ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 25 MARS 2023 | NUMËR 225 | VITI VI I BOTIMIT | ÇMIMI 50 LEKË | WWW.EXLIBRIS.AL | EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL | BOTIM I ONUFRI SHPK

Këto ditë do të festonte 100 vjetorin e lindjes. Por janë të pakët ata që e festojnë për së gjalli këtë kuotë moshe. Po ashtu të pakët janë ata që përkujtohen si qindvjeçarë, edhe pse nuk janë gjallë.

Axha im, Gjon Shllaku, mësuesi dhe mentori im i nji kohe bukur të gjatë, autor i nistimit tim ndër letra dhe në punët e pafundme të gjuhës shqipe, ka qenë njeri i thjeshtë e modest, edhe pse jetën e tij e kishte të ashpër dhe u godit prej saj qysh në fillimet e rinisë.

SI E DI UNË AXHËN TIM, GJON SHLLAKUN

Nga Primo Shllaku





THEODOR DALLTA, MES IKONOGRAFISË BIZANTINE DHE PIKTURËS ITALIANE

nga Fjoralba Prifti (fq. 22)

Fillimi i shek. XX solli shumë ndryshime në të gjitha aspektet e jetës, si sociale, arsimore, kulturore dhe gjithashtu dhe me natyrë patriotike. Shumë personalitete të shkolluar dhe të formuar nëpër universitete europiane u rikthyen në Shqipëri, me synimin e çuarjes përpara dhe zhvillimit të shoqërisë dhe shtetit shqiptar drejt një rruge europiane.

Emrat e përveçëm në origjinal dhe në përkthim

Nga Prof. Dr. Avni Xhelili

Letërsia ruse në vendin tonë ka mbi 100 vjet që përkthehet e ripërkthehet dhe pjesa dërrmuese e veprave të përkthyera i ka qëndruar kohës. Përkthyesit tanë kanë meritën e madhe se mundën të sjellin në truallin gjuhësor të shqipes veprat më të arrira të letërsisë ruse, të cilat mbartin vlerat mbarënjerëzore. Prej punës së tyre vetëmohuese përfituan proceset letrare në vendin tonë, por, më kryesorja, përfitoi lexuesi ynë, të cilit i ranë në dorë vepra elitare të një bote letrare të panjohur për të. Nga përkthimet e kësaj letërsie është përfituar një përvojë e mirë, e cila duhet pasuruar e përsosur.

SHËNIME MBI LIBRAT

Shënime për romanin "Vajzat e mjegullës" të Namik Dokles

POETIKA E VETËS SË PARË NË ROMAN

Nga Skënder Karriqi (fq. 4)

"Vdekja e Omerit", roman nga Adil Olluri

KUR I VDES ORA QYTETIT

Nga Arbër Ahmetaj (fq. 11)

"Fjalimet që përgjakën Ballkanin: Analizë retorike e fjalimeve të Millosheviqit", të autorit Gëzim Mekuli

LUFTËRAT NË ISH-JUGOSLLAVI NISËN ME PËRNDEZJEN E FJALËVE

Nga Enis Sulstarova (fq. 10)

Shqyrtim i librit "Lepurushi i mallkuar" të Bora Chung

SI TA MBASH NJË LEPURUSH TË MALLKUAR?

Nga Andreas Dushi (fq. 21)

Më 27 mars u nda nga jeta shkrimtarja e shquar kroate *Dubravka Ugrešić*

(fq. 20)

BIBLIOTEKË

Charles Bukowski (fq. 18)
Populli i akullores

Shkëlqim Çela (fq. 16)
Çokollatë e errët

Xhelal Tosku (fq. 14)
Kur zbardh dita të verbërit janë prapë të verbër

Fatbardh Amursi (fq. 13)
Koz Kingu

Ermira Mitre Kokomani (fq. 12)
Brenda heshtjes

Azis Mustafa (fq. 15)
Triptik nga palca e manuskriptit

Mehmet Elezi (fq. 17)
Shtëpia me flutura

Dubravka Ugrešić (fq. 20)
Ministria e dhimbjes

100 vjetori i lindjes së përkthyesit të shquar

SI E DI UNË AXHËN TIM, GJON SHLLAKUN

nga Primo Shllaku

Këto ditë do të festonte 100 vjetorin e lindjes. Por janë të pakët ata që e festojnë për së gjalli këtë kuotë moshe. Po ashtu të pakët janë ata që përkujtohen si qindvjeçarë, edhe pse nuk janë gjallë.

Axha im, Gjon Shllaku, mësuesi dhe mentori im i nji kohe bukur të gjatë, autor i nistimit tim ndër letra dhe në punët e pafundme të gjuhës shqipe, ka qenë njeri i thjeshtë e modest, edhe pse jetën e tij e kishte të ashpër dhe u godit prej saj qysh në fillimet e rinisë. Ai i përket atij brezi kur "mentesha" e historisë e përtheu kohën kur mosha e tij ishte artimetikisht vetëm me dy dysha dhe nuk mujti me i përkitë plotësisht asnjenës kohë, as të parës që e lindi e as të dytës që e dështoi. Kësisoj mbeti në kapërcyell tue e heshtë jetën e vet dhe tue jetue vetëm me dritën e ekselencave që e kishin ndriçue botën me shkëlqimin e tyne.

Ai ishte djali i mesëm i gjyshave të mi atnorë. Kur Gjoni ishte vetëm 2 vjeç, i vdes i ati, gjyshi im, dhe të tre vllaznit nuk e njoftën kurr babën e tyne. U rritën jetimë me nanën e tyne, gjyshen time, që u kthye në gjini në moshën 29 vjeçe e që vejnoi dhe nuk u rimartue ma kurr.

Jetimët ishin kontigjente për shkollat private fetare, të cilët kërkonin ta ripërtërinin klerin, kurse familjet e gjituna nga fatkeqësitë shifnin tek shkollat fetare shpëtimin e fëmijëve të tyne dhe të atyne vetë që do të kishin nji gojë ma pak për me e shujtë. Por gjyshja ime, Pina, ishte lidhë me idenë e Gjonit prift dhe andërronte me u ba kujdestarja e tij në nji famulli, kudo që të ishte. Pra andërronte me shkue me të dhe me i ngrysë ditën në gji të Perëndisë, pranë të birit që kishte hy në shkollën e jezuitëve me destinacionin e meshtarit katolik.

Me ardhjen e regjimit komunist më 1944-45, i pari që u godit ishte kleri. Kleri u godit sepse ishte i ditun, kishte informacione dhe e dinte mirëfilli se doktrina e pushtetit në ardhje ishte ateiste dhe se së bashku me pronën private dhe liritë demokratike, ajo gradualisht do ta zhdukte edhe fenë. Shembulli ishte Bashkimi Sovjetik dhe regjimi atë model kishte dhe jo nji tjetër.

Axha im u arrestue në fundin e pranverës së 1945. Shum njerëz e kanë pasë idenë se regjimi po i mblidhte preventivisht klerikët, po i dënonte dhe po i eleminonte edhe fizikisht nën divizën marksiste se feja asht opium për popullin dhe si i tillë feja ishte pengesë zhvillimi shoqnor e shpirtnor.

Ç'asht e vërteta kleri katolik nuk e priti mirë ardhjen e komunizmit dhe iu kundërvu kryesisht ideologjikisht. Axha im, Gjon Shllaku, në prill të 1945 shkruen nji bejte satirike kundër Tuk Jakovës, që asokohe ishte numri dy i regjimit me nji kalë ofiqesh e postesh kryesore në hierarkinë e regjimit. Kjo bejte e cila merrej me satirizimin e zanatit të mapërparshëm të Tuk Jakovës – ai ishte marangoz – i përmendte Tukut sharrën dhe zdrukthin dhe e kështillonte atë të shkonte ma mirë e të bante atë punë që e dinte mirë dhe të mos merrej me punë qeverie se ai nuk kishte kërçik për ato punë. Bejtja tallet me Tukun kur e quen *Tegetthoff i dytë në ushtri* – Tegetthoff-i ishte nji admiral i famshëm austriak që e mundi flotën italiane në Lissa, më 1866.

Zarfin me bejten për Tukun axha ia dha për ta dorëzue anonimisht tek zyrat e mbrojtjes popullore nji djaloshi katërmbëdhjetëvjeçar, E.D. Djaloshi e mori zarfin dhe shkoi fill e tek zyrat te shtëpia e Kokës në Shkodër ku kishte zyrën edhe Tuku asokohe. Ua dorëzoi ushtarëve që ruenin hymjen dhe po rrinte aty. Simbas vetë pohimit të E.D., ai e dorëzoi në sportel dhe ndejti me pritë aty. Djaloshi i ri ishte mësue me dorëzue mallna të ndryshme si mish, stofna, e sende të tjera që dyqanxhijtë i dërgonin nëpër shtëpitë e klientëve të tyne si shërbim falas dhe joshje e klientelës. Destinatari pothuejse gjithnji hiqte e i jepte prumësit nji bakshish të vogël për shërbimin. Pra djaloshi po priste në kambë të merrte simbas rregullit të tij nji bakshish nga dikush aty për atë zarf që kishte sjellë. Kur e pyetën pse pret ai heshti, se ishte turp me kërkue bakshish. Bakshishi duhet "të pikonte" njianësisht nga ana e klientit. Djaloshi heshtte dhe rojat dyshuen për sendin e sjellë prej tij, e hapën dhe, kur panë përmbajtjen, e kapën djaloshin dhe e shtrënguen fort që të tregonte dërguesin. Dhe dërguesi ishte Gjon Shllaku, seminarist në kolegjin saverian të qytetit të Shkodrës.

Kështu arrestohet axha im dhe në hetuesi i bahen tortura të forta: korrent në bulat e veshit. Hetuesit i kërkonin me ditë se kush e kishte porositë për bejten. Ky e merrte vetë përsipër dhe thoshte se, meqë e kishte pasë shok mëhalle Tukun e kishin luejtë me qinda herë top futboll me top leckash së bashku, e kishte pa të udhës t'ia shkruente bejten në konfidencë.

Por hetuesia donte me mbërritë tek pegagogët e shkollës përmes seminaristit Gj.Shllaku.

Atëherë gjyshja ime çohet e i shkon në shtëpi nanës së Tukut dhe e ban leckë lidhë me arrestimin e të birit të saj, tue e quejtë atë punë kalamajsh, nji bejtë e punë e madhe. Shkodra ishte qytet bejtesh dhe humori të patëkeq dhe se nuk mund të burgosej nji jetim për do rreshta humori për me qeshë. E ama e Tukut preket nga gojtaria e posaçme e gjyses time dhe i premton se do ta bisedojë qysh atë mbramje me Tukun punën e Gjonit. Mbas dy ditësh axha kthehet në shtëpi. Nana ime më thotë se atë ditë kur erdhi Gjoni, u ba nji gëzim i papërshkrueshëm. Tri ditë nuk na pushoi shtëpia prej vizitave.

Thonë se nana e nji të burgosuni tjetër që kishte mbetë mbrendë e që ishte edhe ai seminarist si Gjoni, shkoi deri në Tiranë për me u ankue se si nuk e kishin lirue edhe të birin e saj, por kishin lirue vetëm Gjon Shllakun. Diku në kupolën e regjimit u krijue ni "lidhje e shkurtë" dhe axhën tim vijnë dhe e marrin për së dyti, mbasi kishte ndejtë nja tri javë të mira në shtëpi dhe po mundohej me harrue përvojat e tij në hetuesitë e 1945.

Kështu ai iu nënshtrue edhe nji herë hetuesive dhe qe pjesë e nji megagjyqi që u propagandue fort nga regjimi dhe që u zhvillue me altoparlanta në sheshet kryesore të qytetit. Kortezhi i të dënuemve përshkohej me kambë nëpër qytet për me rritë terrorin dhe njerëzia e papjekun politikisht dhe me entuziazmin e propagandës i pështynte tek kalonin rrugës. Në grup ishin mësuesit e axhës Fausti, Dajani etj. Hetuesit ngulmonin që të nxirrnin prej seminaristave të pandehun se ishin mësuesit e tyne ata që i kishin shtie në veprime kundër pushtetit të ri. Në gjyq Gjonin e shtrënguen fort të pohonte se ishte i futun prej mësuesve të tij me shkrue satirën anmiqësore ndaj Tukut që atëherë ishte në pupa dhe nuk i binte pasha në gju. Nana ime më tregon se gjatë gjyqit publik me altoparlanta, ajo së bashku me gjyshen delnin në shesh dhe e ndiqnin gjyqin prej jashtë. Nana ime më thoshte se kur prokurori i bani presion Gjonit të pohonte se ishte pedagogu italian i shkollës, patër Fausti, ai që e kishte porositë bejten për Tukun, Gjoni u përgjigj me vendosmëni: Jo, pasha Zotin! Turma në shesh lëshoi nji uuu! të madhe e

të gjatë. Për nji njeri që kishte marrë rrugën e priftënisë, ishte e ndalueme me zanë be në Zotin dhe axha im në atë siklet shtrëngice e tha tue krye nji kundravajtje morale ndaj rrugës së tij të atëhershme.

Interesante asht edhe dhania e pretencave për këtë megagjyq. U lexuen dënimet që po jepeshin prej atyne që vetëquheshin drejtësia popullore. Nana më tregonte se ishte në shesh me gjyshen dhe po prisnin me zemër të ngrime se cilat do të ishin dënimet. Gjashtë emnat e parë ishin të gjithë me vdekje (pushkatim). Emni i Gjonit, - thoshte nana, - ishte i shtati. U lexue emni i tij. Pati nji heshtje. U ngrimë. Gjyshja ishte mbulue në djersë të ftofta. U ndigjue vazhdimi i dënimit: Burgim i përjetshëm, 101 vjet. Turma brohoriti. Ndoshta se filloi teposhtja e dënimeve dhe emnat e tjerë (se ishin shum) ishin tashma jashtë rrezikut për jetën. Gjyshes time i ra si të pakët, por e mbajti veten. Askush nuk e dinte në atë turmë se ajo grue pesëdhjetëvjeçare sapo e kishte pa djalin e saj të shpëtuem prej kthetrave të vdekjes.

Axha ndejti njimbëdhjetë vjet në burgje e kampe pune, Burrel, Radostinë, Shtyllas etj. Doli nga burgu në maj të 1956. Tuku kishte ra nga fiku, madje ishte përjashtue edhe nga partia e ishte internue në Berat dhe punonte si zdrukthatar. Profetësia e bejtes së Gjon Shllakut ishte përmbushë. Tuku kishte kapë sharrën e zdrukthin edhe nji herë në dorë. Transcendencë e historisë apo fillimi i shthurjes së andrrës komuniste?

Axha im heshti përgjithmonë dhe nuk donte me folë për atë pjesë, madje as në kohën kur regjimi ra dhe liritë e fjalës erdhën me bollëk. Sa herë e pyesja, ftyrës së tij i ikte drita dhe kjo mue më çarmatoste për shum kohë ma mbrapa. Vetëm në 1994 kur erdhi në Athinë me marrë diskun e argjendtë si helenist i njoftun edhe nga bota helene, me njimijë zore e ngurrime pranoi të ma tregonte bejten për Tukun. Nuk deshti me ma diktue, por hyni në makinën time të shkrimit dhe e shkroi përnjiherësh a thue se ishte tue e lexue diku. Si duket, ai tekst që ia kishte ndryshue përgjithmonë jetën, ishte nji realitet mendor tejet i pranishëm në të gjitha orët e tij.

Jeta dhe fama e tij e padiskutueshme lidhet me "Iliadën" e Homerit. Ajo qe kali i tij i betejës dhe monumenti i rrallë që ia la kulturës shqiptare në dy variantet kryedialektore, gati-gati si me dashtë me thanë: shifni dhe krahasoni, ndjeni dhe vlerësoni. Parballja mes dy varianteve kishte qenë nji sfidë e keqe, por e paqëllim. Zellnikët e kthimit në standard e kishin dënue variantin në gegnisht me mbetë pakrahasueshmënisht varianti

Gjon Shllaku ne studion e te vellait, Lec Shllaku, 1999

optimal i Omerit në shqip. Zelli i tepruem shpesh na ban me e humbë të drejtën në nji skemë krahasimtare të cilës nuk ke se si me i ikë. Ma mirë do të ishte të lehej në gegnisht si "Komedia hyjnire" dhe krahasimi hipotetik do të ishte ma në favor të variantit standardo-tosknisht. Por gegnishtja me sa duket i merr revanshet e saj nën qiell të kthjelltë dhe pret mendje të kthjellta për ta kthejellue peizazhin gjuhësor. Ajo asht aty dhe aty do të mbetet derikur shqipes barra që i ka shkue nën bark, t'i barazpeshohet dhe shqipja të rrjedhë e gjanë dhe e thellë sikurse



e ka tregue tradita e saj ma e mirë dhe pjesa historike e mbijetueme e letërsisë së saj.

Kur përkthente Iliadën, Gjon Shllaku i kishte caktue burimet dhe i kishte përcaktue modelet. Kishte studiue me kujdes variantet e përkthimit të disa kangëve nga Frano Alkaj, nji helenist i mrekullueshëm edhe ai, dhe modeli e prozodia e kangëve të Kreshnikëve i kishte ra për shtat frymës epiko-heroike të Iliadës, si histori fatosash e betejash tragjike me antrakte skenash njerëzore e mahnitjesh para gjithësisë e krijesës si burim i përhershëm frymëzimi. Sprovat e para ishin me metër vargu ma klasik, pra greko-romak. Vargu i kthyem kështu ishte pa hove dhe nuk skandohej asimetrikisht. Format klasike të vargut kishin hapësinë ma të madhe, por e lodhnin lexuesin me simetrinë dhe monotoninë që rezultonte prej kësaj simetrie.

Vargu i Kreshnikëve ishte ma i rrëmbyeshëm, ishte ma "thyeqafës", kapërcente dhe shpaloste me shpejtësi, hapte skena dhe mbyllte skena, fillonte dialogje dhe kapërcente dialogje dhe shenjat e pikësimit të tij fonetikisht ishin rrokjet tronke të fundit të vargut. Prozodia e vargut heroik shqip ishte ma filmike, ma imazhiniste, kishte ma shumë imazheri sesa tingëllimë. Por kjo jo gjithmonë. Gjuha shqipe gjente tek Homeri nji hapësinë të pamatë për ta vazhdue ma tej frymën epike e heroike, forcën e nji fjale ose edhe të nji shprehje ndërtue me fjalë. Dialogu i Priamit me Akilin që vjen me kërkue kufomën e Hektorit asht i nji dramaticiteti ndoshta ma të madh në shqip sesa në greqisht. Fryma e Ajkunës që qan Omerin e kishte ndihmue përkthyesin mos me mbetë tek enumeracionet e planit ditor për vorrimin e Hektorit. Elegjiakizmi i sprovuem i shqipes i jepte dorë përkthyesit me thanë shpesh paksa ma tepër se origjinali, madje ma shum, por edhe ma shkurt.

Askush ende nuk ka shkrue për variantin shqip të Gjon Shllakut. Kjo sepse ne nuk kemi ende vetëdijën e nji shkollë shqipe të përkthimeve, anipse kemi përkthime të mrekullueshme nga të gjitha gjuhët europiane. Pritet të vijë kritika edhe në fushën e përkthimit që fama e këtyne njerëzve të mos jetë nji pasthirrmë admirimi prej tifozësh, por diçka e shumçka ma shum. Përkthyesit kanë hisen e vet në tezgjahun e madh të shqipes dhe janë ata që kanë kontribue për pasunimin gjuhësor ma shum se të gjithë letrarët e marrë së bashku. Kjo sepse përkthyesit e shofin shqipen në raport të gjallë me gjuhët e tjera të kontinentit, kurse letrarët kishin mendjen me krijue neologjizma ndër tekste shpeshherë të pafat. Interaktiviteti gjuhësor tek përkthyesit ka qenë e mbetet shum pjellor, sidomos në nxjerrjen

(Vijon në faqen 5)

Shënime për romanin "Vajzat e mjegullës" të Namik Dokles

POETIKA E VETËS SË PARË NË ROMAN

Nga Skënder Karriqi

Një ndër problemet që duhet të zgjidhë prozatori, kur vendos të shkruajë prozën e tij, është veta e rrëfimit, e cila është fokusi me të cilin ai kundron botën dhe veten nga jashtë e nga brenda. Një histori vetore e prozës, në fakt fillon si një histori mitologjike fetare, ku nuk është vështirë të shquhet inferioriteti i aedit deri në vetëflijim, për të arritur (shekuj më vonë) në momentin revolucionar të çlirimit. Përshtatur në terma të formës (gramatikore), rrëfimi prozaik si një moment flijimi (inferioriteti deri në flijim) rezulton në vetën e dytë rrëfimtare, të cilën na vjen ta quajmë si veta klasike dhe që si fakt letrar dëshmohet me lutjen që aedi Homer u bën Muzave si më poshtë: *Rrëfemëni tani muza q*ë *n*ë *Olimp banesën keni/Ju jeni hyjnesha, jeni kudo, shihni gjithçka/Ne dëgjojm*ë *thjesht zhurm*ë*, s'dim*ë *kurrgjë/Cilët ishin udhërrëfyesit e Danajve dhe cilët prijësit?* Pas këtij "mjerimi njerëzor" në vetë të dytë, vjen rrëfimi i epërsisë hyjnore në vetën e tretë edhe si triumf i narrativës hyjnore. Pikërisht kjo narrativë hyjnore, edhe pse lëkundet për një moment nga kapriçua hesiodike e ligjërimit për veten, stilizohet dhe legjitimihet si vetë e të gjithdijshmit, së cilës nga dekada në dekadë, nga shekulli në shekull, do t'i zbeheshin shenjat imagollogjike të Muzës rrëfimtare, duke u bërë, gjithnjë e më padurueshëm, një vetë abstrakte, pa imazh, pa sens, sidomos në kontekste kur qenia, gjithnjë e më shumë triumfalisht, kërkon të provojë praninë e saj, kërkon vëmendje, aq më tepër kur ajo është një qenie krijuese. Pikërisht në këto kontekste (ku qenia, sidomos ajo krijuese) kërkon vëmendje, jemi në momentin revolucionar të çlirimit të vetës autoriale prej vetës pa imazh, pa sens; prej vetës së tretë të gjithdijshme. Sigurisht në këtë moment çlirimi (prej vetës së tretë) vjen konfirmimi i vetës së parë si vetë autoriale, e cila, për ta tejkaluar veten, për ta rritur atë, për t'u njesuar me ngjarje, epoka, kontekste dhe përmasa përtej masës njerëzore, do të shfrytëzonte format gramatikore të vetës së tretë (por jo vetën e tretë).

Këtë histori vetore të artikuluar shkurt si më sipër ti si lexues e gjen në finalen e saj të mishëruar në mënyrë të shquar imagollogjike në romanin: "Vajzat e mjegullës" të autorit Namik Dokle, sidomos kur kërkon të motivosh shkrimin në vetë të parë të këtij romani, i cili, edhe pse i botuar në vitin 2015, vazhdon të tërheqë vëmendjen e mendimit kritik. Me siguri forma klasike e vetës së tretë (si vetë e rrëfimtarit të gjithdijshëm) do t'ia bënte autorit, të largët, pa imazh të shquar dhe të pandjershëm (sidomos përkundrejt detyrimit për të qenë neutral) pikërisht atë botë, të cilën ai e ndjente se duhet t'i qëndronte sa më afër. Është kjo situatë fenomenologjike që, përveçse ka përcaktuar shkrimin në vetë të parë, ka bërë që intuitivisht autori Namik Dokle të kërkojë dhe të përzgjedhë rrugë të tjera stilistike, falë të cilave do të tejkalohej stili kronik.

Që në fjalinë nistore të romanit autori shenjon një distancë kohore të përpiktë (57 vjeçare, jo, fjalavjen rreth 60-vjeçare) me kohën reale kur kanë ndodhur ngjarjet që do të rrëfehen në shtjellim e sipër të subjektit. Shenjimi i kësaj distance të përpiktë kohore nuk mund të jetë për ne thjeshtë një mënyrë fillimi e rrëfimit dhe kaq. Në fakt, distancimi 57-vjeçar i kohës së rrëfimit nga koha e ngjarjeve, është në përmbajtje stilistike, ajo fjalia nistore, të cilën autorët e kërkojnë me këmbëngulje, ndonjëherë edhe për një kohë relativisht të gjatë, racionalisht të bindur (dhe jo si bestydë) se pas saj rrëfimi do t'u shkonte mbarë. Autori Namik Dokle, duke shenjuar distancën kohore (si distancë në raport me veten) motivon gramatikisht dhe stilistikisht jo vetëm rrëfimin në vetë të parë, por edhe figurën e kësaj vete si veta fëmijënore e rrëfyesit, pas së cilit qëndron autori. Kështu, në këtë moment nistor lexuesi percepton mishërimin e parimit stilistik, sipas të cilit, në rastin konkret (tek romani "Vajzat e mjegullës") informacioni nuk është një e dhënë në vetvete por ai ka funksion të dukshëm stilistik.

Rrëfimi në vetë të parë, sigurisht, fillon nga vetja, por jo për të mbetur aty, tek vetja. Për të qenë edhe një rrëfim epik (në kuptimin gjinor të fjalës) rrëfimi në vetë të parë duhet ta tejkalojë veten (në kuptimin e ngushtë të kësaj fjale) duke u ndërkëmbyer sipas rastit nga rrëfim për veten, në rrëfim për tjetrin apo për të tjerët. Në këtë mënyrë, rrëfimit në vetë të parë i duhet të çlirohet nga drejtimi konvergjent me pikë konvergimi vetën e parë (une/ne), për të kaluar në një situatë stilistike divergjente, me një hapësirë sa më të plotë, ku pikërisht prej vetës së parë rrëfimtare do të instalohen edhe veta të tjera, por jo si zëra të veçantë rrëfimtarë. Në të vërtetë ata janë zëra thjesht të rrëfyer nga veta e parë. Sa u shestua më lart gjendet e mishëruar stilistikisht në romanin "Vajzat e mjegullës", ku rrëfyesi në vetë të parë, nga i tillë, duke tejkaluar veten, ndërkembehet me rrëfyesin për të tjerët, duke rrëfyer në këtë mënyrë edhe historinë e rritjes së vet, në një kuadër të gjerë kohor, 57-vjeçar.

Në romanin e prozatorit Namik Dokles rrëfime të tilla të vetës së parë për vetat e tjera, më së shumti për vetën e trëtë, por edhe për vetën e dytë, siç janë p.sh. rrëfimi për Majkën, rrëfimi për Salkon, rrëfimi për mësuesin, rrëfimi për vajzat, rrëfimi për Plakën e Shqipërisë, rrëfimi për Sinan Pashën etj, edhe pse jo në masën e një njësie të plotë episodike, të krijojnë idenë e një distance ndërmjet vetës së parë rrëfimtare dhe vetës së tretë të rrëfyer, distancë kjo, e cila nga ana e saj të krijon iluzionin e pavarësisë së vetës së tretë, deri edhe qenien e saj si zë i veçantë rrëfimtar. Në të vërtetë, nuk ka një zë tjetër rrëfimtar përveç vetës së parë. Ka vetëm një rrëfim gramatikor në vetë të tretë të bërë nga veta e parë rrëfimtare. Në këtë mënyrë, iluzioni i pavarësisë së vetës së tretë nga veta e parë rrëfimtare mbetet thjesht efekt i lojës stilistike vetore të autorit Namik Dokle, për të tejkaluar vetën e parë, e cila, pa instalimin e vetave të tjera, do ta ngushtonte rrëfimin në kufijtë e stilit autobiografik. (Mbase Fan Noli pikërisht këtë lloj efekti ngushtues deshi të shmangte , kur autobiografinë e vet e shkroi në vetën e tretë).



Kur flasim për linjë rrëfimi, do të ishte shpërdorim përcaktimi i saj si shumëplanëshe. Në këtë kuptim na duket i dyshimtë togfjalëshi *linjë shumëplanëshe* (e rrëfimit), me të cilin ndonjë studiues shpjegon veçori të rrëfimit në romanin "Vajzat e mjegullës". Në këtë roman rrëfimi është linear dhe ky linearitet vjen gjithë stil nga rrëfyesi në vetë të parë, si rrëfim i rrëfimit të rrëfimit, ku spikat figura e gjuhës si strukturë sociale në periudha të ndryshme kohore. Fjalavjen, në këtë roman, nga një distancë 57-vjeçare, rrëfyesi rrëfen rrëfimin e djalit 12 vjeçar, i cili rrëfen rrëfimin e Majkës, e cila rrëfen rrëfimin e Sinanit, i cili rrëfen rrëfimin për plakën e Shqipërisë etj.

Në esenë "Gjuha e romanit" studiuesi i njhur rus Michail Bahtin, kur i referohet gjuhës së romanit, e sheh atë, në një kuptim të gjerë, jo si gjuhë të autorit, por si gjuhë të epokave apo periudhave historike, të cilën autori, në rolin e rrëfyesit (qoftë në vetë të parë, qoftë në vetë të tretë), e mbart nga kontekstet historiko-kulturore. Në këtë mënyrë ai e shquan figurën e gjuhës së romanit si një tërësi të folmesh dhe stilesh që e karakterizojnë gjuhën në kontekste romanore. Një figurë të tillë të gjuhës romanore e shohim edhe në romanin "Vajzat e mjegullës", ku shquhet e folmja e fshatarëve të Gorës, e folmja e përfaqësuesve të pushtetit të ri komunist, e folmja e grave, e folmja historike e personazheve historikë (Sinan Pasha), e folmja etnografike e personazheve përrallorë (Majka), stili etnografik i formulave të mallkimit, ku të bën përshtypje relievi gjuhësor etj.

Në kërkim e sipër të veçorive të gjuhës romanore si më lart, në romanin "Vajzat e mjegullës" mund të shquajmë tregues të qartë stilistikorë, të cilët, si të tillë, përveçse komunikues, e bëjnë të veçantë dhe tërheqës rrëfimin në këtë roman. Kështu mund të dallohet përdorimi stilistik i ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejtë. Në qoftë se e para me natyrën e vet i jep mundësi autorit që në mënyrë të drejtpërdrejtë të përcaktuar të sjellë veçori të gjuhës së personazhit, si aspekt i ghuhës romanore, e dyta i jep atij të njëjtën mundësi, veçse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, por në mënyrë të ftilluar nga rrëfyesi. Garanci që të dyja ligjëratat (e drejtë dhe e zhdrejtë) sjellin veçori të gjuhës së personazhit si aspekte të gjuhës romanore (tërësi të folmesh dhe stilesh që e karakterizojnë gjuhën në kontekste romanore) është fakti gramatikor (sintaksor) i përcaktimit apo sipas rastit, ftillimit të ligjëratave nga folje të tilla si: them, dëgjoj, paralajmëroj, gjykoj, mendoj, pyes etj, semantika e të cilave, në një mënyrë apo në një tjetër, lidhet me perceptimin e ligjeratës, dëshmimin e saj si akt gjuhësor (tha, thirri, pyeti dëgjoi, paralajmëroi etj) dhe si mendim (mendoi, gjykoi, vlerësoi etj). Ndër shembujt e shumtë, më poshtë po sjellim nga një sipas llojit. Ligjëratë e drejtë: *"Mos u trembni", u thirri ai, "s'kam pun*ë *me t*ë *tjertat, veç me at*ë *q*ë *preka. Shko e u thuaj n*ë *sht*ë*pi se t*ë *vura beleg dhe s'mund t*ë *martohesh me tjet*ë*r veç meje. Do t*ë *t*ë *gjej edhe me u mshel*ë *si arrat n*ë *gëzhyt*ë*r"*, (fq 25).Ligjëratë e zhdrejtë: *I pash*ë *me inat dhe mendova sa mir*ë *po vinte ai aksion t'i rrëmbente, t'u shuhej virrma e t*ë *mos na tregonin me gisht ne q*ë *ishim t*ë *detyruar t*ë *hanim buk*ë *t*ë*rshëre t*ë *p*ë*rzier me misrin e Murselit nga Orgosta.*(fq 24). Por çështja e përdorimit stilistik të ligjëratave nuk na rezulton të jetë kaq e thjeshtë, kur është fjala për romanin "Vajzat e mjegullës". Në kërkim e sipër, mund të konstatohet me lehtësi se autori Namik Dokle është inkoherent në zbatimin e rregullatve të përdorimit të thonjëzave dhe gramatikat përkatëse të ligjëratave, por që në fakt kemi të bëjmë me

rastin e një inkoherence poetike, siç do të përpiqemi ta shpjegojmë më posht.

Në këndvështrimin teorik studiuesit kanë dalluar, ndër të tjera, ligjërimin e jashtëm dhe ligjërimin e brendshëm. Ligjërimi i jahstëm është gramatikor, pasi qëllimi i tij është komunikimi i zëshëm i mesazhit tek të tjerët, gjë që nuk mund të realizohet pavarësisht konvencioneve gramatikore. Ndërsa ligjërimi i brendshëm mund të jetë edhe jogramatikor, pasi qëllimi i tij nuk është komunikimi i mesazhit tek të tjerët, por përdorimi me shkathtësi dhe me stil i gjuhës për të arritur vetëshprehje në shkallën më të lartë dhe efekte zbavitëse estetike në vetvete, nëpërmjet gjuhës. Ligjërimi i brendshëm, duke qenë potencialisht një ligjërim edhe jogramatikor ka premisën e artë për ta çliruar autorin nga "burgu i gjuhës". Në lidhje me "produktet" e ligjërimit të brendshëm si ligjërim jogramatikor, autorit i duhet ose t'i mbajë ato për vete, të papublikuara, ose të gjejë rrugë kompromisi, në mënyrë që shkelja e konvenciponeve gramatikore nga ana e tij të jetë e tolerueshme nga lexuesi, në këmbim të përjetimit të efekteve zbavitëse estetike në vetvete, të arritura nëpërmjet përdorimit me shkathtësi dhe me stil të gjuhës.

Në përgjithësi, autori Namik Dokle, për të sjellë figurën e gjallë të gjuhës, fjalët, shprehjet, fjalitë apo frazat e personazheve i fut në thonjëza, sipas rregullave të përdorimit të tyre dhe sintaksës së veçantë në këto raste. Por në shumë raste ai nuk e zbaton këtë rregull, i cili e dallon gjuhën e tij nga gjuha e personazhit, qoftë në pikëpamje stilistike, qoftë në pikëpamje shkrimore formale. Neglizhimi i këtyre rregullave, më tepër se sa i tillë, është në fakt një reagim i vetës së parë rrëfyese, për të qenë sa më afër, sa më brenda, mundësisht i shkrirë, me personazhet e rrëfyera dhe kohën që rrëfen (me të cilën është në një distancë 57-vjeçare). Për sa thamë, mund ta vërejmë në shembujt si më poshtë: *"Po cila është kljo Majka?", pyeti Mësuesi. "A nuk e njeh? Është një plakë që ka bërë dyqind apo treqind vjet mbi këtë tokë dhe që vdekja e ka harruar, e ka shtëpinë këtu afër, ajo të shëron me magji. Edhe mua më ka shëruar...".* (fq. 34). *Ajo më vuri re dhe më tha, ik se të bëhet merak nëna, unë me Mësuesin do të flasim për punët e dy botëve.* (fq. 39). Në këta dy shembuj mnud të shihet rasti korrekt i përdorimit të thonjëzave (shembulli i parë) dhe rasti i neglizhimit të përdorimit të thonjëzave (shembulli i dytë). Në qoftë se në shembullin e parë autori është koherent me rregullat përdorimit të thonjëzave, duket se ai nuk është aspak koherent me rregullat sintaksore të fjalisë dhe të tekstit, pasi sipas këtyre rregullave, fjalitë: "*e ka shtëpinë këtu afër*" dhe "*ajo të shëron me magji*" duhet të ishin fjali të thjeshta, më vete, të ndara me pikë në tekstin përkatës. Po kjo nuk ka ndodhur, jo për neglizhencë të rregullave të sintaksës, por për shkak të figurës së ritmit të shprehjes së rrëfyesit, ritëm ky që për shkak të emocionit të shprehjes, nuk e suportonte pikën si ndërprerje relativisht të gjatë të ligjërimit. Për këtë arsye legjitimohet një lloj tjetër lirie poetike pëkundër sintaksës së fjalisë. Ndërsa në rastin e dytë, ku autori e neglizhon përdorimin e thonjëzave duke u përpjekur të ruaj në mënyrë fiktive formën e ligjëratës së drejtë, ndihet se për këtë arsye rrëfyesi është në raporte intime me gjuhën e përsonazhit (Majkës në rastin tonë), raporte këto që edhe në këtë rast legjitimojnë arsyen e mospërdorimit të thonjëzave dhe sintaksën e veçantë. Në të dyja rastët inkoherenca në lidhje me shenjat e pikësimit dhe rregullat sintaksore është e tolerueshme nga lexuesi, në këmbim të poetikës së figurës së ritmit ekspresiv dhe intimitetit të rrëfyesit me gjuhën e personazhit, si veçori të poetikës së vetës së parë rrëfimtare në romanin "Vajzat e mjegullës", i cili ka tërhequr dhe vazhdon të tërheqë vëmendjen e opinionit letrar dhe mendimit kritik letrar brenda dhe jashtë vendit.

Gjon Shllaku, seminarist, ne gjyqin kunder priftave, Blinisht, 1945

SOFOKLIU

VEPRA E PLOTË

Onufri

(Vijon nga faqja 3)

e fjalëve nga zona inaktive e leksikut dhe rijetësimi i tyne në tekste që e emancipojnë drejtpërsëdrejti fjalën për shkak të cilësive të tekstit dhe të ideve e famës që bartin.

Në verën e 2003 erdha në Shkodër dhe, sapo shkela në shtëpinë e tim eti, ai më tha se axha Gjon nuk ishte mirë, se ishte dobësue dhe se ishte në gjendje kritike. Ndjeva dhimbje dhe njifarë ngurrimi me shkue me e pa. Ai njeri optimist e i heshtun, që më kishte mësue shkronjat e Homerit dhe vargje të tana prej tij, që më kishte përkthye me mija vargje nga latinët për nevojat e mia të formimit e të shkollës, ai njeri që kishim luejtë futboll me porta hungareze dhe që dikur rrinte edhe 30-40 minuta i varun në degë i mbajtun prej njenit krah të tij, tashti ishte në gjendje kritike. Në fakt mësuesit nuk vdesin, prandej ndoshta edhe na nuk duem me i pa as të ligështuem e jo se ma të vdekun. Krova kryet e u nisa pa qejf. U mundova me e imagjinue dhe më delte gjithnji përpara me atë buzëqeshjen e tij enigmatike, të cilën e përdorte si sipar për me mbulue krejt jetën e tij të përmbysun e fatkeqësitë e tjera të cilat e kishin goditë vetëm atë.

Shkova. Në shpinë e tij. Kishte ra heshtja. Herojt e Iliadës ishin mshefë mbrenda librave dhe nuk bëzanin. Ishte vapë dhe shtëpia e tij vinte era kafe e freskët. S'm'u duk shenj i mirë.

Na doli para Neta, bashkëshortja e tij. Ajo pati nji vetimë buzëqeshje kur na pa dhe përnjiherësh u ba serioze. "Hë, si asht axha," – e pyeta. "Njashtu", - u përgjigj ajo dhe na priu në shtëpi. Ndejtëm pak. I thashë: "Po axha, ku asht?" "Në dhomë," – më tha, - e ka zanë gjumi."

Mbas pak ajo doli dhe erdhi. "Hajdeni," – na ftoi me shkue në dhomën e gjumit të tyne.

Kur hyna mbrendë mbi shtratin e tij shquejta nji çarçaf të bardhë hjedhë mbinji trup njeriu. M'duk se kishin hjedhë nji çarçaf mbi disa binarë të kryqëzuem parregull mes tyne. Neta ia zbuloi kryet dhe ai e çoi shikimin përreth.

Sa më pau, u çil në ftyrë dhe foli me nji za të mekun që s'ia kisha ndigjue kurr. Ai ishte tenor i vërtetë e zanin e kishte kangëtar. Tashti zani i tij ishte bjerrë, ishte topitë dhe dukej se delte me zor prej thellësish të liga që po e ngulfatnin dita me ditë. "Oho, Primus inter pares," – më tha. Mandej e ktheu në greqisht:

"Ti leei i Eladha?" – dhe u mundue me buzëqeshë si përherë. Folëm pak. I shtrëngova dorën dhe dolëm. Ai kishte nevojë për pushim. Mbas nji udhëtimi kaq të gjatë, por jo si të Iliadës, por si të Odisesë, axha im kishte nevojë për pushim. Nuk e pashë ma të gjallë. Ai kishte marrë pushimin e tij të përjetshëm për me shkarkue lodhjen e tij të përjetës...

Tiranë 15 mars 2023

EMRAT E PËRVEÇËM NË ORIGJINAL DHE NË PËRKTHIM

Nga Prof. Dr. Avni Xhelili

Letërsia ruse në vendin tonë ka mbi 100 vjet që përkthehet e ripërkthehet dhe pjesa dërrmuese e veprave të përkthyera i ka qëndruar kohës. Përkthyesit tanë kanë meritën e madhe se mundën të sjellin në truallin gjuhësor të shqipes veprat më të arrira të letërsisë ruse, të cilat mbartin vlerat mbarënjerëzore. Prej punës së tyre vetëmohuese përfituan proceset letrare në vendin tonë, por, më kryesorja, përfitoi lexuesi ynë, të cilit i ranë në dorë vepra elitare të një bote letrare të panjohur për të. Nga përkthimet e kësaj letërsie është përfituar një përvojë e mirë, e cila duhet pasuruar e përsosur.

Shkrimi i sotëm është një përpjekje për të përgjithësuar përvojën e përkthyesve tanë lidhur me transmentimin në shqip të emrave të përveçëm, të cilët janë një komponent i rëndësishëm funksional në strukturën e tekstit letrar. Ata marrin pjesë në ndërtimin dhe zhvillimin e kompozimit letrar dhe ligjërimor të tekstit, ndihmojnë në zbërthimin e ideve artistike të autorit. Në kontekstin e përkthimit artistik transmetimi i emrave të përveçëm në një gjuhë dhe kulturë të re përbën një problem përkthimor serioz; çdo njësi antroponimike dhe toponimike kërkon qasje të veçantë nga përkthyesi.

Në letërsinë artistike përdoren të gjitha llojet e antroponimeve dhe toponimeve: emra/mbiemra njerëzish të zakonshëm, pseudonime, nofka; emërtime të objekteve gjeografike: emra kontinentesh, vendesh, vendbanimesh, oqeanesh, detesh, liqenesh, malesh etj. Në një vepër letrare përdoren gjithashtu dhe emra/mbiemra të krijuar nga vetë autori sipas modeleve ekzistuese të gjuhës, të cilët, veç funksionit emërtues, thonë diçka më shumë për personazhin dhe funksionin e tij në vepër, theksojnë tipare a cilësi të karakterit të tij. Letërsia ruse është e pasur me mbiemra të tillë, mjafton të përmendim personazhet nga tregimi i Çehovit "Kameleoni": *Oçumelov, Hrjukin, Eldirin*; nga poema "Frymë të vdekura" e Gogolit: *Sobakieviç, Koroboçka, Manillov*; nga romani "Krim dhe Ndëshkim" i Dostojevskit: *Raskolnikov, Marmeladov, Razumihin*.

Si klasë e veçantë fjalësh, antroponimet dhe toponimet janë pjesë e historisë dhe e kulturës së popujve. Ato pasqyrojnë periudha të tëra historike, kontaktet midis popujve, mënyrën e jetesës së njerëzve, besimet, aspiratat a fantazitë e tyre. Nga emri/mbiemri i personazhit lexuesi mund të njihet me identitetin e tij etnik, kulturor e fetar, me përkatësinë historike të emrit (cilës periudhe historike i përket), me kuptimin metaforik dhe simbolikën që përfaqëson në tekstin letrar.

Si objekt i huazimit ndërgjuhësor dhe ndërkulturor, transmetimi në përkthim i emrave dhe emërtimeve është problem kompleks dhe i vështirë, jo rrallë i lidhur me zgjidhje përkthimore të diskutueshme ose të qortueshme. Detyra e përkthyesit bëhet edhe më e vështirë, kur përkthimi me shkrim realizohet nga gjuhë me sisteme alfabetike të ndryshme nga shqipja, siç është rasti i rusishtes ose i gjuhëve të tjera sllave që përdorin alfabetin cirilik. Nuk mund të lihen jashtë vëmendjes edhe veçantitë e sistemeve antroponimike në gjuhë të ndryshme si dhe traditat e kombeve në vendosjen e emrave, p.sh., sistemi antroponimik i shqipes përbëhet nga dy komponentë (emri+mbiemri), i cili ngjason me shumicën dërrmuese të vendeve europiane. Ndryshe nga kjo traditë, sistemi antroponimik i gjuhës ruse përbëhet nga tre komponentë: emri+atësia+mbiemri (*Ivan Pavlloviç Panfillov*), rendi i të cilëve mund të ndryshojë. Në dokumentet zyrtare në fillim shkruhet mbiemri, pas tij emri dhe në fund atësia: *Panfillov Ivan Pavlloviç*. Në praktikën e përditshme mund të përdoren vetëm emri dhe atësia (*Ivan Pavlloviç*) ose emri dhe mbiemri (*Ivan Panfillov*).

Një pjesë e antroponimeve të kësaj gjuhe janë me burim nga sllavishtja e vjetër ose nga gjuhët skandinave (*Tretjakov, Menshov, Jarosllav, Vsevollod, Vlladimir, Tihomir, Igor, Olga*), por shumica e antroponimisë ruse i përket sistemit grek të emrave, të cilët depërtuan në Rusi nga fundi i shek. X së bashku me krishtërimin dhe ritin e pagëzimit (*Ivan, Aleksei, Vasili, Andrei, Sofia, Aleksandri, Llarisa)*. Krahas emrave të mirëfilltë grekë në gjuhën ruse depërtuan edhe emra me burim latin, hebraik si dhe nga ndonjë gjuhë tjetër (*Viktor, Vitali, Jakovi, Mihaili*). Sot gjejmë edhe huazime nga gjuhët perëndimore, si *Eduard, Artur, Marta, Albert, Leonard*, por ato nuk kanë përhapje të gjerë edhe për shkak të pamundësisë së formimit prej tyre të atësisë me prapashtesat ruse ***–oviç/-jeviç/ -iç***, p.sh. nga emra të tillë, si *Bill, Fransua, Serxhio* etj. është vështirë të formohet komponenti i atësisë.

Si rregull, emrat e përveçëm nuk përkthehen, prandaj në literaturën përkthimore bëhet fjalë për transmetim të njësive antrponimike dhe toponimike dhe jo për përkthim të tyre. Transmetimi bëhet kryesisht nëpërmjet transliterimit dhe transkriptimit. Teknika e transliterimit riprodhon germë pas germe emrat e përveçëm të origjinalit me germat e alfabetit të gjuhës shqipe, ndërsa transkriptimi mbështetet në riprodhimin fonetik sa më afër fjalës së huaj. Këto dy mënyra nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, sidomos kur përkthejmë nga gjuhë me sisteme të ndryshme grafike. Në këto raste transkriptimi dhe transliterimi kryqëzohen, shpërfaqin një lloj simbioze. Po sjellim si shembull mbiemrin Золотарёв**. Nëse do t'i qëndronim besnik shqiptimit të fjalës (veshjes tingullore), do të duhej ta transkriptonim në shqip si** *Zallatarjof*, por kjo nuk ndodh kështu, sepse emri i transkriptuar do të largohej shumë nga forma e tij shkrimore. Teknika e transkriptimit duhet të mbajë parasysh jo vetëm shqiptimin e fjalës, por edhe formën shkrimore të saj. Për këtë arsye varaianti shkrimor i mbiemrit të mësipërm, siç është bërë traditë në përkthimet shqip, do të jetë *Zollotarjov*, ku mbizotëron teknika e transliterimit; i vetmi transkriptim në këtë njësi antroponimike është germa **ë** (*jo*) e rusishtes që shqipes i mungon. Në këto raste kemi të bëjmë me transkriptime a transliterime jo të pastra. Transkriptimi sot shihet si mënyra kryesore e transmetimit të antroponimeve dhe toponimeve, megjithatë kjo teknikë nuk transmeton plotësisht shqiptimin origjinal.

Përzgjedhja e njërës apo tjetrës teknikë është me shumë rëndësi për të pasur një transmetim korrekt të emrave të përveçëm, por kjo është e pamjaftueshme, nëse përkthyesi nuk mban parasysh veçoritë historike, stilistike dhe kulturore të sistemit antroponimik, nëse nuk zotëron mirë kulturën, traditat dhe historinë e dy vendeve.

Është e njohur se gabimet dhe humbjet në përkthim janë të pashmangshme, por detyra e përkthyesit, e redaktorit dhe e botuesit është t'i minimizojë ato në maksimum. Pasaktësitë në përkthim janë të llojllojshme, por në këtë shkrim do të ndalemi në disa gabime a shkelje të normave gjuhësore që lidhen me transmetimin e emrave të përveçëm nga gjuha ruse. Për këtë qëllim kemi vëzhguar përcjelljen e tyre në më shumë se 20 vepra të përkthyera në shqip nga përkthyes të ndryshëm. Objekt i vëzhgimit u bë gjithashtu gjurmimi i traditës së krijuar në kalimin e emrave të përveçëm nga rusishtja në shqip dhe hetimi i prirjeve të përkthyesve për të përdorur njërën a tjetrën teknikë përkthimore. Shkrimi në fjalë synon jo vetëm të rendisë disa zgjidhje përkthimore të gabuara, por në radhë të parë të ofrojë sugjerime a qasje përkthimore më të qëndrueshme, të cilat mund të ndihmojnë në mënjanimin ose minimizimin e gabimeve dhe pasaktësive të vërejtura, pse jo edhe në formulimin hap pas hapi të disa rregullave a parimeve, të cilat mund të çonin në njëfarë standartizimi në transmetimin e emrave të përveçëm.

Edhe pse përkthimi i letërsisë ka filluar në vitet e para të shekullit të kaluar, nga vëzhgimi u vu re se shkrimi i emrave të përveçëm të rusishtes ka mbetur i rrëmujshëm, i hallakatur. Ja disa grupe pasaktësish e gabimesh, të nxjerra nga përkthime e përkthyes të ndryshëm:

1. Prania e dy ose më shumë varianteve përkthimore për të njëjtin antroponim ose toponim tek i njëjti përkthyes në të njëjtën vepër ose te përkthyes të ndryshëm: Дмитр - *Dmitër, Dimitër* dhe *Dhimitër,* Евгений – *Jevgen, Evgen, Eugen* dhe *Eugjen,* Егор - *Jegor dhe Egor,*

Надежда - *Nadezhda dhe Nadjezhda,* Ефимов - *Jefimov dhe Efimov,* Катья - *Katia dhe Katja,* Пётр – *Pjotr dhe Pjotër,* Алексей - *Aleksej dhe Aleksei,* Толстой - *Tolstoj dhe Tolstoi.*

Mbiemri Емельянов, i përmendur 8 herë vetëm në dy faqe të tregimit të A. Tolstoit "Nepërka", është shkruar korrekt vetëm 3 herë (*Emeljanov*), ndërsa 5 herët e tjera gabim (*Emiljanov*). Të dy variantet kanë origjinë të përbashkët (Емельянов vjen nga emri kishtar Емилиан), por juridikisht janë mbiemra të ndryshëm. Nëse në një tekst juridik, fjala vjen, një dokument noterial trashëgimie, ku mbiemri *Emeljanov* do të ishte shkruar edhe në formën *Emiljanov*, dokumenti do të ishte i pavlefshëm, sepse secili variant do të merrej si individ më vete. Paraqitjen e emrit/mbiemrit në dy a më shumë variante unë do ta quaja pakujdesi e mungesë serioziteti të përkthyesit, të cilat në përkthim janë të palejueshme.

Të njëjtën situatë kemi edhe transmetimin e disa njësive toponimike. Toponimi rus Заборье jepet në tri variante, asnjëri i saktë: *Zabori-e, Zaboritje, Zaborije* (për *Zaborje*). Po kështu emërtimet Белогорская (крепость) dhe Белогорский (монастырь) diku është transkriptuar (*kalaja) e* ***Bjellogorskut*** e diku *(manastiri)* ***i Bellogorskit.***

2. Shkelje e traditës përkthimore të ngulitur prej vitesh, sipas së cilës mbaresa ruse –ий ***(-ij)*** tek emrat dhe mbiemrat e gjinisë mashkullore është zëvendësuar në shqip me –***i***: Юрий – *Juri,* Василий - *Vasili,* Маяковский – *Majakovski,* Бродский – *Brodski.*

3. Imitimi nga anglishtja ose nga gjuhë të tjera i transkriptimit të antroponimeve dhe toponimeve: *Liudmilla për Ljudmilla/Ludmilla, Tatiana për Tatjana, Kolia për Kolja, Pliushkin për Pljushkin, Viaçeslav për Vjaçesllav; Biellogorsk për Bjellogorsk, Briansk për Brjansk.*

4. Në raste më të rralla haset humbja e mbaresës së gjinisë femërore ***a*** te mbiemrat: *Tatiana Llosev* për *Tatjana Llosev**a**, Emilia Kabakov* për *Emilia Kabakov**a**.* Një pasaktësi e tillë, nëse nuk është gabim ortografik, është ndikim nga gjuhët perëndimore, ku mbiemri i gruas tingëllon ashtu si mbiemri i burrit. Po të respektohej një rregull i tillë, do të duhej që romani i Tolstoit të quhej *Ana Karenin.*

5. Precedenti i emrit të shkrimtarit të madh rus Лев Толстой (***Lev*** *Tolstoi*), i përkthyer në italishte si *Leone* dhe i huazuar në shqip si ***Leon*** *Tolstoi*, ka shërbyer si shembull negativ imitimi.



Emrat e autorëve, si rregull, nuk përkthehen, por përkthyesi italian, në të drejtën e tij, e ka parë të arsyeshme ta japë të përkthyer (*Leone*). Nëse edhe përkthyesi ynë ka dashuur të përdorë teknikën e përkthimit, në shqip do ishte *Luan Tolstoi* dhe jo *Leon Tolstoi.* I ngulitur gabimisht para 60-70 vitesh ky emër vazhdon të përdoret edhe sot, edhe pse në përkthimet ose ripërkthimet e veprave të Tolstoit ky gabim ka filluar të ndreqet, por precedentin e gjejmë të pësëritur. Në një nga tregimet e përmbledhjes *Tregime & Novela* të A. Çehovit emri i personazhit ***Lev*** *(Trofimoviç)* është përkthyer si ***Leon*** *(Trofimoviç).* Një transmetim i tillë në shqip është tërësisht i pajustifikuar; zoonimi лев i rusishtes përkthehet në shqip ***luan*** dhe jo ***leon***. Madje përkthimi në shqip i emrit të personazhit ka qenë i panevojshëm, sepse *Lev Trofimoviçi* në tregim nuk është personazh kryesor dhe emri i tij nuk ngërthen kuptime a simbolika

të tjera që ndihmojnë në zbërthimin e konceptit të autorit. Për lehtësuar leximin dhe kuptimin e veprës, përkthyesi mund ta përdorë edhe kalkimin e emrit ose të mbiemrit të origjinalit, por rasti i mësipërm është i pavend, aq më tepër që është përkthyer në një gjuhë tjetër.

Mendojmë se disa nga shkaqet që kanë çuar në pasaktësitë e mësipërme janë: vëmendja e pamjaftueshme e përkthyesit ndaj dallimeve që kanë sistemet grafike (alfabetike) të rusishtes dhe shqipes, prirja për të huazuar qorrazi transkriptime nga gjuhë të tjera duke shkelur normat e shqipes, zgjidhjet e nxituara pa u thelluar në veçoritë strukturore, semantike e funksionale të njësive antroponimike e toponimike të originalit. Në mjaft raste zgjidhjet i janë lënë intuitës së përkthyesit. Diku-diku gabimet e mësipërme flasin për mungesë profesionalizmi dhe mangësi në kulturën gjuhësore të përkthyesit. Sjellja e një vepre të huaj letrare në kulturën dhe gjuhën tënde është veprimtari krijuese, e cila, si çdo krijim, kërkon kohë e ritëm të shtruar pune.

Cilat do të ishin disa nga qasjet a sugjerimet që mund të çonin në formulimin e disa rregullave, të cilat do t'u vinin në ndihmë përkthyesve nga rusishtja?

1. Emrat dhe mbiemrat e gjinisë mashkullore që mbajnë në fund me -ий (***-ij***) rekomandohet të shkruhen në shqip me –***i*** dhe jo me –***ij***: Василий – Vasili, Виталий -Vitali, Анатолий – Anatoli, Аркадий – Arkadi, Георгий – Georgi, Григорий – Grigori, Валерий – Valeri, Юрий – Juri; Достоевский – **Dostojevski,** Горький – *Gorki*, Островский – **Ostrovski,** Чуковский – Çukovski, Чайковский - Çajkovski, Паустовский – Paustovski, Вяземский – Vjazemski, Жуковский – Zhukovski, Андреевский – Andrejevski.

Shkrimi emrave të mësipërm me -***ij*** duhet mënjanuar, sepse, së pari, ***j***-ja e shqipes dëgjohet dobët; së dyti, prania e saj në format e tjera rasore vështirëson leximin e emrit: (biseda me) *Vitalijn*, (vepër e) *Gorkijt.*

2. Emrat mashkullorë me -й fundore, së cilës i paraprijnë zanoret -***a*** (-***aй***), -***o*** (-***oй***), -***e*** (-***eй***) shkruhen me –***i***: *Николай – Nikollai, Полевой – Polevoi, Толстой –Tolstoi, Матвей – Matvei, Андрей – Andrei, Сергей – Sergei, Корней – Kornei.*

3. Emrat femërorë që mbarojnë me ***-ия*** duhen shkruar shqip me –***ia***: *Валерия – Valeria, Лидия – Lidia, Мария – Maria, Ксения – Ksenia, Анастасия – Anastasia, Галия – Galia, Наталия – Natalia.*

4. Emrat femërorë që mbarojnë me *–ья* ose *–я* shkruhen me ***-ja***: *Наталья – Natalja, Прасковья – Praskovja, Марья – Marja, Анисья – Anisja, Софья – Sofja, Авдотья –* Avdotja, *Дарья – Darja, Настасья – Nastasja, Ася – Asja, Таня - Tanja, Юля - Julja, Олеся - Olesja, Оля -* Olja.

Ky rregull vlen edhe për format e shkurtra zvogëluese nga emrat mashkullorë: *Володя - Volodja, Вася - Vasja, Витя – Vitja, Митя – Mitja, Ваня – Vanja.*

Shënim: Antroponimet e tipit Наталия dhe Наталья kanë prejardhje të njëjtë, por juridikisht janë emra të ndryshëm, prandaj transmetimi i tyre në përkthim duhet ta pasqyrojë këtë dallim. Është kjo arsyeja që pas vitit 2015 në Rusi janë formuluar rregulla të reja për pasqyrimin e këtij dallimi në transliterimin e emrave rusë me shkronja latine (vetëm për pasaportat për jashtë shtetit, patentat e drejtimit të automjeteve dhe kartat bankare). Transliterimi është standartizuar si më poshtë: Наталия – Nataliia dhe Наталья – Natalia, Мария - Mariia dhe Марья - Maria, Ксения - Kseniia dhe Ксенья - Ksenia, Анастасия - Anastasiia dhe Анастасья – Anastasia.

5. Kur në tekstin original ndeshem më shumë se dy forma përkëdhelëse zvogëluese të emrave (Masha, Машунчик, Marusja, Marijka – nga Maria; Borja, Borka, Borjushka – nga Boris), përkthyesi, për të shmangur rrezikun e perceptimit të tyre si emra të ndryshëm, fut në tekstin e përkthimit vetëm njërën formë.

6. Zanorja я jepet në shqip me ja, pavarësisht nga pozicioni që zë në fjalë: Яков - Jakov, Яковлева - Jakovleva, Зоя Ярёмченко – Zoja Jarjomçenko, Яким Овсянников – Jakim Ovsjanikov, Вячеслав Стоянов - Vjaçesllav Stojanov,



Наталья Добросельская – Natalja Dobroselskaja, Рябин Чистяков - Rjabin Çistjakov, Костя Худяков – Kostja Hudjakov, Наталия Третьякова – Natalia Tretjakova, Святослав Лукьянов – Svjatosllav Llukjanov, Татьяна Звягина – Tatjana Zvjagina, Яна Шаляпина – Jana Shaljapin.

Shënim: Variantet me ia, si: Kolia për Kolja, Tatiana për Tatjana, Viaçeslav për Vjaçeslav, që hasen në përkthime të ndryshme, duhen mënjanuar.

7. Zanorja ruse ё jepet në shqip me jo: Стёпа Ёжиков – Stjopa Jozhikov, Алёна Ёжкина – Aljona Jozhkina, Алёша Воробьёв – Aljosha Vorobjov, Пётр Гринёв - Pjotër Grinjov, Семён Муравёв - Semjon Muravjov, Матрёна Берёзова - Matrjona Berjozova, Вася Тёркин – Vasja Tjorkin, Пётр Тёшкин – Pjotër Tjoshkin.

Shënim: Do të shkruajmë o pas bashkëtingëlloreve ч, ш щ, ж: Горбачёв – Gorbaçov, Пугачёва – Pugaçova, Лихачёв - Lihaçov, Сухачёва – Suhaçova, Симашёв – Simashov, Тимашёв – Timashov, Сущёв – Sushçov, Слащёв – Sllashçov, Стрижёв - Strizhov.

8. Zanorja e jepet në shqip me je: Ельцын - Jelcin, Есперсен – Jespersen, Ломтев – Llomtjev, Григорьев - Grigorjev, Васильев - Vasiljev, Белослав – Bjellosllav, Надежда – Nadjezhda.

Shënim 1: Pas bashkëtingëlloreve do të shkruajmë e shqip në trup të fjalës: Валерий Леденёв - Valeri Ledenjov, Алексей – Aleksei, Мамашев – Mamashev, Ожегов - Ozhegov, Марченко – Marçenko, Чехов – Çehov, Щебякина - Shçebjakina, Стручев- Struçev, Старцева – Starceva, Мальцев – Malcev, Юрцева - Jurceva, Зайцев – Zajcev, Лебедев – Lebedjev, Дементий – Dementi, Женя – Zhenja, Олеся – Olesja, Викентий – Vikenti, Демьян – Demjan, Геннадий – Genadi.

Shënim 2: Shkrimi i zanores ruse e (je) në fillim të fjalës me je ose e është shumë i paqëndrueshëm, krahaso: Jekaterina/Ekaterina Jegor/ Egor, Jershov/Ershov, Jesenin/ Esenin, Jevgeni/Evgeni/Eug(gj) eni, Jevtushenko/Evtushenko, Jermollai/ Ermollai, Jelizaveta/ Elizaveta, Jeremejev/ Eremejev, Jefimov/Efimov, Jermakov/Ermakov, Jermollajev/Ermollajev.

9. Zanorja ю zakonisht jepet në shqip me ju: Юрий - Juri, Юлия – Julia, Юдин - Judin, Ильюшин - Iljushin, Крючкова Krjuçkova, Плюшкин - Pljushkin, Рюмин – Rjumin, Хахрюков – Hahrjukov.

Varianti i transkriptimit në shqip të ю ruse me iu shqipe (Liudmilla, Iliushina, Kriuçkova, Pliushkin, Riumin, Hahriukov), i huazuar nga gjuhët perëndimore, në shqip









lexohet me vështirësi, prandaj duhet mënjanuar.

10. Shqiptimi i bashkëtingëllores ruse x është i ndryshëm nga h e shqipes, por është germa më e afërt me të: Тихон Хренников – Tihon Hrenikov, Михаил Захаров - Mihail Zaharov Прохор Хомяков – Prohor Homjakov, Миха Харченко - Miha Harçenko, Архип Харитонович - *Arhip Haritonoviç,* Дмитрий Разумихин - *Dimitri Razumihin.*

Variantet e zëvendësimit të fonemave të shqipes, të përafërta me rusishten (***h*** për ***x***, ***ju*** për ***ю***) me transkriptime të huazuara nga gjuha angleze (përkatësisht ***kh*** dhe ***iu***: *Mikhail, Liudmilla, Kharçenko)* duhen mënjanuar. Një përkthim i tillë do t'i ngjante një sallate të përzier me disa përbërës: emri/mbiemri i përveçëm rus, transkriptimi anglisht, gjuha e përkthimit shqip.

11. I paqëndrueshëm ka mbetur shkrimi i emrave të përveçëm të rusishtes me bashkëtingëlloren л (***ll***), edhe pse në "Drejtshkrimin e gjuhës shqipe" (1973) është vendosur të shkruhen me ***l*** të gjithë emrat e gjuhëve sllave, pavarësisht shqiptimit të ***l*** në këto gjuhë (*Lugansk Bajkal, Milosh, Ladoga, Lomonosov,* etj.). Ky rregull drejtshkrimor në përkthimet e shqyrtuara diku është respektuar e diku jo. Ja disa shembuj*: Mihail, Lolita, Luiza, Vladimir, Vjaçeslav, Lzhedimitri; Sollzhenicin, Dovllatov, Llotman, Ludmilla, Ciollkovski, Llarisa, Vollodia, Lluçezar, Zabollocki, Stanisllav, Vollkov, Llazar.*

Lind pyetja: pse autorët e "Drejtshkrimit..." kanë lënë jashtë emra nga gjuhë të tjera, fjala vjen, *Bill* (nga anglishtja), *Ballkan* (nga turqishtja), të cilët i shqiptojmë dhe e shkruajmë me ***ll,*** ndërsa emërtimin Балтийское море duhet ta shkruajmë *Deti Baltik*; ose pse duhet të shkruajmë për rusishten *Nikolai, Lazar* kur në shqip shkruajmë dhe shqiptojmë *Nikolla, Nikollai. Llazar, Llazi.* Mendoj se do të varet nga përkthyesi, nëse do të shkruaj *Stanisllav ose Stanislav, Llopuhova ose Lopuhova, Vollga ose Volga, Vollgograd ose Volgograd, Povollzhje ose Povlzhje,.*

12. Toponimet:

a. Toponimet ruse që mbarojnë me -ье në shqip është e rekomandueshme të jepen me ***-je***: Зарядье – *Zarjadje,* Заборье – *Zaborje,* Задорожье – *Zadorozhje,* Приморье – *Primorje,* Дубовичье – Duboviçje, Медвежье – Medvezhdje, Заполярье - *Zapolarje,* Полесье – *Polesje.* Поволжье - *Povollzhje* (Variantet e tipit Zarjadije, Zarjadie, Duboviçije, Duboviçie janë të papërshtatshme).

b. Toponimet ruse që mbarojnë me elementet ***–ск*** dhe ***–цк,*** në trajtën e shquar të shqipes marrin - ***u*** (***–sku*** dhe ***–cku)***: Архангельск – *Arhangelsk-u,* Брянск – Brjansk-u, Белогорск – *Bjellogorsk-u,* Иркутск - *Irkutsku-u,* Курск – Kursk-u, Смоленск – *Smolensk-u,* Луганск -*Lugansk-u,* Новороссийск – Novorosijsk-u, Новосибирск – Novosibirsk-u, Липецк – *Lipeck-u,* Донецк – *Doneck-u.*

c. *Për toponimet rusishtes me* ***x*** *në fillim ose në trup të fjalës, në shqip duhet ruajtur tradita e shkrimit më* ***h*** *të shqipes:* Хабаровск – *Habarovsk,* Харкив - *Harkiv,* Херсон – *Herson,* Астрахань - *Astrahan,* Сахалин – *Sahalin,* Махачкала – *Mahaçkala.* Variantet *Khabarovsk, Kharkiv, Kherson, Astrakhan, Sakhalin, Bakhmut* janë imitime transkriptimesh të papranueshme për dëgjuesin dhe lexuesin shqiptar.

d. Transkriptohen gabim nga rusishtja disa mbiemra ose toponime të gjuhëve të tjera sllave me alfabet cirilik (bullgarishtja, serbishtja). Mbiemri bullgar Първанов ose toponimi Велико-Търново për mungesë të zanores ë në rusishte transkriptohet me zanoren –ы: Пырванов, Велико-Тырново. Këto dy njësi duhen dhënë në shqip jo nga transkriptimi i rusishtes (*Pirvanov, Veliko-Tirnovo*), por me transliterim të drejtpërdrejtë nga bullgarishtja, përderisa edhe bullgarishtja, edhe shqipja janë të pajisur me zanoren ë: *Përvanov, Veliko-Tërnovo.* Mbiemri serb Вучић, i transkriptuar në rusisht Вучич, në gjuhën shqipe, për arsye etike, duhet shkruar me ç (*Vuçiç*) dhe jo me ***q*** *Vuçi**q**,ndonjëherë Vuqiq* (takova *Vuqiqin,* i thashë *Vuqiqit*). Për të mos rrëshqitur në banalitet edhe mbiemri Пысин duhet transkriptuar në shqip jo me ***i*** (P**i**sin), por me një zanore të përafërt me të, *Pësin* ose *Pysin.*

Krahas transkriptimit dhe transliterimit të njësive antroponimike dhe toponimike, në praktikën përkthimore përdoret edhe kalkimi (përkthimi). Zakonisht kalkohen emërtimet, si: Ладожское озеро – Liqeni i Ladogës, Черное море – Deti i Zi, Зимний дворец – Pallati i Dimrit etj. Këto raste përcillen lehtë në përkthim. Detyra e përkthyesit bëhet me e vështirë në rastet, kur ai duhet të përcjellë emra, mbiemra të përveçëm, të krijuar nga vetë autori i veprës, të cilët, krahas funksionit emërtues, identifikues, kanë edhe ngarkesa të tjera kuptimore e stilistike që ndihmojnë në zbërthimin e idesë së autorit, si: *Sobakieviç* (nga qen, me prirje qeni), *Svistunov* (nga fishkëllimë), *Pugovicin* (nga kopsë), *Pravdin* (nga e vërtetë), *Bosoj* (*nga* këmbëzbathur), *Krisoboj* (nga vrasës minjsh). Në shumicën e rasteve ato transkriptohen, por me teknikën e transkriptimit në përkthim humbet e gjithë ngarkesa që mbart emri. Për të ruajtur këtë informacion disa përkthyes përdorin kalkimin. Le shqyrtojmë sa për ilustrim një rast ku kalkimi ka qenë zgjidhje përktimore e pastudiuar mirë nga përkthyesi.

Në novelën e Bullgakovit "Zemër qeni" funksioni i nofkës së qenit Sharik është i veçantë, sepse prej saj buron mbiemri i përveçëm *Sharikov.* Autori e përshkruan Sharikun si qen endacak, trupvogël, topolak, pushator, por i ushqyer mirë. Këtë mbiemër qeni e mori kur u shndërrua në njeri pas transplantit të hipofizës. Si njeri Sharikov filloi të sillej si dhuruesi i organit me *të gjitha veset e* tij. Pikërisht emrin e këtij personazhi kryesor përkthyesi e ka shqipëruar si *Rrumbullaku.* Kur Rrumbullaku shndërrohet pas operacionit në njeri, përkthyesi i shton emrit prapashtesën ruse ***ov*** dhe në vend të mbiemrit rus *Sharikov* përdor mbiemrin shqip *Rrumbullakov*. Përkthimi i nofkës ruse Sharik në këtë rast është i padobishëm, sepse, veçse të vret veshin, sidomos kur antroponimi përmendet i plotë *Poligraf Poligrafoviç Rrumbullokov*, por edhe sepse emri shqip *Rrumbullaku* nuk i thotë asgjë më shumë lexuesit se përshkrimi i autorit.

Nga sa u parashtrua më sipër, mund të bëhet ndonjë përgjithësim:

Para përzgjedhjes së teknikave përkthimore duhet bërë studimi paraprak kulturologjik i tekstit. Vetëm pasi përkthyesi bindet për përkatësinë kombëtare gjuhësore të antroponimit ose toponimit vendos për mënyrat e transmetimit. Zgjedhja e teknikës përkthimore duhet të mbajë parasysh të gjithë komponetët e formës dhe të përmbajtjes së njësisë antroponimike. Emri i përveçëm i transkriptuar duhet të shqiptohet pa vështirësi dhe të ketë tingëllim të pranueshëm. Është me shumë rëndësi që transmetimi i njësive antroponimike dhe toponimike të ruajë sa është e mundur shqiptimin si në origjinal, pa iu larguar shumë formës shkrimore të emrit.

Pavarësisht përshtypjes se njësitë antroponimike dhe toponimike përcillen lehtë në përkthim, përkthyesi profesionist e fillon përkthimin vetëm pasi njihet hollësisht me të gjithë informacionin e nevojshëm.

Shënime për librin "Fjalimet që përgjakën Ballkanin: Analizë retorike e fjalimeve të Millosheviqit", të autorit Gëzim Mekuli (Prishtinë: Alphabet J&H, 2022)

LUFTËRAT NË ISH-JUGOSLLAVI NISËN ME PËRNDEZJEN E FJALËVE

Nga Enis Sulstarova

Ne, shqiptarët, duhet të kujtojmë. Është detyrim kujtesa për dramat kolektive që na kanë ndodhur. Për pjesën më të madhe të historisë së kombit tonë varemi nga dokumentet që kanë prodhuar të tjerët për ne. Edhe në shek. XX, kur krijuam institucionet tona shkencore e kulturore, na mungonte liria e fjalës. Disa të vërteta, si p.sh. Masakrën e Tivarit, duhej t'i bisedonim me zë të ulët dhe me njerëz të besuar. Po kështu, indoktrinimi ideologjik shpeshherë e bënte të pamundur pranimin e së vërtetës dhe të fakteve. Tani jemi në kushte më të mira, sepse studiuesit që punojnë në disiplina të ndryshme kanë lirinë dhe mundësitë që t'i përdorin teoritë e metodologjitë bashkëkohore për t'iu qasur të kaluarës dhe për të dhënë ndihmesë në kultivimin e kujtesës kolektive.

Libri "Fjalimet që përgjakën Ballkanin", i autorit Gëzim Mekuli, gazetar i mirënjohur dhe studiues i shkencave të komunikimit, na çon mbrapa disa dekada për të na kujtuar se luftërat në ish-Jugosllavi më së pari nisën me përndezjen e fjalëve. Sikurse shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore nuk mund të shihet i shkëputur prej fjalimeve të Hitlerit nëpër tavernat dhe sheshet e Gjermanisë, po ashtu edhe fillimi i shkatërrimit të Jugosllavisë mund të gjurmohet te fjalimet luftënxitëse të Sllobodan Millosheviqit. Fuqia mistike e fjalës, e cila mund të ngrejë në këmbë një popull të tërë, ka tërhequr interesimin e Mekulit për të studiuar, nga këndvështrimi i retorikës dhe i shkencave të komunikimit, disa fjalime që Millosheviqi ka mbajtur në fillim dhe në fund të karrierës së tij politike. Sigurisht që vetëm fjala në vetvete nuk mjafton, sepse, siç e vëren Mekuli, që fjala të prekë "telat" e shpirtit të një populli, ajo duhet të thuhet në çastin e duhur e në mënyrën e duhur dhe gjithashtu të përhapet sa më gjerë përmes mediave. Që fjala të bëjë ndryshimin, kërkohet publiku retorik dhe situata e duhur retorike (f. 29-30). Duke cituar nga studiues të ndryshëm, që kanë hulumtuar marrëdhënien e retorikës me kontekstin politik dhe shoqëror, autori ka ndërtuar një aparat konceptual me të cilin i analizon fjalimet e Millosheviqit. Në qendër të këtij aparati ndodhen togfjalëshat që përsëriten më shpesh dhe që në mendjet e dëgjuesve ndërtojnë një botë fantastike, ku përleshen forcat e së mirës (zotit) me forcat e së keqes (djallit). Nëse politikani ia del të ndërtojë një botë imagjinare, që i mbivendoset botës reale dhe që besohet nga pasuesit e tij, atëherë ai i zotëron shpirtrat e këtyre dhe mund t'i tërheqë pas projektit të vet politik. Sigurisht që përndezja emocionale nuk zgjat përgjithmonë, sepse vjen një çast dhe realiteti bëhet kaq i shpërputhshëm me imagjinatën, saqë pasuesit ose, së paku një pjesë e tyre, kthjellohen dhe "ftohen". Kjo duhet qartë në dy prej fjalimeve që Millosheviqi i ka mbajtur gjatë viteve të fundit në pushtet dhe që Mekuli i ka veçuar për t'i analizuar.

Studimi i Mekulit përqendrohet në tri fjalime të Millosheviqit. I pari dhe më i rëndësishmi syresh është fjalimi në Gazimestan më 28 qershor 1989, i dyti është fjalimi në 10 qershor 1999, i mbajtur në Beograd pas përfundimit të luftës midis Jugosllavisë dhe NATO-s, dhe i treti është fjalimi në Beograd në vitin 2000, pas humbjes së zgjedhjeve parlamentare. Fjalimi në Gazimestan është cilësuar si programatik, sepse mbahej me rastin e 600-vjetorit të Betejës së Fushë-Kosovës, ndoshta miti më i rëndësishëm i nacionalizmit serb, dhe paralajmëronte projektin e Millosheviqit për t'ia nënshtruar Jugosllavinë interesave serbe. Mbi një milionë serbë morën pjesë në tubimin e Gazimestanit, përfshirë klerikë dhe pelegrinë ortodoksë që nderonin reliktet e princit Llazar që u vra në Betejën e Fushë-Kosovës dhe që u shpall martir i Kishës Serbe. Tubimi u transmetua drejtpërdrejt nga RTV Beograd.

Siç vëren Mekuli në analizën e retorikës së fjalimit të Millosheviqit, ky i fundit shfrytëzoi simbolikën diakronike për t'i thënë publikut serb se Kosova është zemra e Serbisë dhe se gjoja ishte e shkëputur nga trupi i Serbisë, prandaj ringritja e Serbisë po ndodhte pikërisht në atë çast në Fushë-Kosovë, ku ishte flijuar edhe princi Llazar. Nëse beteja para 600 vjetëve u humb për shkak se midis princave serbë mungonte uniteti, tani Serbia ishte unike dhe kërkonte të drejtat e saj "të mohuara" në Jugosllavinë socialiste. Serbët, jo vetëm në Kosovë, por kudo në Jugosllavi, do të kërkonin që "gjymtyrët" e ndara t'i bashkoheshin trupit të Serbisë. Me këtë fjalim, të ngopur me imazhe fetare, Millosheviqi i ftoi serbët që ta ndiqnin në një "luftë të shenjtë" dhe shumë prej tyre i shkuan pas atij, duke e kujtuar për mishërim të Car Llazarit (f. 74).

Pothuaj dhjetë vjet më pas, Millosheviqi mbajti një fjalim në Beograd, për të shënuar përfundimin e luftës së Jugosllavisë me NATO-n. Fjalimi i Millosheviqit nuk u ndoq nga më shumë se 50.000 pjesëmarrës në shesh, shumë më pak se turma e mbledhur në Gazimestan, por është domethënës fakti se ai nuk u botua në shumë prej gazetave të kohës dhe disa media televizive e transmetuan të përmbledhur. Për sa i përket situatës retorike, bashkimi i serbëve në një Serbi të Madhe nuk kishte ndodhur. Një pjesë e mirë e serbëve ishin përzënë nga Kroacia, Bosnjë-Hercegovina ishte shtet i pavarur dhe serbët atje kishin arritur të njiheshin si një njësi përbërëse e federatës. Në Mal të Zi ishte formuar një tendencë e qartë politike për daljen nga partneriteti me Serbinë dhe në Kosovë po hynin trupat e NATO-s. Epilogu i luftërave që serbët ndezën në Jugosllavi shënohej nga ndërtesat e shkatërruara në mes të Beogradit.

Mekuli shkruan se "e gjithë bota e Millosheviqit, sistemi i ngritur prej tij, u shpërbë me lehtësi të pabesueshme, krejt ndryshe nga pretendimet e tij të dikurshme. Pra, situata retorike kishte një *problem të ngutshëm* dhe ky duhej të zgjidhej përmes gjuhës (komunikimit)" (f. 104). Dukej sikur Millosheviqin po e ndiqte pas fati i princit Llazar, që në Kosovë e humbi "mbretërinë tokësore", prandaj në fjalimin e tij ai i mëshonte idesë se ia kishte dalë ta ruante sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën. Tema qendrore e fjalimit është se populli serb duhet ta ndjejë veten fitimtar, sepse tregoi se mund t'i qëndronte me vetëmohim "agresionit" të NATO-s. Në Gazimestan, Millosheviqi kishte thënë se serbët në Betejën e Fushë-Kosovës e kishin mbrojtur Perëndimin ndaj islamit, duke aluduar se këtë rol ata kryenin sërish. Dhjetë vjet më pas ai thotë se lufta e serbëve kundër NATO-s po jep ndihmesë në krijimin e një bote multipolare. Pra, Perëndimi tani nuk përfaqëson më vlerat për të cilat serbët janë flijuar. Nga aleat i serbëve kundër fundamentalizmit islamik, Perëndimi është shndërruar në vetë "djallin" (f. 124-125). Millosheviqi i paraqet serbët si viktimë dhe askund në fjalimin e tij



nuk përmenden viktimat shqiptare të makinerinë ushtarake serbe, të udhëhequr prej tij. Përkundrazi, siç e vëren Mekuli, Millosheviqi përpiqet që imazhi i ushtrisë serbe të shkëlqejë ("Ushtria jonë është e pathyeshme dhe më e mira në botë"; "Populli ishte ushtri dhe ushtria ishte popull").

Fjalimi i tretë që Mekuli merr në analizë u mbajt menjëherë pasi Millosheviqi kishte pësuar humbje në zgjedhjet presidenciale të vitit 2000. Ai nuk e pranoi rezultatin e raundit të parë të zgjedhjeve dhe u përpoq që të mbante pushtetin, por qeveria e tij u rrëzua disa ditë më pas, si rezultat i protestave popullore. Tema e fjalimit para një publiku prej jo më shumë se 30,000 vetave është se si Serbia po sulmohet nga Perëndimi dhe nga "tradhtarët" e opozitës. Millosheviqi i përshkruan shtetit dhe kombit serb një funksion "kundërimperialist" dhe paralajmëron se nëse serbët nuk rezistojnë, ekziston rreziku i pavarësimit të Kosovës dhe i largimit të Malit të Zi nga federata. Madje, edhe vetë Serbia mund të shpërbëhet me shkëputjen e Sanxhakut dhe të Vojvodinës: "Territori që do t'i lihej ta mbante emrin Serbi, do të pushtohej nga forcat ndërkombëtare, SHBA apo ndonjë shtet tjetër. Ata do ta trajtonin tokën tonë si terren të tyre të stërvitjeve ushtarake, si rezervat të tyre privat, për t'u kontrolluar në përputhje me interesat e fuqisë pushtuese" (f. 135).

Me këtë retorikë të mbjelljes së frikës se identiteti i kombit serb do të shuhej si pasojë e kolonizimit të Serbisë, Millosheviqi përpiqet ta bindë publikun se ardhja në pushtet e opozitës serbe do të sjellë dhunë dhe luftë. Sërish serbët paraqiten si viktima të padrejtësive historike dhe se vetëm uniteti kombëtar mund t'i shpëtojë. Mekuli veçon faktin se Millosheviqi, në fjalimin e tij, përdor edhe kritikën ndaj kulturës konsumeriste perëndimore, të cilën ia shton edhe kritikës "kundërimperialiste" (f. 146). Të dyja kritikat gërshetohen në fjalim në mënyrë që Perëndimi së bashku me opozitën të portretizohen si "demonët" që duan të rrënojnë "popullin qiellor" serb. Mekuli vë në dukje se e fjalimi i tretë është më i gjatë se të parët, sepse Millosheviqit i duhet të përdorë më shumë retorikë në mënyrë që ta kthejë publikun, tashmë mosbesues, në anën e tij. Mirëpo, Millosheviqi nuk ishte më në gjendje ta kontrollonte shpërndarjen e mesazhit në publikun serb, për të cilin mediat më të besueshme ishin ato opozitare, të cilat po e nxisnin popullin për t'i dhënë fund sundimit të Millosheviqit. Ai perceptohej si një diktator, edhe pse një dekadë më parë shumica e serbëve e kishin brohoritur si shpëtimtarin e tyre.

Analiza e Mekulit është e pasur dhe e shkruar me një gjuhë të rrjedhshme. Referencat shkencore janë të përqendruara sidomos në dy kapitujt e parë, por kjo nuk do të thotë se leximi i tyre është i vështirë. Përkundrazi, përmendja e autorëve dhe e teorive të retorikës, që nga Aristoteli e deri në ditët tona, ndjek një linjë logjike dhe të qartë. Libri i Gëzim Mekulit "Fjalimet që përgjakën Ballkanin" është një lexim i nevojshëm për studentët dhe studiuesit e shkencave të komunikimit, të historisë dhe të një publiku të interesuar për marrëdhëniet midis retorikës, ideologjive dhe pushtetit në Ballkan.

"Vdekja e Omerit", roman nga Adil Olluri

KUR I VDES ORA QYTETIT

Nga Arbër Ahmetaj

Titulli i ngjan më shumë këngës te "Cikli i Kreshnikëve" e mund të ishte edhe "Vrasja e Omerit". Në fund të fundit, rezultati është i rëndësishëm. Një i ri vdes nën plumbat e një atentatori, e një armiku të përbetuar, e një vrasësi me pagesë. Apo e gjitha kjo është një sajesë? Në fakt, nga ana shkencore nuk ka një ekzaminim kriminalistik, që përcakton shkakun e vdekjes, madje s'ka as akt formal zyrtar për vdekjen e tij. Rrjedhimisht ka më shumë supozime sesa konfirmime.

Një tjetër gjë i afrohet së vërtetës absolute: qytetit, ku zhvillohen ngjarjet, i ka vdekur ora!

Duke mos qenë roman policor i mirëfilltë, nga ata ku ndodh një krim e dikush nga organet e hetimit shtetëror ose privat interesohet nga fillimi deri në fund të zbardhë enigmën, ky roman anon pak më tepër nga zhanri i romanit psikologjik, ku analizohet natyra e krimit dhe kriminelit, zbulohen ose jo arsyet e deformimeve psikike të vrasësit apo tiparet që e shndërrojnë viktimën në pre të vrasësit. Romani është vërtet i shkurtër e numri i ngjarjeve është tmerrësisht i kufizuar: një vrasje, një hetim i lënë përgjysmë dhe jehona e thashethemeve rreth tyre. Ngritja e hipotezave, vënia e tyre në pikëpyetje nga dështmitarë të tjerë dhe marrja në pyetje e dështmitarëve, sado gjysmake, sjellin në roman atmosferën e qytetit.

Në fakt, para se të jetë i një gjinie të përcaktuar, ky është një roman atmosfere, ku as krimet, as vrasësit, aq më pak autoritetet, nuk arrijnë të bëhen personazhe. Gjithçka bie në hije nga atmosfera e rëndë dhe mbytëse që krijohet në shoqëri të tilla, ku asnjë princip moral nuk njihet më, ku ligji dhe autoriteti shtetëror janë privatizuar e përvetësuar nga mujsharët, ku njeriu i thjeshtë, qytetari që ëndërron të krijojë jetën e tij të qetë e të ndershme, s'është asgjë, madje është më i lig, më i pamoralshëm dhe i padobishëm se vetë vrasësit dhe *karaduzët* e armatosur me para, influencë e pushtet mafioz.

Nga pikëpamja e shkrimit, teknika e shikimit të së njëjtës ngjarje nga shumë kënde, nga shumë personazhe, ani pse jo e re, është përdorur pothuajse me sukses, duke i dhënë rrëfimit një dinamizëm të kënaqshëm, gjë që do të kishte qenë shumë më tërheqëse sikur në faqet e para të romanit, autori të mos ishte aq i pranishëm, madje disa herë edhe në veten e parë të numrit shumës, si: "Me anë të këtij libri nuk do të lajmërojmë, por do të shpjegojmë". Kjo mund të ishte shmangur me një redaktim të kujdesshëm e ujërat e faqeve të para të romanit do ishin kulluar para se të printohej libri.

Gjithsesi, krijimi i personazheve komplekse e të paraqitura kështu në formë poliedri, siç i shohin qytetarët e tjerë, përbën një sfidë të fortë për çdo prozator, sado me përvojë, e unë si lexues e gjej Mujdin Rexhepagën, Mujën, siç e thërrasin në roman babën e Omerit, një personazh thellësisht të realizuar, një njeri që e kemi nëpër këmbë në shoqërinë tonë prej shekujsh; është njeriu që pasurohet jo veç se është i zoti, por se u zë frymën të tjerëve, bën si i ditur, bën si i fortë, por në fakt është i brishtë dhe frikacak. E ani pse mund të vrasë e të paguajë vrasje, kur një gjëmë si vdekja e të birit i bie mbi krye, i paraqitet lexuesit me krejt njerëzinë, dobësinë dhe ndjeshmërinë e vet.

Kapitulli i parafundit i romanit titullohet: "Monologu i Mujës pranë varrit të Omerit". Po të kishte qenë: "Vaji i Mujit te vorri i Omerit", përkitjet me këngët e kreshnikëve, që i ka sjellë me delikatesë në roman, do të kishin shkëlqyer edhe më shumë.

Sipas të dhënave në *web*, Adil Olluri deri më tash ka shkruar dy romane, dy libra me tregime dhe një studim letrar. Sa do të na bëjë për vete në të ardhmen me prozën e tij? Revista Letrare do ta ndjekë këtë "affair" e do t'ju informojë!

BRENDA HESHTJES

cikël poetik nga ERMIRA MITRE KOKOMANI

TË PISH ME CHARLES BUKOWSKIN

Ai më përshëndet.
Jam e vetmja spektatore në sallë.
Koka e tij, me venat e fryra
që shquhen në tëmtha,
peshon shumë,
rënduar nga vargjet
që herë këndojnë, herë qeshin
e përleshen.
Heshtja pi birrë me Atë,
ndërsa unë pi verë me heshtjen e tij,
dhe shetis mëndjes të gjej shtegun
për të thyer perden e akullt mes nesh:
"Ç'shije ka birra juaj, Charles?"
"Të dëshpëruar,
nga debati presidencial natën e shkuar. "
"Po vera jote, Vogëlsi?"
"Të thartë,
prej rrushit të prushëzuar në Kaliforni"
"Charles, a e keni shigjetën tuaj atje lart?
"Po, Vogëlsi, po, e kam,
por jo për ti gjuajtur Perëndisë.
E kam mprehur të shënjoj
racën e prishur atje poshtë, tek Ti ".
"Vogëlsi,
dua të të them se
nuk i kursej këshillat e mia,
ti kursesh ato, i bën inegzistente.
Edhe kur nuk jam aty
ofroj pjesën time të shpirtit që larg,
për të mos i bërë gjërat shtrembër.
Si për shëmbull:
të bini përsëri në dështim,
në dëshpërim,
në regres elektoral,
të bëni një tjetër Hiroshima,
apo të ndodhë një tjetër Pearl Harbor.
Pastaj
të rrokulliseni nga maja tëposhtë
e si një zar i humbur
të përplaseni diku, në vetmi.

Nëntor 2020

IKJA

E lashë Durrësin.
Ikja këputi në mes melodinë
e erës që më harbonte flokët,
sirenat e anijeve, lëvizjen e trenave,
që i ndiznin gjakun ujit edhe tokës.

Ikja më ndau me trokitjen
e korit të hapave në kalldrëm,
me spektatoret e trotuarëve që digjeshin
në afshin e mbrëmjeve muzgjezjarrta.
me dallgët e të qeshurës së hazdisur në plazh,
me kalatë e rërës që mi shëmbte vala,

Ikja më vodhi një mik të ujshëm,
që më ftonte të vallëzoja,
të tretesha në trupin e tij si kripë,
ku herë bëhesha dorëvalë përkëdhelëse
mbi bedenat e kalasë që kish përpirë,
tek pyesja etërit ç'u ngeli peng më shumë.
Herë-herë bëhesha rrymë e fortë,
që humbisja thellësive,
të gjeja ç'mister fshihte
në trupin e ujshëm ai mik.

Të gjeja ku e ka zemrën?
Ç'farë e lumturon, e zemëron atë,
ku i fsheh dhimbjet, po lotët,
dashuritë ku i fsheh?
Po gjerdanet e florinjtë
pse ja rrëmben gjoksit të vajzave,
pse çifteve ja nxjerr prej gishtit unazat,
mos vallë kështu i shpreh dashuritë?
Në ç'stomak i bluan tragjeditë,
po mëkatin e dhimbjes së të mbyturve?
Varret e tyre vallë ku i fsheh,
a mundem të ndez për ta nën ujë një qiri?
Po peshqit, algat, koralet, ku i rrit,
po gjarpërinjtë, peshkaqenët
në ç'hulli të barkut i fsheh para sulmit?

E lashë Durrësin,
ikja më vodhi një mik të ujshëm,
që më ftonte të vallëzoja
të dëfreja, të ngazëlleja si delfin,
e të harroja rënkimet.

Ah, ikja është si gur i ashpër,
ngado që ta kthesh të gërvisht,
një pjesë zemre ma vari hajmali
në farin tek Kodra e Vilës.
Ajo akoma më pret, si fari,
derisa unë shtegtari
edhe me gjysëm anije,
të kthehem në Durrës përsëri.

Gusht 2021

RRËFEN ME BINDJE

Kumbulla e purpurt të shikon,
e zhveshur nudo,
e paturpshme, në lakuriqësinë e saj,
qëndron aty,
ngulur mbi pëllëmbë
si statujë shtatzënë,
gdhendur nga majat e gishtrinjve,
endur ndër damare,
tuli ndihet i pjekur,
i ëmbël, i freskët, i ngazëlluar.
Ajo është vetvetja,
brenda trupit të saj të paprekur.

Në pikëllim,
ngre krye uria,
ndjesi gërryese,
në heshtje, zvarritet
mbi trupin e purpurt,
me qetësi i ngul dhëmbët ethshëm,
në kërkim të atij intimiteti,
sa të lashtë aq dhe të virgjër.

Ajrit kumbojnë thela zhurme,
lëngu vërshon me vrull,
të derdhet në boshësinë e gojës së uritur,
si ujërat e mitrës në praglindje,
ndërsa tuli bëhet instrumenti
që stomaku yt i ndryshkur,
të këndojë ekstazë psikodelike,
e Uria, kjo monarke e heshtur,
të dorëzohet tërësisht,
si lehona pas lindjes.
Ndaj, rrëfen me bindje,
Uria: ndjesi që mund të zhbëhet.

Janar 2022

PASQYRA KONVEKSE

Të jesh bashkë me ty në një dhomë,
është si të shihesh në pasqyrë konvekse.
Të kërkoj shpesh të ndryshosh sjelljen,
fokusin tënd prej valësh negative
që largojnë dritën.
Edhe muret pajtohen me mua,
dëshmitarë të lojës tënde dinake.
Shikimi yt shpues si majë shpate
e mprehur mirë, ngutet të presë
kordën e neuronit në tru,
që më lidh gjuhën e mendimin,
vetëm për ti mashtruar
të shthuren e bien në kurthin e ngritur
prej dërdëllitjesh absurde.

Ndryshe,
si grua Viktoriane në kohët moderne,
thërras në subkoshiencë rezistencën,
të m'i burgosë mendimet
në kafazin e mëndjes,
në mushkëri të paraburgosë frymën,
të më prangosë lopatën vozitëse të mishit,
midis mure nofullash
për të mos nxjerrë goje korrupsion.

Prapa pasqyrës që përpara shndrin,
ngre kokën ana e errët dhe e zymtë
e zhivës helmuese të mendimeve të tua,
që ma deformon, ma devijon fytyrën,
dhe nënçmon bukurinë e virtytshme.

E shoh hijen tënde të lëvizë,
gjurmë montazhi të karakterit tënd,
fshehur pas xhamit të pasqyrës konvekse,
është "fuqia e syrit të tretë", intuitë
që ti vështirë se mund ta rrokësh.

Fatkeqësisht,
Ti kalon çdo ditë para meje,
e unë të vështroj qetësisht dhe kokën tund,
thelbin tim mbështjell në monolog
heshtjeje,
si mundet të shkëlqejë Egoja kaq shumë,
me tërë honin e mbrapshtisë së pafund,
e si mollë t'ju hajë, kafshatë pas kafshate,
derisa të mos mbetet më pulp,
por veç thelbi i fortë që mbron farat,
në prag fundosjeje.

Por, dhëmbëve të tua egoiste
u mungon guximi
për të thyer thelbin,
këtë substancë të fortë.
Ata mbajnë brënda kaq shumë frikë,
Unë jo!
Thelbi mbetet Rezistencë ndaj
Korrupsionit!

Mendimet e tua të baltosura,
frenojnë reagimin tim, të pafjalë,
ndaj të ofroj kullën time të forcës,
kridhem brënda vetes heshtjerëndë,
dhe ty të shoqëroj bashkë me të.

Ajo lëviz në drejtim të kundërt nga ti,
han përbrënda cipet e qetësisë,
sikur ha mollën e humbjes,
në skaj të ekzistencës,
pak nga pak, përtypje pas përtypjesh,
derisa arrin thellë të zbulojë veten,
të prekë thelbin tim të fortë,
që mban ngjizur brënda
farat njërëzore të rilindjes dhe shpresës.

Lukthin tim prek dhe dëgjoj
t' iu përgjigjet mendimeve të tua
përçmuese,
"kjo bërthamë mbetet e paprekur për të
rikrijuar".
A e dëgjon? Nëse jo, mbaj vesh:
heshtja ime është kështjella e fortë
që të bën ty të dështosh,
ti nuk mund ta shembësh,
ta rrahësh heshtjen,
apo ta shprishësh shpirtin tim të hollë.

Egoja jote nuk mund ta zhbëjë shpirtin
kurrë,
thelbi im i paprekur të refuzon zëlartë,
edhe nëse guxon lëkurën të më rjepësh,
dhe kockat në pluhur të mi bluash,
apo lëngun e kuq të venave të mia ta pish,
si vera më e rrallë që të ka shijuar,
në filxhanin prej porcelani japonez,
me të cilin ti ujisje trëndafilat
të vetmet qënie që je kujdesur gjer më sot.

Edhe sikur të guxosh të më kthesh në hi,
shpirti im i dlirë do të ngrihet përsëri
do të fluturojë si feniks
të djegë shikimin tënd përvëlues,
e të shkrijë metalin e helmët të pasqyrës.
Pastaj, do të ketë qetësi në dhomë,
muret do të gëzohen dhe do të buzëqeshin
ndërsa ti mungon.

Prill 2020

BRENDA HESHTJES

Mëngjes,
jashtë ndihet fishkëllima e erës
brenda
zien ibriku i cajit mbi stofe,
midis nesh ngrihet
një shtëllungë ajri e ftohtë.

Frymojmë,
brenda heshtjes së njëri tjetrit;
lëvizim neper kuinta
si somnanbulë të hershëm
heshtja
hedhur trupit, zhgun murgu,
grryen muret e perbrendeshme.

Ndez serish nje cigare,
hirin e heshtur e te pajete ,
ja shkund aty per aty,
flas me te, për shoqeri,
nuk eshte aspak kapricioze si ty,
nuk kerkon asgje,
vec shkak per te bere drite.

Fjollat e tymit,
flegra shpirti qe shpervilen
here me mbysin,
here me permendin sfiden e instiktit,
mbi buze,
vetem ajo mbetet besnike,
mi ben drite shpirtit.

Shkurt 2023

EJA VALËZ

Eja valëz luaj me tharmin e shpirtit,
që piklon guaskash,
eja përkëdhelmë, si farfurimë drite,
aty ku rrekemi, shtegtarë të përhershëm,
mes detesh, kontinentesh,
shpirtin ngima me një gotë verë të vjetër.

Eja valëz, shkumbëzo mbi mua,
lëmoma gjoksin,
me freskinë e shkumës, rend arteriesh,
shpërthe me plazmën e zemrës,
eja zgjomë në ag dashurie,
e përkundmë me afsh të epërm.

Eja valëz, mbuloma trupin,
me puthje bulëzash,
le të dridhet halë pishe,
në sqep të harabelit humbur stuhive,
me shkumën tënde mbështille,
të kridhet, përgjërohet
në membranë afshi dashurie.

Derdhu valëz dejeve të mia,
si vera e vjetër derdhur butit,
qiellin harkoje brënda një bulëze,
por mua mos më përpij, mua lermë,
të kthehem në Pulëbardhë,
të harlisem pafundësive,
mes Tokës e Qiellit,
jam Pulëbardha që ulem e ngrihem,
në sinkroni me dallgën.

Janar 2020

PA TITULL

Jam nji grue,
nji nanë, nji lule e vogël,
n'kopshtin tem.
Nuk jam
"Lulja e Vogël" Karmelitë,
Shenjt"Terezë e Lisieksit",
prej Francet,
por prej burimit t'shpirtit saj,
njom buz't e mija
kur m'rreshken.

Laj duert,
ftyrën laj,
n'mirsin, n'butsin e saj;
n'melhem shpirti
e njyej penicën,
kur n'leter
du fjalën me shpërvjelë,
n' përulje t' shpirtit.
Jam veçse nji grue,
nji nanë,
nji lule e vogël sa nji sy,
ku shtrihen, përplasen,
tanë detnat e oqeanet e Tokës,
e un mbetem njashtu,
nji shkam, tuj durue.

E ti udhtar i Zotit,
falju nanës tande,
qi t'fali njato sy,
për me shikjue
nji grue t'pa faj,
nji nanë trandun dhimet,
nji lule, t' vocërr,
sa njai sy,
e përmes synit saj,
me kqyr ndër vedi,
e me kuptue,
me zbulue,
njat qi asht hyjnore,
ndër ty,
e me ju fal
nj'asaj, qi t' asht falun ty!

Maj 2019

PRITJA

Prisja,
çdo mëngjes,
si një lot i paçelur
mbi qerpik;
prisja agimin
të griste çarçafin e natës,
e të zbardhte
ndarjen mes nesh.

Prisja,
si pret qielli
të mbushë gjoksin
plot me re e yje;
vetminë pikturoja,
me shiun e tyre
gurpritjen lëmoja
me durim
të heshtur gruaje.

Prisja,
si pulëbardhë e trembur,
strukur
në uturimën e erërave,
me ankth,
mes tyre kërkoja timbrin e zërit tënd,
ti pëshpërisja
se pritja është zbehur.

Dhe Ti, u shfaqe,
ashtu puhizë zgjimi,
i paqtë
nëpër mugëtirën e heshtjes,
kënga
shkruar në pentagramet e syve,
treste
shkretëtirën e pagojë të ndarjes.

Ah, e rëndë Pritja,
kreshmë e pakohshme,
pakuptuar na rikthen ad hoc,
vizionet e humbura,
me koshiencë hyjnore!

Mars 2020

PA ÇMIM

Dy brigje falen në një det,
dy pole lidhen në një aks,
hënën e plotë ngjitur mbi retë,
ta adhurosh nuk është mëkat.
Nuk ish e thënë të ndizej zjarr,
as zjarr, të shuhej në vënd tjetër,
janë vetëm diejt që mbajnë zjarr
hënat kokëulur ndriçojnë veç terret.
Baticë, zbaticat, janë derte shpirti.
Ç'thellësi e detit, ç'mister i sjell?
Kur hënë e plotë ngrihet në qiell,
dielli në krahë kërkon ta marrë.
Akrep i orës titanike,
nuk dihet se në ç'kohë godet,
nga syri hënës lart në qiell,
një lot u derdh e u bë det.
Nuk ish lot zije, as lot gëzimi,
ai sy lotoi në pafajsi,
por nuk ka çmim jo adhurimi,
nuk merr dënim shënjtëri e tij.

Maj 2019

NJË GRUSHT SHPIRT

Plasaritet muzgu si pasqyrë,
brigjeve thërmohen rrezet prore,
shkuma e frymës s' mbrriti kurrë,
qiejve u shuan sërish meteorët.

Muajt, vitet, humbën s'di se ku,
të tjera shtigje, gjurmët na i fshinë,
pranë të ndjej kur rrugën humbas,
"Eja këtej," thua, "je më mirë."

Larg jemi, akoma malli mbeti shtysë,
meridianët hartës zgjaten, duart lusin,
më jep një grusht shpirt, në faltore të pyes,
A e ndriçojnë sytë misterin e padukshëm?

S'zhbëhen shpirtrat, koha s'mbaron,
sëbashku në një aksiomë rrimë ngjizur,
më kot pres të pyes kohën që s' ndalon,
vallë, dy pole, ç'mister i mban lidhur?

Gusht 2019

KOZ KINGU

Tregim nga Fatbardh Amursi

Në atë kohë isha mësues gjimnazi. Ndiqja dhe rrethin letrar. Me ndërhyrjen e një poeti të njohur në Tiranë përmes Koz kingut, mu kërkua të ndihmoja një kushurirën e poetit nga kryeqyteti, për t`i botuar një cikël me poezi në gazetën lokale, që do i shërbente asaj, si një mundësi për të vazhduar shkollën e lartë. Ishte një opsion, që, Lidhja e Shkrimtarëve, kishte ofruar për të rinjtë e talentuar. Cikli u botua, por, në revistën "Hosteni" del një shkrim diskretitues, ku talleshin me autoren, e cila, poezitë i kishte vjedhur nga poeti Agim Shehu dhe i biri i tij. Thirra nxënësen për të mësuar të vërtetën. Duke qarë e pranoi se poezitë s`ishin të sajat. Por, kush do paguante për të? Të nesërmen më thërrasin në komitet të partisë, ku prindërit ishin ankuar se i kisha bërë presion vajzës të pranonte vjedhjen dhe, sipas tyre, ai që i kishte çuar poezitë në gazetë isha unë, si e si ta digjja për t`i hapur rrugën një tjetre. (Të gjitha ligësitë kanë të njëjtën skema: në sy të ndezin cigaren dhe nga pas të vënë flakën.) Njeriu që shihej nëpër qytet me revistën "Hosteni" ishte Koz kingu, sa në komitet të partisë, xhiro me familjarët e vajzës, shoqëruar si gjithnjë me dy kolegët tanë, por, miq të tij: Diamanti dhe Pordhaci. Ky i fundit, mbahej se e pëlqenin femrat. Dihet si bëheshin mbledhjet atëherë, ku po më kërkohej llogari, si shkaktar i namit të keq, që po i hapej shkollës. Dihej që tonin mbledhjes ia jepnin ata që ishin në rol, ku dallohej: "bedeli", "i ndërsyeri" dhe ai që ta ka me ta futur. Kur ktheva kokën në klasën, ku po më bëhej autodafeja: Diamanti, Koz kingu dhe Pordhaci ishin të ulur në një bangë. Veti e të dobtëve, që, sa herë bie ora e ligë për ty, ata shtërngojnë radhët për t`u dukur të fortë. (Unë e di se sa shumë e urrejnë njëri-tjetrin, por, hë për hë, u duhet të jenë bashkë, me shpresën se ky do jetë fundi im.)

"Unë s`jam roje i letërsisë!"-u thashë i nxehur.

"Po vigjelincën ku e ke ti?!"-mu kthyen gjakftohtët. Rrymat e ngrohta po përplaseshin me ato të ftohtat. Të shpëtohej "nderi i humbur i vajzës", ishte gjithë kauza e rreme, ku në shtyllën e turpit duhej të vihesha unë. Ligësia i ngjan betonit, i cili duhet shtruar shpejt se përndryshe ngrin. Kjo është ora e betonizimit tënd, e flijimit. Ka shumë orgazëm në këtë linçim.

Ajo kohë quhej "hekur-beton", ndërsa tani, as më shumë e as më pak: selikon. Mu kujtua kjo histori, kur: Koz kingun, e ndjeva t`më dilte në krah me hap të nxituar, duke më thënë, për hir të shtatit, më dukej si një kacavjerrës i bezdisur:

"Ti s`je Fatmiri, por Fatziu?!"-meqë pranë ishte një kosh plehërash, gjëja e parë, që më shkoi në mend, ta vërvisja atje. Dhe kisha arsye.

"Fatzi, se kur kisha në dorë t`i futa tri rroga në shtëpi?"-Prisja të skuqej, a të zverdhej, por ai nxiu. Shfaqi atë ngjyrë, që kishte në shpirt.

"Pse e përmend?!-gati sa s`më tha: "Si s`ke turp, që e zë me gojë nderin?!"- Si thotë populli: "Bëje të mirën dhe hidhe në det!"-Në përfytyrim më doli revista "Hosteni".

"Të mirën, që unë ty të bëra, ti e hodhe në det apo e fute në xhep?"

"More kush je ti që më kërkoke llogari mua, se ku i çojë paratë e fituara me djersën e ballit?! Na flet ky, sikur me qenë shpëtimtari i jetëve tona?! Pse plaku ta la zyrën e shtetit ty?"

"Mirë ta bën!-iu drejtova edhe une vetes,-se kur e kishe në dorë, në vend të merrje hak për poshtërsinë e dikurshme, tregove atë kalorsiakun tënd të dalë boje, duke menduar se Koz kingu do të bëhej më i mirë?!"

"Zyrë e shteti ishte dhe ajo, që të hoqi nga puna para se të vija unë?! Diamantin e kishe ofiqar dhe s`t`a vari! Vetë ma ke thënë! Miku tjetër i yti, Pordhaci, po dihet sheh vetëm bythën e tij?!"-befas u shfry. Jam mësuar me shfryrjen e të tillëve.

"E di si është puna?! Ta kisha inatin, se më ke fyer."

"Unë të kam fyer?! Përkundrazi, të jam gjendur, kur të fyenin".-Nuk i thashë, kur të tallnin.

"Tek ky shkrimi i fundit, nuk kishe lënë qen e mace pa përmendur, ndërsa unë sikur s`ekzistoja fare për ty! Mund t`më kesh zili, por jo kaq hapur?!"

"Unë zili ty?! Gjallë në botë!"

"Prapë po më fyen. Kaq i pavlerë qënkam unë, sa mos t`i ngjall zili askujt?! Se vetëm t`i qenke mençuria e këtij kombi dhe ja nuk e sheh, përmbys pas teje! Mos kujto se jam ajo çupelina unë, që e mashtrove me poezitë, duke ia shkatërruar të ardhmen?!"-çakërreu sytë, lëvizi dorën me nervozizëm në ajër krejt i shpërfytyruar, si i dalë nga faza. Që ta kthesh të bardhën në të zezë, duhet patjetër të kesh brenda vetes, një bojë të zezë, sikurse e kishin dikur shaptilografët dhe sot printerët, ku: me të zezat e tua, të nxish për kollaj tjetrin. Mirë ta bën, kalorsiak i pandreqshëm!

Nju Jork, mars 2023

por kur zbardh dita, të verbërit janë prapë të verbër

Cikël poetik nga Xhelal Tosku

***

deti deti gjithmonë deti
dhe unë do jem guacka bosh
dhe ti do jesh perla e munguar

***

kemi dimrin përpara

një dimër përpara me shi
një shi përpara me dimrin
si i bëhet që pak të të shoh
Si i bëhet që pak të më shohësh ti

një dimër përpara me deborë
një dëborë përpara me dimër
si i bëhet tek unë të vish ti
si i bëhet që unë tek ti të mbrrij

kemi një dimër përpara të dy
dhe dimri nuk shkon pa akuj pa të ftohtë
si i bëhet që me frymën time të të ngroh ty
si i bëhet që ti të mos më lësh të ngrij

***

më mërdhijne këmbët
dielli ende i ftohtë

mëngjes.

mirmëngjes Hamlet
kafkën e kujt do kesh sot në dorë.
këngë për keq

***

jam në dheun tim

nuk dua të më dojë njeri
dhe unë nuk dua kërkënd

ta dijë kushdo që më njeh
kush nuk më njeh
nuk ka çfarë të dijë

kjo botë bën edhe pa mua
po edhe unë pa botën bëj

shpirt je ti dheu im
që do më tresë

***

shpirt ti do ngjitesh lart
do fluturosh nëpër qiej
do pushtosh lartësitë

trupit që të mbajti brenda vetes
si i thonë të mbajti në shpinë
do ja kthesh shpinën

trupin që të mbajti ty
do ta hajë dheu
trupin tënd ti do ta braktisësh

shpirt fluturo lart pushtoji lartësitë

dije mosmirënjohësi më i madh ti je

***

nuk e di se sa mund të jetë ora.
në hapësire fluturojnë tingujt e kambanave
të kishës
në luginë trëndafili yt i gatshëm
të çeli në çdo stinë
në çdo orë të natës dhe të ditës
unë në ëndërrime.

***

harabeli im i vogël
harabeli im i vogël

vrima në ujë
nuk mbetet vrimë
në ujë

o harabeli im i vogël
çfarë kërkon ti mbi det

***

bota rrotullohet edhe kur dielli djeg
edhe kur nga yjet bie shi rrotullohet po jo

për ty o mike
për mu o mike jo se jo

bota rrotullohet kaq gjë edhe bufi e di
po nuk rrotullohet për ty moj mike
për mua moj mike jo se jo
bota rrotullohet për qejfin e vet.

rrotullohet bota mikja ime rrotullohet
këtë gjë edhe bufi e di
edhe po të mos ishte Galileu je ti
që më çon në tavernë
dhe pastaj . . . moj mike çdo gjë unë di

***

do ketë dhe plot e plot net të tjera me hënën
mbi det
dhe po në keto brigje deti do lëkundet
dhe era gjithherë këtej do vërtitet
këtu për herë të parë kam ndjere
frymëmarrjen tënde
këtu duart tuaja u bënë bashkë me duart e
mija
po herë tjetër herë tjetër ku i dihet.

***

o mos e zgjo dhimbjen time

o vetmi e katundit tim
o ullinjt e gjelbër të katundit tim
o hënë e kuqe mbi ullinj

o syri im

***

o zot pse e krijove fshehtësinë

ngaqë të vdekurve ua mbyllin sytë
unë i mbylla sytë
thash të shoh vdekjen
vdekjen nuk e pashë

ngaqë jeta jetohet me sytë hapur
unë syte i bëra kater
as jetën nuk e pashë
jeta sesi më iku sysh

pashë sytë e tu
syte e tu i pashë
po çfarë më fshehin sytë e tu
nuk e pashë kurrë

o zot, fshehtësinë përse e shpike

***

kur kam qenë fëmijë
bëja pipza prej gruri
nuk e di pse në publik
nuk kam kënduar kurrë
as përpara klasës time

nuk e dua Bethovenin as Vagnerin
Jorgo Loli, mësuesi im i muzikës
në shkollën fillore
për këtë shkak me vuri notën pesë
njohja ime me brengën nisi pikërisht këtu

Vivaldin dua për stinën e vjeshtës dhe dimrin
jo për pranverën verën
në La Skala nuk shkela kurrë

kur vjen mbrëmja
në përroin tim në fund të kopshtit
dëgjoj bretkosat që nxjerrin kokën mbi ujë
dhe këndojnë
me një trishtim të ëmbël të thellë
me një trishtim pa fund
kushedi çfarë duan të thonë.

***

në mëngjes të kam parë
ti krejt i gjelbert i tejdukshëm
mirëmëngjes deti im
ke qenë gjithmonë gëzimi im
i kaltër i kaltër pafundësisht
kam vrapuar pas teje
ke mbushur ditët e mija gjithëherë
---ngazëllimi im je o dete.
nuk e di çfarë m'i bënte syve
fasha jote e kuqe tejpertej në perëndim të
diellit
dhe kur zbriste natë e errët
më të erret se ty o deti im
nuk kam parë
atëherë e gjithë fshehtësia jote
sikur ngjiste tek unë
kush luan kështu me ne
o deti ìm

e shtrenjta ime e dashura ime
këtyre brigjeve shpesh unë të kam thirrur ty

***

fryj moj ere fryj

kudo që të shkosh
kjo botë: baltë dhe uje

unë ujë prej përroit tim
baltë prej dheut tim

kur të ecësh nëpër rrugë ngado
moj e Bukura e Dheut
ti do dish ta heqesh pluhurin nga syri

fryj moj erë fryj

unë do bëhem dhe'
do jem pluhuri

***

ti je syri
sheh dritën

unë i verbër
shoh errësirën

ti i gëzohesh jetës
unë nuk kam sy

ti je syri

***

viçi ngre kokën sheh trenin që nga livadhi
tund kokën pa kuptim
dhe kthehet prap tek bari

kasapi sheh viçin që rritet
kur luan kërcen e hidhet
i lumtur prej barit i shkreti
se nuk e di që thika po mprihet

e në paste pak fat
e pret qerrja parmenda
e në qëllofte femer
e pret i gezuar fshatari
që lopë të behet
dhe tri herë në ditë ta mjeli

kështu vërtiten në këtë botë punët
për njeriun e shkretë
kudo qoftë dhe kushdo qoftëe
që jeten e tij e sheh
si viçi trenin : i mjeri

***

dua erën e maleve

zjarri është dashuria për dheun e rrënjëve
zjarri është malli për aromën e pyjeve

e dinë vetëm drurët që digjen
unë ndjej aromën e pyjeve

***

në fillim
një lule
seicila lule
duhet të ketë qene një pikë loti

tani lulen
secilën lule
e mbajnë në vazo
e vendosin edhe në parvaz të dritares

loti i kujt
do ketë qenë
lotët e kujt
do kenë qenë

***

une jam i vdekshëm do vdes
une jam i ikshëm do iki
po ti çfarë do bësh

***

o deti im
kush ja tha njeriut
se peshku qelbet nga koka

***

një ditë gjithmonë ndodh

në cepin e preferuar të pyllit tim
ndodhi një ditë një mëngjes
nuk e gjeta aromën e manushaqes

simbol pranvere dhe fat i errët.

kjo është e gjithë e vërteta.
mund të ketë qenë dhe muzg.

***

edhe në katundin tim
rriten jaseminët dhe ullinjtë
del hëna netëve dhe ndriçojnë yjet

edhe në katundin tim
gjelat neteve këndojnë
dhe qentë lehin

po kur zbardh dita
të verbërit janë prap të verbër.

***

ujra të kaltra pa fund

përshëndetje o lumi im
përshëndetje o det'
përshëndetje oqean

peshku im i vogël nuk është se nuk të duan
thjeshtë të mendojnë pa tru

në qiell pulbardhat fluturojnë

***

shit bli bli shit
mbetem lakuriq
vetëm dheu do na mbulojë të gjithëve

***

O të vdekurit e të gjithë botës
o të vdekurit e mi
o të vdekurit e të dashurës time
o të vdekurit e miqve të mi
o të vdekurit e katundit tim
më thoni, a jeni të lirë atje ku jeni
apo si gjithmonë do heshtni ?

TRIPTIK I NXJERRË NGA PALCA E NJË MANUSKRIPTI

Tregim nga Aziz Mustafa

1. ...

Autobusi nga Beogradi mbërrinte diku para mesditës në Stacionin e Gjilanit.

Nuk di përse sa herë e kujtoj atë stacion autobusësh, por edhe të gjithë stacionet e autobusëve të ish-Jugosllavisë, në hundë e pastaj në korën olfaktore të trurit tim më vjen era e urinës, kurse në vesh zhurma e ujit që rrjedh vazhdimisht nga rubinete të prishura. Ulësja e kujdestarit apo pastruesit, me një tavolinë të vogël ku mund të këtë ose jo rrathë letre tualeti, por domosdo në tavolinë është me një kuti të rrumbullakët metalike për monedhat metalike të pagesës: pesë dinarë për të voglën, dhjetë për të madhen.

Prej të gjitha këtyre vizita tualeteve, nuk e harroj njërën. Nuk e di a shkoja a vija nga Beogradi, që edhe nuk ka ndonjë rëndësi. Diku pas mesnate. Në zemër të Serbisë. Zbres nga autobusi dhe nisem drejt tualetit. Meshkuj një anë, femrat një anë. Kujdestari apo pastruesi, një burrë i dobët, afër të dyzetave, me një mirësjellje të pazakontë më thotë të pres pak, sepse të gjitha kabinat e tualetit të meshkujve janë të zëna. E kuptova: të gjithë udhëtarët kishin mësyrë vendin e zbrazjes së mëshikëzave të urinës. Në tavolinën e vogël, nuk më kujtohet a kishte letër tualeti dhe a kishte kutizë monedhash, por më rri para sysh një libër, në gjuhën amtare të pastruesit të tualetit.

- A mundem? - e pyeta.

- Patjetër. -

E mora në duar. I rrëzbitur nga leximi dhe rileximi. I nënvizuar nga disa herë me lapsa të ndryshëm, me ngjyra të ndryshëm. I shkruar skajeve me një shkrim brilant, gati kaligrafik. Danilo Kiš: "Grobnica za Borisa Davidoviča: sedam poglavlja jedne zajedničke povesti" (Danillo Kish: "Varreza për Boris Davidoviçin: shtatë kapituj të një historie të përbashkët"). Me sytë e ënjtur nga një gjumë me ëndrra në një autobus të vijave të gjata, lexova në faqen 99, pasuesin nënvizuar me ngjyrë të kuqe:

"*Historia e ka ruajtur nën emrin Novski, që është, pa dyshim, vetëm pseudonim (thënë më saktë, një nga pseudonimet). Por ajo që menjëherë zgjon dyshimin është çështja: a e ka ruajtur vërtetë historia? Në Enciklopedinë e Granatovit dhe në aneksin e saj me dyzetegjashtë biografi të autorizuara dhe autobiografi të gjigantëve të revolucionit dhe përcjellësve të tyre, emri i tij nuk gjendet.*"

Vazhdova të lexoja në këmbë atë faqe, dhe ktheva faqen e njëqindtë, ku mbeta i nemitur dhe i magjepsur nga erudicioni i autorit, që e kisha dëgjuar si emër. Nga fundi i faqes, lexuesi/kujdestari/pastruesi, kishte nënvizuar me ngjyrë të zezë fragmentin e më poshtëm, duke vënë anash tre shenja: një yll të Davidit me ngjyrë të zezë, një kryq të kuq dhe një gjysmë hënë me të gjelbër:

*"Grekët e Vjetër (*thuaj Ilirët, mendova me vete*) kishin pasur një zakon të denjë për respekt: të gjithë atyre që kishin vdekur të djegur nga zjarri, atyre që i kishte përbirë gryka e vullkanit, që i kishte mbuluar llava, atyre që i kishin shqyer kafshët e egra ose peshkaqenët në det; të gjithë atyre që ua kishin ngrënë copat hutat e shkretëtirës; në atdhe u kishin ngritur të ashtuquajturit* kenotafe, *varreza të zbrazëta, sepse trupi është zjarri, uji ose toka, por shpirti është alfa dhe omega, atij duhet ngritur tempull".*

Do të kisha vazhduar të lexoja ashtu, po të mos më kishte treguar se ishte liruar njëra nga kabinat dhe se mund të kryeja tani atë për të cilën kisha zbritur.

Rrugës deri në cak e di se pata menduar për varrin tim: a do të ishte varri im në Lugun e Leskës, afër varreve të të parëve, apo do të ishte një varr i zbrazët, një *kenotaf* si ai metaforik që kishte ngritur Kishi për Boris Davidoviçin?

2. ...

Qyteti im Gjilani asokohe kishte disa librari, por dy ishin më të pasurat me libra. Nuk ka nevojë ndoshta të them se librari quheshin edhe shitoret e mjeteve mësimore dhe për zyrë, edhe pse nuk kishin as edhe një libër artistik. Pra, qyteti im kishte dy librari, njëra me libra shqip "Rilindja", libraria e shtëpisë botuese model që botonte letërsi shqip, origjinale dhe të përkthyer, tjetra me serbisht "Jedinstvo". Isha ndalur pikërisht para kësaj të fundit.

Një libër më tërhoqi vëmendjen.

"Atlasi i erërave" do të thoshte përkthimi i titullit. Kapakë me ngjyrë si thellësia e detit. Për momentin nuk po më kujtohet emri i autorit. Me duar në xhepa, po shikoja librin në vitrinë. Titull shumë intrigues. Një fllad i lehtë më flladiti qafën, deri sa dielli po afrohet kah perëndimi. Duhet të hyja, ta blija dhe ta lexoja në një kënd të parkut, prapa ca shkurreve ku hidheshin mbeturina ilegalisht, për të mos lexuar në ulëset ku kalimtarët serb do të më shihnin si snob e pleh që nuk po lexon shqip, ndërsa shqiptarët si një spiun që po mundohej tu mësonte gjuhen e tu hynte në bythë serbëve.

Pa marrë parasysh ku i kam lexuar ato 14 faqe të atij libri, të atij tregimi, të atij "Atlasit të erërave" , por mund të them vetëm se kanë kaluar disa dekada, por pasusin e fundit të tregimit me titull të njëjtë nuk e kam harruar. Ndoshta ka qenë momenti, ndoshta kanë qenë yjet e erërat mbi qiellin ballkanas që më kanë ngulitur në kokë këtë fragment që po e parafrazoj:

"P.S. As që marr guximin të mendoj se çka është puna me librat tjerë të bibliotekës sime. Me qindra e mijëra libra. Çka nëse në titujt e tyre kanë hyrë tituj tjerë? Po vallë nëse edhe ata mbajnë emra të tjerë barbarë ngjashëm me këtë? Mbaj syze të kuqe dhe nuk guxoj të shikoj në titujt dhe emrat e autorëve në raftet e mija. Frika ime është lodhëse dhe kjo më tregon se më e keqja veçse ka ndodhur. A ta zgjas dorën dhe të vërtetoj edhe njëherë për realitetin e pamundur që fundoset rreth meje, apo ti kthehem pagabueshmërisë së Atlasit të erërave *dhe të mbaj sytë mbyllur edhe më tutje? Ti mbaj sytë mbyllur më kot.*

Sepse, jo vetëm se me përllogaritje të gabuara mund të zbulohet një kontinent, por njëkohësisht me përllogaritje të sakta mund të humbet tjetri."

Mbaj mend se librin e kam fshehur nën kazanin e bërllokut, për ta marrë vonë dikur në vonë natën, para se të nisesha për fshat, kur të kem përfunduar ecejaket në kërkim të vajzës së ëndrrave, dashurisë sime eterike.

Një gjë e di, se kur e kam marrë në duar atë atlas, disa orë më vonë, pak para se punëtorët e ndërrimit të natës së ndërmarrjes për menaxhimin të mbeturinave ta lëviznin kazanin, më kujtohet se librit i vinte një erë e këndshme, si aroma e fushave të livandës në Jug të Francës. Rrugës për shtëpi, e shtrëngoja librin në duar, deri sa hijet e natës më pështpëritnin një gjuhë që nuk e kuptoja se cila gjuhë ishte, por ia kuptoja domethënien, si muzikës. Sa miliona gjuhë të botës ishin zhdukur deri tash? A nuk kishte qenë edhe gjuha jonë e rrezikuar të zhdukej nën kërcënimet e thikave, helmit dhe luftës shekullore të armiqve fqinj? A ishte e mundur që një nga to këto gjuhë të vdekura, të zgjohej nga varri dhe të pështpëriste në gjuhë të një ere pa drejtim?

E di se kur pata mbërri në shtëpi, kisha pasë një dhembje të padurueshme të kokës, ethe e temperaturë aq të lartë. Kisha pirë një hap për dhembje dhe isha shtrirë në errësirën e dhomës. Tërë natën kisha parë ëndrra, që nuk më kujtohen. Të nesërmen kur u ngrita, më kokën sa një balonë, nuk më kujtohej as në e kisha takuar Anitën apo jo.

Libri, "Atlasi i erërave" ishte nën jastëk, tani me aromë portokalli.

Emri i autorit kishte fluturuar bashkë me ëndrrat e mija dhe ishte futur diku në bibliotekën e pazakontë të tij, ku frynin erëra dhe ndërronin fjalitë, fletët dhe deri në fund edhe emrin e tij në kapakët e "Atlasit të erërave".

Milorad Pavić, tani mu kujtua emri i autorit dhe më doli para portreti i tij i vizatuar me kafe të bluar imtë, portreti i një burri që thithë një llullë dhe në fytyrë i varet një ndjenjë e pacaktuar.

3. ...

Ditën e dytë, pas asaj natës me dhembje koke, temperaturë, ëndrra dhe harresë, u ndala para vitrinës së librarisë "Jedinstvo". Kur e mendoj, pyes veten, ato ditë, rrugëve të Gjilanit, kë po kërkoja unë? Vajzën që e doja, apo librat që më shtonin pyetjet në kokë dhe më zgjonin sinapsat e fjetura të trurit, të mbuluara me mykun e përditshmërisë? Sinapsa të fjetura që mundoheshin të zgjoheshin dhe të më tregonin rrugën kah do të shkoja. Sinapsa që më zgjonin pyetje të fjetura, pyetje jetike që i kanë shoqëruar të gjithë njerëzit që nga koha kur kanë filluar të mendojnë.

Mes shumë librash, njëri ma zgjoi kërshërinë. Ja pse libri duhet të ketë një titull që të bie menjëherë në sy, të mos them në kokë.

Umberto Eco.

"Emri i trëndafilit"

Duhej ta kisha në duar. Në dukej se duke e lexuar do të ndjeja aromën e një trëndafili mistik, nga ato të legjendave e përrallave. Nëpër xhepa kisha ende mjaft të holla që kisha fituarduke punuar tërë verën nëpër kopshtet me dredhëza buzë Danubit, afër një qyteze që quhet Grocka.

Hyra, pagova dhe e mora në duar. *Il nome della rosa.*

Në këmbë lexova fjalinë e parë, që ishte në faqen pas një skice të një abacie të shekullit të 16-të dhe titullit të kapitullit "Një dorëshkrim, natyrisht":

"*Më 16 gusht 1968 më ra në dorë një libër i shkruar nga pena e njëfarë abati Valet,* Dorëshkrimi i Dom Adsonit prej Melku, *përkthye frëngjisht simbas botimit të Dom I. Mabijon (Në Pres de l'Abej de la Sursë, Paris 1842).*

Pastaj vazhdova të lexoja se si dikush narratorit ia kishte vjedhur dorëshkrimin dhe se ky ishte përpjekur ta kopjonte nga mendja e tij. Pastaj pas shfletova me shpejtësi, shumë përnjëherë për të arritur deri te fjalia e fundit:

"Bën ftohtë këtu në skriptor e më dhemb pëlqeri. Po e lë këtë shkrim s'di as unë për kë, s'di as unë se rreth kësaj gjëje: *stat rosa pristina nomine, nomina nuda tenemus.*"

Stat rosa pristina nomine, nomina nuda tenemus.

Trëndafili qëndron me emrin e vjetër, ne kemi vetëm emra të zhveshur.

Trëndafili qëndron me emrin e vjetër, ne kemi vetëm emra të zhveshur.

Në kokën time emri i vajzës që doja u përkthye si me automatizëm të makinës në trëndafil. Dhe ashtu më ka mbetur deri më sot.

Vite më vonë, kur më ra në dorë botimi i përkthimit shqip, kur e ri-lexova e dhe e ri-lexova, përherë më kthente te vitrina e asaj librarie me libra në gjuhë të huaj dhe gëzohesha se të gjithë ato libra tani më i kishim edhe në gjuhën tonë.

Por, fillimi dhe fundi nuk janë ato që më kanë mbetur më shumë në kujtesë. Më së shumti më ka mbetur në kujtesë ajo pjesa kur autori thotë se nën ndikimin e torturës, viktima tregon jo vetëm ato që ka thënë e bërë, por edhe ato që ka menduar ti bëjë.

Më patën kapur ethe kur e pata lexuar këtë pjesë.

E pata mbyllur librin dhe e pata hedhë në qoshe. E shikoja si diçka kërcënuese dhe të frikshme.

Një dekadë më vonë, kur më patën marrë policia serbe në një bisedë informative rreth aktiviteteve të mija politike dhe përkujdesjes mjekësore që i kisha dhënë prindit të sëmurë të një heroit kombëtar që ishte vrarë nga policia serbe, mu pat kujtuar "Emri i trëndafilit", Adsoni i Melkut dhe të gjitha metodat e torturave që kishte përdorë Inkuizicioni për të nxjerrë pohimin nga i dyshuari.

Gjilan, mars 2023.

ÇOKOLLATË E ERRËT

Tregim nga Shkëlqim Çela

1.

Subway 5, vajza të holla me pallto të zeza që hipnin me shumicë në 86 Street, shitës aziatikë me çikërrima në duar vagon më vagon duke përsëritur pa pushim "uan dalar, pip-pip, uan dalar", Grand Central, avenju e pestë, jetë mëngjesi dimëror i Manhattan-it, avull i bardhë nga frymëmarrje njerëzish dhe puseta rrugësh, stenda ambulante, i njëjti mercedes i zi me një burrë të vranët me puro nën Chrysler Building, avenjuja e tretë, 46 Street, ashensori që ngjitej shpejt, fytyra nëpunësish ende të prangosura nga të ftohtit e rrugës, midis tyre shpesh, si detaj burlesk, vajza qukse e katit të 23-të, që kishte zakonin t'u frynte balukeve... Ky ish fillimi i zakonshëm i ditës njujorkeze për JC-në, një qerthull ala Groundhog Day, po pa mërzinë e përsëritjes. Ja vajza balukefryrëse. Kuqse seriali. Buzeqeshje episodi. Nesër në të njëjtën orë. Asnjë takim nuk ish aq i sigurt sa kjo nesër. Nepër sy ende borxhe të pashlyera ëndrrash. Qyteti që gjoja s'fle - mos gënje, Frank! Për shembull, kjo kuqsja duhej të flinte për shtatë palë qejfe. E sigurt, edhe pse s'njiheshin fare. Si mund të njohësh dikë në NYC? Thjesht kishin qëlluar një herë vetëm në ashensor, dhe ajo, në vend të asaj heshtjes tipike klaustrofobe me sy ngulur panatyrshëm në pika befas tepër interesante të ashensorit, apo në vend të ndonjë fraze fosil mbi motin, kishte thënë "ky ashensor ka kamera". Hm. Ç'ishte kjo, paralajmërim? (Zot, dukej vallë aq i dëshpëruar?) Apo ftesë? Hijeshia brad-pit s'kishte qenë ndonjëherë arma e tij, po kushedi, shije këto, kurrë s'i dihet, vendi i oportuniteteve..., njujork-njujork, ba ra bara bam, ba ra bara bam. "E kam mësuar duke e pësuar, ha ha ha", zëri i saj ishte si me grip, po hunda majuce s'kish si i skuqej më. "Vërtet!?" kishte thënë ai gjithë gazmim mirëkuptimi. "O jo-jo, jo ashtu si mund të mendoni!" kishte sqaruar ajo gjithë duke qeshur. Pastaj kati i saj i 23-të, ndërprerje nga ding-u i ashensorit, paçi një ditë të mirë, ju gjithashtu..., ndjekje e tjetrës me sy nga pas, gjetje medoemos të metash trupore, thjesht për ngushëllim, ai dhelpër, ajo rrush me quka, gjysma rrush i kuq-o, gjysma rrush i zi... apo jo, më mirë moj nepërka pika-pika..., po vërtet, ç'mund ta bëjë dikë të mësojë duke e pësuar që në ashensorë ka kamera? Mundësitë ishin të shumta dhe të përçudshme. Ndërpriteshin nga kati i tij. Ding-u i ashensorit. Një tjetër ditë, një tjetër dollar. Dera e punës së tij që hapej me kod shifror. Pesë numra. Shtypur më parë te pjesa e trurit që punonte vetiu, ku stivoseshin fjalëkalime alfanumerike, emra përdoruesi, numri i sigurimit shoqëror, i punësimit. Hapu Sezam, bzzz, dera hapej me bezzz...di dhe pas tryezës pritëse të vizitorëve shquhej fytyra afrikane e Antuanetës duke përtypur çamçakëz, gjithnjë e zënë, o me kompiuter duke komunikuar me shoqërinë virtuale, o me telefon, qartësisht biseda private dhe intime. Gëëëd-morning! Kortezi gjithë përtesë, politikë korporate dyersh të hapura, nga ku dukeshin me radhë Xhudi nga Anglia, një tjetër vajzë nga Gjermania, pastaj Virxhinia vendore që mendonte se ishte o e bukur, o çapkëne e madhe, se ndryshe nuk shpjegohej qe edhe kur fliste me klientë në telefon, gjë që e bënte të shumtën e kohës, e spërdridhte zërin si gjë e zgjuar shumë e me naze..., dhe në fund dera e zyrës së tij.

2.

Virxhinia sot ishte si e sersenosur. Ai është një hottie1, u dëgjua zëri i saj prej zyrës së vet, ngjitur me atë të JC-së, tek i fliste kushedi se kujt. Ngaqë u tha sapo mbërriti ai, JC-ja për një çast mendoi se ajo frazë mbase ishte për të. Zakon i vjetër ky, nga gadishulli i origjinës në kontinentin e vjetër, ku meshkujt si rregull i marrin gjërat në favor të tyre. Zaten në gjithë katin meshkuj ishin vetëm dy, dhe tjetri, banues në Nju Xhersi, i kujtonte shumë një karrocier të Institutit Foragjer të Fushë-Krujës, me emrin Xhazir. Gjithësesi, dhjetë orë në një rrethinë me femra, të gjitha shumë larg menopauzës, mbase të bëjnë edhe hottie. Siguristi, ai përcaktim ishte mbase për Keanu Reeves, të themi, në ndonjë film të djeshëm. Sidoqoftë, për JC-në hottie duhej të ish ai vetë përsa nuk ish vërtetuar e kundërta. Po kjo s'kish shumë rëndësi kur vinte nga Virxhinia, sikur edhe vetëm për shkak të hundës së saj plangprishëse. Tjetër gjë të vinte për shembull nga Xhudi, të cilën akcenti britanik e bënte interesante edhe kur kërkonte një stilolaps.

Ja ku u duk te dera.

- Je për kafe, JC!

Shkuan te dhoma e kafes. TV mbi mur ishte gjithnjë tek CNN-i. Me votim ky kish fituar mbi FOX-in. Lajme, politikë.

- Si po ja çon, Xhud?

- Javën tjetër shkoj në shtëpi – tha ajo gjithë gëzim. – Më ka munguar Londra.

- London? – tha JC me theks britanik. – Çaj me mbretëreshën?

- Mos u tall.

JC këndoi me zë të ulët.

London bridge is falling down,
Falling down, falling down...

Xhudi i kapi dorën me butësi.

- Jo këtu, - i tha. - Jo në këtë... mjedis.

Kishte të drejtë. Pak pas 11 shtatorit kënga e Urës së Londrës mirëfilli nuk mund të këndohej lirshëm në New York. Ashtu si shumë gjëra të tjera. Vajza nga Gjermania, për shembull, kish ardhur një ditë më parë shumë e tronditur, ngaqë disa djem e kishin marrë për franceze nga e folura, dhe e kishin dokëndisur një copë rrugë duke e ndjekur: I see world, I see France/ France has yellow underpants! Ky është diskriminim, kishte thënë gjermania e indinjuar. Tani e kuptoj si ndihen emigrantët e Lindjes në Gjermani. JC-ja kish buzeqeshur: S'ka më patatina frënge! Megjithëse ato kanë shumë karbohidrate, sidoqoftë... ha ha ha. Nuk është për të qeshur, JC. E di, por edhe s'do qajmë! Woody Allen dhe unë kemi vendosur që të mos heqim dorë nga puthja frënge të paktën, një herë për një herë.

Dora e Xhudit ishte ende mbi dorën e tij kur te dera u dha Antuaneta.

- JC, dikush po të kërkon në telefon, ç't'i them?

JC vuri re një shkëndijë xhelozie në sytë e zezakes.

- Thuaji që po vij, Antuanetë.

- Mos u vono atëhere! – pakënaqsia në zërin e saj ishte pothuaj e hapët.

Ajo doli dhe JC e shoqëroi me sy. Pantallonat skin-tight2. Dhe asnjë e metë! Dhe pak xhelozi? Kombinim premtues. Laver Bariu doli nga një guvë e brendshme. Do marr çiftenë, do dal për gjah. I gjithi rrush i zi, Laver, jo gjysma-gjysma, edhe dhelpra të mbyllte gojën më mirë.

3.

Mbasditja dimërore po vdiste në avenjunë e tetë. Një vetvrasje në shumë gjuhë: harakiri mbi tabelat me hieroglife japoneze, përgatitje për rimishërim në tabelat indiane, vetshpërthim terrorist në shenjat arabe. JC-së gjithnjë i dukej sikur kjo pjesë e qytetit i fshihte diçka. Zallamahia shumëkombëshe i fuste në shpirt një vetmi të çuditshme, pothuaj luksoze. Fytyrat me racë të papërcaktuar krijonin një ndjesi karnevali. Ky qytet duhet të jetë një eksperiment i dikujt, mendoi ndërsa u këmbye me disa kalimtare që nuk ishin as zezake, as filipinase, as latine, por diçka nga të treja këto. Reklamat nisën të ndrinin si të penduara duke e bërë qiellin dhe ngrehinat edhe më të huaja. Nju Jorku edhe mërzinë e kish të magjishme. Në mos të magjishme, të llojit të vet. Edhe grinë që rridhte si një ujëvarë nga retë e ulëta mbi muret e pingulta e kish tjetërlloj: gri e huaj, që nuk të donte po pa të pëtbuzur, që të trishtonte me një trill prej Wagneri. Ndërsa sheshet, sheshet sikur lëngonin me tri plagë semaforësh në kraharuar. Në të pyettë ç'plagë mori, nja tri drita semafori. Ç'dreqin blinin këta njerëz pambarim? Tabelat nuk tregonin asgjë. Qeskat plastike nuk dekonspironin. Një SMS nga Xhudi. "Do jem në barin e hotelit W sot. Thjesht për info". Just FYI3. Rockefeller Center po afronte. Atje e priste italiani Antonio. Me marlboron e përhershme në dorë. JC, amico, come vai! Hej Toni, ti picë e ftohur italiane, ku ke humbur... Përditësim 10 minutësh. Të rejat nga puna, arratisjet nga Big Apple4, femrat... Ku do shkojmë, JC? S'kam asnjë ide. Taksi! Fiuu! Taksisti nga ish-BRSS me mjekër shekullore që kish absorbuar mahorka të rëndë për shumë dekada. Ku do shkoni, xhentëllmenë? Vazhdo për skëterrë. Fraza thënë taksistit nuk ishte origjinale, ishte filmike, Al Paçino, por efektin e kishte sidoqoftë të plotë. Sidomos kur tjetri kuptonte dhe nuk pyeste për tu siguruar nëse skëterra ishte ndonjë lagje e re e padëgjuar e Nju Jorkut. Hellborough? Madison, Park avenju... Mjekra mbi timon shpjegonte, pa e pyetur kush, komplotin e fundit të qeverisë amerikane kundër jakave blu. Carnegie Bar u shfaq si toka për Kolombin. Stop! Për xhehnem u nisëm, sosëm në xhenet. Kusurin mbaje, taksist. Dhe na vjen keq për ato jakat blu.

Konjakun e solli e njëjta kameriere, shumë profesionale, me kostum të errët, me këmbë veçanërisht të hijshme. Antonio ndezi ritualisht puron që e porosiste gjithnjë me konjakun. Tymoste, shijonte dhe s'fliste. JC-ja mori një cigare nga paketa e italianit dhe i merrte erë vazhdimisht: një "ish" që s'mund ta harronte edhe pas 7 vjetësh. Pa telefonin sërisht. SMS tjetër. Kjo nga Antuaneta. Ajo do të ishte në Grand Central pas një ore. Linja e trenit 6. Thjesht për info. Just so you know. Ç'bëhet kështu, mendoi. Sindroma e kohës sonë. Shumë informacion, asnjë dije!

- Ke shkuar ndonjëherë me zezake ti, Toni?

- Po. Pse pyet?

- Kam kërshëri.

Italiani u mendua pak.

- Hm..., të nxehta janë. Dhe gjuhën e kanë të ashpër, si gjuhë maceje. Po ti kot s'po pyet.

- Jo, jo, kot pyes!

- Seç kam përshtypjen që ju shqiptarët sikur jeni një çikë racistë.

- ...

- Kot e keni. Një pino nuar e mirë s'refuzohet kurrë.

- Shiko, shiko...

- Po! Gjithë puna është a e përballon dot. Si thotë ajo kënga, "black girls want to get fucked all night, but I don't have that much jam5".

- Na fute frikën.

- Filozofi më i madh i të gjitha kohërave, Forrest Gampi, na mëson se jeta është një kuti çokollatash; ti kurrë s'e di ç'do të të qëllojë.

- Edhe?

- Po ja: fut dorën, kap çokollatë të bardhë. Fute prapë, çokollatë e errët. Të dyja shijen e vet. Të dyja i do shpirti.

JC qeshi. OK, çokollatë e errët u bëftë!

- Më duhet të shkoj në Grand Central. Toni, do më falësh.

Tjetri tundi kokën gjithë mirëkuptim. Ciao, JC! Ci vediamo.

Taksisti këtë rradhë qëlloi indian i heshtur. Asnjë shpjegim për luftën e klasave dhe marksizmin. Falemnderit, Zot! Në këtë qytet shoferët e taksive kishin maninë të tregonin që s'i bënte dot kush për budallenj. Dhe natyrisht, që qëndronin më lart se ata të Bostonit. Si çdo njujorkez, xhanëm! Antuaneta, vajza e magjisë së zezë. Ajo s'kishte probleme me Bostonin, po natyrisht, s'mund të mos e kish një litani: ishte viktimë e racizmit! Orë debatesh mbi pamundësinë e shkollimit, lagjet e këqia, me papunësi, droga të lira shkatërrimtare dhe këpucë atletike hedhur mbi telat e rrymës. Kur JC-ja i kish folur për jevgjit e lagjes së vet në Tiranë, shoqërim idesh aq i natyrshëm ky në Harlem dhe Bronksin jugor, padashur kish përjetuar momentin e parë të vërtetë të afrimit me afrikanen tërheqëse. Antuaneta kishte emigruar nga Afrika qysh fëmijë. Dy vjeç. Nuk kish në bagazh padrejtësitë qindra vjeçare të stërgjyshërve të bardhë mbi stërgjyshërit skllevër me ngjyrë. Nuk kërkonte dëmshpërblimin e famshëm. Edhe pigmenti i saj nuk ish çelur nga disa shekuj përzierje genesh me skllavopronarët. Kafe shqeto. Pa krem. Me pak. Me hidhtësi të dëshiruar. Si për vaki. Po prapë se prapë, qerthullit problematik të racës s'i shpëtonte dot. Ju paguani pak taksa, i thoshte JC-ja, si kërkoni shkolla të mira? Unë bëj më pak se 15 mijë dollarë në vit, JC! Çfarë taksash më thua?! Pastaj vazhdonin argumentet mbi kontratat milionëshe të sportistëve me ngjyrë. Të këngëtarëve. Dhe kundërargumenti i njohur, i marrë nga Chris Rock-u: ka të zinj që janë "rich", OK, por asnjë i zi nuk është "wealthy".

Stacioni Grand Central gëlonte nën rrëmujën e zakonshme të orës. Mermeri masiv dhe i rëndë i sallës kryesore përcillte diçka besnike. Ja, Antuaneta! U shfaq papritur nga dallga e turmës si një sirenë e errët. Pak më e gjatë se JC, me flokët abrazivë, pantallonat pa pushim vrasëse dhe me buzëqeshje triumfale kur dalloi shqiptarin tek hyrja e linjës 6.

- Ç'ne këtu, JC? - tha gjithë djallëzi.

- Unë jetoj në Grand Central, Antuanetë. Nuk e dije?

1 Person seksualisht tërheqës

2 Ngjitur pas këmbëve

3 Akronim për 'For your information' – Sa për dijeni

4 Qyteti i Nju Jorkut

5 Varg i një kënge të Rolling Stones me titullin "Some girls"

JC e kapi përkrahu dhe e drejtoi nga lokalet brenda stacionit.

- Ku po shkon?

- Vë bast që ke uri.

- Ti ke pirë? Mban erë alkool.

- Jo.

- Mos thuaj "jo".

- Vetëm një gotë. Nuk quhet.

- Nuk kam shumë kohë, JC.

- As unë, Antuanetë. As unë.

U ulën me sanduiçe në duar duke u mbllaçitur në heshtje.

- S'e mendoja që do vije, - tha Antuaneta.

- As unë, Antuanetë. As unë.

Ajo qeshi.

- Por mos mendo se do të dali gjë me mua, JC.

- Kurrë mos thuaj kurrë, Antuanetë.

- JC, është e rrezikshme! Për ty e kam. Ti nuk e di. Për mua edhe janë përleshur njerëzit.

- Ou?

- Po. Dy ish të dashur. Në dy banda të ndryshme. Krisën armët në mëhallë.

- Ou?

- Shiko! Unë të kam qejf, OK? Ti e di. Por nuk shkon.

- Sado të shkojë, Antuanetë. Sado të shkojë.

- Ty po të flasin hormonet, JC.

- Po!

- Mos këtu!

JC e tërhoqi pas vetes. Buzët e fryra te zezakes ishin dy ngjyrëshe. Rozë nga brenda dhe të errëta e pak të ashpra nga jashtë.

Antuaneta ndenji pasive. JC-ja i kërkoi gjuhën, por ajo nuk u përgjigj. Atij ju kujtua gjuha e ashpër si e maces, sipas Tonit, dhe ngulmoi. Ajo u shkëput.

- JC, jo këtu!

- Më ler të vij me ty.

- Ti nuk do të doje të vije me mua..., atje! Ti nuk ke asnjë ide. Po të paralajmëroj!

- Eja, Antuanetë.

Ai u çua i pari dhe ajo erdhi nga pas me mëdyshje.

Linja 6 ishte plot. Shumica të zinj. Stacionet ishin të shpeshtë. Ndërsa treni ndalonte, ai e linte veten të përplasej me Antuanetën. Gjoksi i saj të ftonte veç për marrëzi. Ndjente flokët e saj të ashpër, natyrisht të rremë, po kjo nuk kish asnjë domethënie tani. Ashtu si dhe sytë aspak miqësorë të disa pasagjerëve përreth. Duhej të shkonte patjetër me të.

- Edhe sa stacione?

- Edhe katër. Po nuk e di a do jem vetëm në apartament!

- Ti po tallesh...

- Jo. Shoqja ime e dhomës ndodh që vjen herët. Mund të jetë aty ndërkaq. Po nuk qe, atëhere kemi kohë deri në mesnatë.

- Me siguri që nuk është aty. S'ka si të jetë aty!

Dolën nga metroja. Mbrëmja ishte e errët në këtë pjesë të qytetit. The Bronx. Rrugë të ftohta dhe plehra të ditës që zbardhnin mbi trotuare. Kalimtarët të përzierë me natën. Ftohtë. JC-së iu kthjellua shikimi. Dyqanet anës trotuarëve, me dritat e zbehta, sikur e shtonin shkretimin. Arritën te ngrehina e saj.

- Prit këtu, JC. Do të njoftoj nëse jam vetëm.

Ajo u zhduk brenda ndërtesës.

Disa kalimtarë me kapuçë në kokë i hodhën ca shikime hulumtuese. SMS e Antuanetës arriti pa vonesë. Më vjen keq. Nuk jam vetëm.

Ai u nis drejt stacionit të metrosë.

Kur mbërriti në Manhattan kokën e kish ende të turbullt. Në gishta vërtiste marlboron e Tonit. Bekoi fatin që nuk kishte shkrepse. Kafshoi majën e cigares dhe shija e hidhur e duhanit sikur e ngushëlloi.

Që larg regëtinte reklama "Blue Martini". Pikaso. Goditje grushti mbi mollëz. Boksier i mundur. Ngjyrë e mavijosur - gjithnjë kish dashur të quhej Martin. Dhe pastaj reklama e hotelit W, që fillimisht i kujtoi të bardhën dhe pak më pas, fillime të pafundme pyetjesh në anglisht.

SHTËPIA ME FLUTURA

Tregim nga Mehmet Elezi



1.

Burimi është serioz dhe më jep një lajm të çuditshëm. Në një fshat në rrethinë të qytetit B. jetuakan dy vëllezër 127-vjeçarë. Deri sot bota s'ka gjetur dëshmi të besueshme për dikë, që ka kapur këtë moshë. Burri më jetëgjatë, që dihet deri sot, është japonezi Kazimiho Kamacu. Vetëm njëqind e katërmbëdhjetë vjeç e nëntë muaj. Merr Goglën e nisu. Gogla çan, i njeh udhët e malit.

Ja, për këtë të thirra, tha kryeredaktori.

I trashë, afër një kuintal e gjysmë, Gogla e sfidon nofkën përkëdhelëse mbetur nga foshnjëria. Dhe kur mendon sa i shkurtë është: një metër e gjashtëdhjetë e pesë, me gjithë këpucë! Për çdo centimetër gjatësi, një kile peshë, s'është ndonjë gjë e madhe, thotë. Ndodh që ndal veturën në mes të rrugës, shtrihet në kokërr të shpinës e zhgërryhet në pluhur si kërriç. Nuk luaj vendit pa më prurë bukë, pikë. Vdiqa. Vapën e ka tmerr. Në redaksi thuhet se verës rri në shtëpi me fustan si arabët. Të brendshme nuk duron dhe fle drejtpërdrejt në pllaka.

2.

Udhën e një dite e mbyllim përballë një vile të re. E bardhë, në shpatull të bjeshkës. Në derë përvijohet një burrë i gjatë, me setër kadifeje krahëve, urdhëroni. Mustaqet e prera shkurt e kallëzojnë më të ri. Ndërsa hurbim kafet, Gogla e pyet a ke kënd më të moshuar në shtëpi.

- Kam dy djem, m'i ka falë Zoti.

Presim ku po don me dalë.

- Sa vjeç janë?

- I kanë do vjet, i kanë. I pari është sa im atë. I dyti pak më i madh.

Nga dritarja duket oborri me lule nën pjergull, gurra me gurë të gdhendur. Një gjel i groshëm matet me pi ujë, por ndërron mendje. Lëshon një ko-ko-ko, duke shpupurisur krahët.

- Nuk po e kuptoj, thotë Gogla, me një dritëz ironie në sy. Qysh mund të jetë djali sa gjyshi i vet?

Gogla merr përsipër rolin e reporterit. Në redaksi thonë kështu bën kur shoqëron gazetarë të rinj, *kokëgjelbër.* Unë kam ardhur në gazetë kur ju pinit cicë.

- Këta vjet djemtë kanë bërë sa në tre breza, thotë burri. Kanë vënë në punë plangun që morëm prapë. Dritë në dritë, shpirti u del. Por jetojmë mirë. Një nip dhe një mbesë po shkollohen në Zvicër.

Malsorët flasin me rrotulla. Mosha e djemve paska qenë metaforë.

- A ka burra të tjerë të moçëm në katund?

- Janë dy vëllezër. Për gjynah të Zotit.

- Të moçëm sa djemtë e tu?

- Mosha e tyre është tjetërgjë. Është me libër kishe.

- Sa vjeç janë?

- Njëri 127 e do muaj, tjetri 127 pa do muaj.

Mendohet një grimë.

- Edhe 27 secili, mund të thuash.

Prapë me rrotulla.

Kallëzon rruginën përmjedis do gurëve të zinj, e shikoni? Ecni deri ku të mbyllet shtegu. Përballë është shtëpia. Për darkë ju pres këtu. Vijnë edhe djemtë.

3.

Rrugën përmjedis gurëve të zinj e kanë kapluar ferrat. Dëgjo si gëzhatin gjarpërinjtë, thotë Gogla, i prerë në fytyrë. Do të ketë edhe breshka, më ka pasë mësuar një italian si theren breshkat. Ke parë ndonjë ëndërr mbrëmë, Gogël. Ku ke ndenjur me italianë asokohe, ti?

Rrugën e mbyll një mur i nxirë. Tufë bari nëpër të çarat e tij. Një derë druri e kalbur thotë ndal. Hitha të çakërdisura mbërrijnë deri te doreza e ndryshkur.

Thirrjes o i zoti i shpisë!, nuk i përgjigjet kush. Shtëpi fantazmash? Prit kur të shfaqen shajnitë. Do të dalin prej birave të murit, në trajtë tymi fjolla-fjolla. E shtyjmë derën butë, mos me na ngelë në dorë. Çelet me gërvimë. Errësirë e trashë, erë dheu të lagët e myku. Një mori fluturash na përplasen në fytyrë. Ngjajnë me fluturat e natës, që lëshohen drejt llampës verbëtazi.

- Kush është?

Zëri del prej grykës së një pusi.

- Po na hyjnë fluturat në sy.

- Ç'e zezëditë ju pruri këtu?

Sytë mësohen me terrin, fillojmë me dallue diçka. Rreth një quku me hi janë ulur dy lëkurë të thata, në trajtë njerëzish kuk, gërmuq.

- Mirëmbrëma!

- Zimbrëma!

- Mirëvdekja!

O Zot, ç'përgjigje! Rrëqethem.

- A pranoni miq?

- Dëshirojmë vetëm një.

- Jemi dy.

- Presim tjetërkënd. Qe njëqind vjet nuk po vjen.

- ...

- Mos je Xhebraili?

Gogla mallkon nëpër dhëmbë. Rreket me i largue fluturat. Ato turren si bletët, që egërsohen kur i nguc. I varen në vetulla e në qerpikë. Vetëtimthi përfytyroj Goglën tjetër, atë të zhegut të verës, me fustan deri në fund të këmbëve si arabët dhe pa të brendshme, fluturat i depërtojnë gjithkah. Në një rrethanë tjetër do të isha shkokluar në gaz.

- Jo. Nuk jam Xhebraili.

- Hm.

- Ndoshta ju bezdisim?

- As na bezdisni, as na gëzoni.

- Të fortë mbaheni.

- Kush më ligsht se ne nuk është mbi dhé.

- Sa vjeç jeni?

- Unë 127 vjet e gjashtë muaj.

- Unë 127 pa gjashtë muaj.

- Qysh nuk qenkeni të fortë! Do të bëheni sa rrapi i Jutbinës. Treqind vjeç.

Njeri:

- Ku me e gjetë me qenë rrap. Kish me më vra reja një ditë e kisha me u kallë flakë.

Tjetri:

- Kish me më rrëzue bora një ditë e kisha me u kalbë në dhé.

Nëpër muret e plasaritura lëvizin hardhuca. Qosheve hije të varura, si vargje qepësh. Lakuriqë?

- Faleminderit që na pritët. Na jepni leje me u largue?

- Ne jemi vetë pa leje në këtë botë.

- Mund të ndez një dritë?, thotë Gogla.

- U çmende, do me na i djegë gjinden?!, hidhen të dy përnjëherësh.

Gogla më bie me bërryl. Ia mbathim, sa s'kemi ngordhë këtu. Janë të shkalluar fare.

I madhi e dëgjon. Ai që është 127 vjeç e gjashtë muaj.

- Dikur kemi qenë të çmendur. Sot jo.

Goglën e mbërthen një kollë e thatë.

- Ph, dreq!, më hyri një flutur në gojë. Një mizë e gjallë në gojë lajmëron zi.

- Nuk janë miza. Dhe mos e përmend atë që qoftë tretë. E ndjell.

- Të ndezim një dritë në oborr, të paktën. I ngreh drita e dalin.

- Nuk dalin. Nuk janë si fluturat e tjera.

- Çka janë, në mos qofshin si fluturat e tjera?

- Janë të vdekurit tanë!

Kërr-kërr, eshtrat. Gogla zverdhet.

- Kanë ardhë me na marrë, nuk na marrin dot. Dhe nuk na lënë dot. Qe njëqind vjet sillu e pështillu. Shtohen përditë.

- Pse nuk ju marrin dot e nuk ju lënë dot?

- Se nuk jemi të vdekur. Nuk jemi as të gjallë!

4.

Thonë kanë pasur babë fort të mirë, kallëzon burri, që ka dy djem sa baba i tij. Para njëqind e kusur vjetësh. Kryenëveti, s'e marrin vesh për kurrgjë. Nuk lënë fëlliqësi pa bërë. Fisi lodhet prej tyre. Hija e madhe e babës nuk le me i çartë.

I ati, burrë. Ve dy fishekë në mur të oborrit. Këta djem po ma vrugnojnë fytyrën. Kush t'i vrasë, hallall gjaku, me Kanun. Qe ku i ka fishekët!

Po i vrasim, thonë në kullën e parë.

Po i terim, thonë në kullën e dytë.

Po i çojmë hisehupun, thonë në të tretën.

Treqind pushkë në treqind shpi i marrin në shenjë.

Malsia nuk qet pushkë në të vdekurin, thotë Mus Zeneli. Ata i vrau i ati. I fali fishekët për ta.

Treqind armët ulen përnjëherësh.

Tashti i patë vetë, gjallë e në zall. Qe njëqind vjet vdekërojnë pa vdekur dot. Jeta i ka përzënë, vdekja s'i pranon. Juve nuk ju ngjiten sëmundjet e njeriut, u thotë Kajë Nokja. Mbase sëmundjet e drurëve ju bëjnë derman për në atë botë. Qe përhapur murtaja e vreshtave, *filoksera,* i thonë djemtë. Merrni rrënjë e trungje hardhish në lëngatë, thotë Kajë Nokja, shtypini e shtrydhini, pijeni atë lëng esëll, të gjallë. E pijnë lëngun deri në pikën e fundit. Faqet e rrudhura u këndellen, sikur kishin pirë verë!

Edhe një provë, thotë Kajë Nokja e moçme. Në qytet është një burrë në hjekë. E ka gërryer të brejtunit, dergja e keqe. Një birë si shpellë në nofull i kullon ditë e natë, s'i duket fundi. Nuk ulet kush skaj tij, prej erës së rëndë. A jeni të zotë me e vu gojën në atë vrimë? Me e thithë pa marrë frymë, deri ta dëlirni, ta bëni akull. Ju bie dergja e tij e ju çelet rruga e vorrit! Ata e thithin varrën, si cicën e nënës. E shterrin, e terin. Varra nis me u mbyllë, i sëmuri pip në këmbë. Ata shëndosh si parandej!

Kjo botë u ka bërë dalje.

Tjetra s'u bën hyrje.

Me libër kishe janë 127 vjeç. Edhe 27 vjeç, mund të thuhet. Aq ishin kur i ati fali fishekët e malsia nuk pranoi me qitë në ta. Enden nëpër hapësirën e zbrazët, ndërmjet dy botëve.

Shtëpia e tyre i ngjan vorrit e vorr nuk bëhet kurrë. Mbushur me flutura të zeza. Ajri brenda po trashet prej tyre. Po shndërrohet në qull të rrastë, të zi.

Charles Bukowski

POPULLI I AKULLORES

Përktheu nga origjinali Roland Gjoza

PRA, TI DO QË TË BËHESH SHKRIMTAR

nëse nuk të shpërthen ashtu pa kuptuar
pavarësisht ndonjë gjëje tjetër
mos shkruaj.
po të mos dalë pa e kërkuar
nga zemra, nga mendja, nga goja
dhe nga zorrët e tua
mos shkruaj
nëse duhet të ulesh për orë të tëra
duke parë ekranin e kompjuterit
ose i përkulur
mbi makinën e shkrimit duke kërkuar fjalët
mos shkruaj
nëse e bën për para ose për famë
mos shkruaj
nëse e bën se do të kesh femra në shtratin tënd
mos shkruaj
nëse do të ulesh aty dhe do të shkruash e shkruash përsëri
mos shkruaj
nëse të duket e vështirë edhe kur e mendon
mos shkruaj
nëse mundohesh të shkruash si një tjetër
mos shkruaj
harroje përgjithmonë nëse pret të dalë si një shkulmë e
fuqishme prej teje prit me durim
nëse nuk ulërin si një bishë
bëj një punë tjetër

nëse fillimisht do t'ia lexosh gruas tënde
ose të dashurës, ose të dashurit tënd
ose prinderve, ose dikujt tjetër nuk je gati.

mos u bëj si shumë shkrimtarë
mos u bëj si mijëra njerëz që e quajnë veten shkrimtarë
mos u bëj i trashë, i mërzitshëm dhe pretendues, mos e
konsumo më kot dashurinë për veten
bibliotekat e botës gogësijnë
kanë nevojë të flenë prej racës suaj
mos iu shto gjumin
mos shkruaj
vetëm nëse del nga shpirti yt si një raketë nëse nuk të çon
në marrëzi në vrasje apo vetëvrasje
mos e bëj
nëse dielli nuk është brenda teje duke të djegur zorrët
mos e bëj

nëse vjen vërtet koha dhe je i shenjuari njeriu me fat
gjithçka do të bëhet vetë dhe do të vazhdojë të bëhet
gjer në vdekje, ose gjer sa ajo të vdesë tek ty
nuk ka rrugë tjetër dhe nuk mund të ketë.

LIDHJA IME E PARË ME NJË GRUA TË VJETËR

kur kthej kokën pas kujtoj sjelljen e saj të vështirë
me mua më vjen turp
që isha aq i pafajshëm
por duhet të them
se ajo më mësoi të pi
dhe të dehem dhe kuptova se
jeta e saj ndjenjat e saj
ishin shkatërruar
gjatë viteve
dhe se unë
isha jo më shumë se një shoqërues
i përkohshëm
ajo ishte dhjetë vjet më e madhe
dhe e plagosur nga e kaluara
dhe e tanishmja
ajo u soll keq me mua
më tradhtoi
me të tjerë burra
ajo më shkaktoi
dhembje të pafundme
ajo më gënjeu
më vodhi
më tradhtoi me të tjerë burra
megjithatë ne kishim çastet tona; dhe
një ditë opera për një grosh
mbaroi dhe ajo në koma
në spital unë te koka
i flisja për orë të tëra
gjersa ajo hapi sytë dhe më pa;
"e dija që ishe ti!"
pështpëriti dhe mbylli sytë
të nesërmen vdiq
pas kësaj për dy vjet
piva fillikat vetëm

DUSH

pastaj na pëlqen të bëjmë dush
(më pëlqen që uji të jetë më i nxehtë se ajo)
dhe fytyra e saj është gjithmonë e qetë dhe e butë
më parë ajo më lan mua
sapunis bolet e mia
i ngre bolet,
i shtrydh
pastaj lan karin;
"hej, kjo gjë është ende e vështirë!"
pastaj hedh gjithë flokët e saj atje poshtë-
barku, shpina, qafa, këmbët
unë buzëqesh dhe pastaj e laj unë atë
së pari piçkën, ndërsa qëndroj pas saj, kari im në mollaqet
e bythës së saj sapunis me butësi qimet e piçkës
e fërkoj me lëvizje qetësuese
zgjatem ndoshta më shumë seç duhet
shkoj shkumën në pjesën e pasme të këmbëve, bythëve
shpinës, qafës, e kthej, e puth
i mbuloj me shkumë gjinjtë, barkun, qafën
pjesën e përparme të këmbëve, kyçet, kërcinjtë
dhe pastaj piçkën, edhe një herë, për fat..
një puthje tjetër dhe ajo del e para
duke u fshirë me peshqir, nganjëherë duke kënduar, ndërsa
unë ende lahem e bëj ujin më të nxehtë
duke ndierë magjishëm kohët e mira të dashurisë
pastaj dal zakonisht është mesditë dhe qetësi
dhe duke u veshur flasim për gjëra që duhen bërë
për të qenë së bashku duhen zgjidhur shumë prej tyre
dhe për aq kohë sa ato mbeten të zgjidhura
në historinë e grave dhe të burrave- janë ndryshe për
secilin. për mua është e mjaftueshme mrekullia e mbajtjes
mend të kujtimeve të dikurshme, dhembjes, humbjes dhe
pakënaqësisë me kohë koha i flak ato tej
e bëj këtë sa më ngadalë dhe butë
e bëj sikur po vdes në gjumë, në vend që të hyjë
në jetën time, ajme!

TRAGJEDIA E GJETHEVE

u zgjova nga të thatët dhe gjethet e fierit ishin zverdhur
bimët në vazo ishin bërë të gjtha të verdha si misri
gruaja ime ia kishte mbathur
dhe shishet bosh si kufoma të gjakosura
më rrethonin me padobishmërinë e tyre.
megjithatë dielli ishte ende i qeshur, ndonëse
pronarja më kishte flakur në sy faturën e qirasë të
papaguar prej kohësh
dhe gjithë kjo e verdhë gjethesh e pa dëshiruar; çfarë
duhet tani?
një humorist i zgjuar, nje stil i lashtë arti, një arlekin
gazmor mbi dhembjen absurde, se të gjitha dhembjet janë
absurde sepse ato ekzistojnë, asgjë më shumë.
u rrova me kujdes me një brisk te vjetër
unë që kishte qenë dikur i ri
për të cilin thonin se kishte dell gjenialiteti;
por kjo është tragjedia e gjetheve;
fieri i vdekur, bimët e vdekura;
dhe hyra në një sallon të errët ku qëndronte pronarja
me një denoncim të fundit për të më dërguar në ferr
hapi krahët e saj të dhjamosur dhe të djersitur
dhe ulëriu për qiranë bota kishte dështuar për të dy.

PAMJE

një herë bleva një lepur lodër në një tregtizë
tani ai rri ulur dhe mediton
për mua me sytë e pastër ngjyrë pink

ai do topa golfi dhe mure qelqi
unë dua bubullima të qeta

zhgënjimi qëndron midis nesh

NJË GRUA NË RRUGË

vetëm këpucët e saj
do të më ndriçonin dhomën
si një mijë qirinj

ajo kalon si të gjitha gjërat
shkëlqen në qelq
si të gjitha gjërat
që bëjnë diferencën

dhe largohet

PO, PO

kur Zoti krijoi dashurinë, ai nuk u kujdes aq shumë për të
kur Zoti krijoi qentë, ai nuk i ndihmoi qentë

kur Zoti krijoi bimët, ai ishte në nivel mesatar
kur Zoti krijoi urrejtjen, ne kishim një leverdi të dobishme
kur Zoti më krijoi mua, ai më krijoi mua
kur Zoti krijoi majmunin ai ishte duke fjetur
kur Zoti krijoi gjirafën, ai ishte i dehur
kur ai krijoi narkotikët, ai ishte në nivel të lartë
dhe kur ai krijoi vetëvrasjen, ai ishte në nivel të ulët

kur ai të krijoi ty shtrirë në shtrat
ai e dinte çfarë po bënte
ai ishte i dehur dhe ai ishte lart
dhe ai krijoi malet, detin dhe zjarrin në të njëjtën kohë

ai bëri disa gabime
po kur të krijoi ty shtrirë në shtrat
ai ishte i plotë në të gjithë universin e tij të bekuar

PËR ATO QË KISHIN GJËRA PËR TË THËNË

atje ishin tre kanarina dhe një pemë limoni
dhe një plake me lytha;
dhe unë isha atje, një fëmijë dhe preka tastat e pianos
ndërsa ato flisnin por jo me tingull të fortë
dhe pashë kur mbuluan kanarinat natën
me thasë mielli;
"që ato të flenë, e dashura ime!"

i bija pianos qetësisht një notë në një kohë
kanarinat nën thasë dhe një pemë piperi atje
pema e piperit frushullonte mbi çati si shi
dhe varej jashtë dritareve si shi i gjelbër
ato flisnin, të treja së bashku
ulur në gjysmë errësirën e natës së ngrohtë
dhe tastat e pianos ishin të bardhë dhe të zinj
dhe i përgjigjeshin gishtërinjve të mi
si një kuti magjike e mbyllur e një bote që rritej në pritje;
ato tani kanë ikur, ato të treja dhe unë jam bërë plak
piratët kanë shkelur me këmbë dyshemenë me kashtë të
pastër të shpirtit tim
dhe kanarinat nuk këndojnë më.

KËTË ÇAST UNË MUND TË SHKRUAJ POEZINË MË TË BUKUR PËR DASHURINË

më dëgjo, i thashë
pse nuk më lëpin në bythë?
jo, tha ajo
nëse unë të lëpij në bythë edhe ti duhet të më lëpish në bythë
mirë, tha ajo
përkula kokën dhe fillova të shikoj aty rrotull
hapa një vrimë dhe lëviza gjuhën në të
jo atje! tha ajo. ha,ha,ha, jo atje! nuk është ai vendi.
ju femrat keni më shumë vrima se djathi zviceran.
unë nuk dua që ti ta bësh atë punë
pse?
pastaj duhet që unë ta kthej dhe në takimin e parë me miq
ti do thuash se të kam lëpirë bythen me gjuhë
ashtu të duket, por unë të premtoj se nuk do ta bëj
do të bjerë në kokë pija dhe do ta bësh.
mirë, pranova
rrotullohu, do të lëpij në një vend tjetër
ajo u rrotullua dhe unë e lëpiva në një vend tjetër
ne ishim të dashuruar, përvec asaj që thashë në takimin me miq
ne nuk e donim njëri-tjetrin si të dalldisur
ajo më kërkon që unë të shkruaj një poezi të llojit tjetër
një poezi të vërtetë për dashurinë
por unë mendoj se po të mos duam bythët e njëri-tjetrit, pordhët dhe mutin dhe gjërat e tjera të turpshme dhe të tmerrshme ashtu siç duam gjërat e mira, kjo s'mund të quhet plotësisht dashuri

POPULLI I AKULLORES

e dashura ma ka hequr përkohësisht shishen nga dora
dhe palloshi fryhet e ngrihet më mirë
megjithatë gjërat ndryshojnë brenda natës
në vend që të dëgjojmë Shostakoviçin dhe
Mozartin, nëpër tymin e duhanit që të mbyt
netët ndryshojnë, ngatërresa të reja shtohen
për në Baskin- Robbins grahim
31 lloje e shije të ndryshme;
udha shkëmbore, çamçakiz tollombace, kajsi e ngrirë, luleshtrydhe
kek me djathë, çokollatë me dhjozëm...

parkojmë jashtë dhe shikojmë njerëzit
me akullore
populli i shëndetshëm dhe i kënaqur
një mundësi vetëvrasjeje më shfaqet në horizont
(kaq shumë njerëz sikur po votojnë)
dhe i them të dashurës;
"çfarë mund të thonë çunat po të më shohin midis tyre
ndoshta iu shkon mendja se po gjuaj ndonjë pjeshkëz të njomë."
"eja, kulish," qesh ajo dhe ne hyjmë në turmë
ne mes te popullit te akullores.
asnjë prej tyre nuk shan, s'i kërcënon njeri
shitëset dhe s'shoh një të dehur, askush
nuk ankohet
alarmohem prej kësaj paqeje dhe qetësie të shurdhër
që më rrethon e ndiej veten si një pede në një konkurs
bukurie. më në fund marrim harxhet tona
ulemi ne makinë dhe fillojmë të hamë.

s'kam si e mohoj se këto gjëra janë kaq famoze, sa më
duket sikur marr lajme të reja nga bota (miqtë më thonë
se dukem më mirë se çdoherë. ti dukesh aq mirë, më thonë
ata, sa na vjen çudi si kemi menduar se ti atje aq e pate..)
e kanë fjalën për 4500 net skëterre, burgje, spitale..

dhe gjer vonë atë natë palloshi u përdor për pallim dhe
dashuri që zgjati dhe ishte i vërtetë
dhe i lavdishëm më pas folëm për gjëra të thjeshta
dy kokat tona ngjitur me dritaren e hapur nën dritën e
hënës dhe ne vështronim përjashta, pastaj ramë të flinim
në krahët e njëri-tjetrit
populli i akullores më bëri të ndjehem mirë
nga jashtë dhe nga brenda.

GRUAJA E POETIT TË VDEKUR

ajo më tha se isha i pandjeshëm
se nuk kisha respekt për Zotin apo dashuri
për kafshët. dhe çdo mizë ka shpirt,
tha ajo

ishim në një dhomë moteli në plazhin e
Lagunës. ajo ishte mbi peshë
dhe unë gjithashtu dhe ndoshta
në këtë rrethim të madh të elementeve të natyrës
ne të dy kishim shpirtra
si mizat

e ktheva shishen
dhe e boshatisa.

" dreq," tha ajo, " dhe Williami pinte shumë.
mendoni se në këtë mënyrë jeta mund të bëhet
më e bukur?
" po, prandaj pi."
" nuk ju pëlqejnë bukuritë e natyrës?" pyeti
ajo. nuk ju shkon ndonjëherë nëpër mend mrekullia
e lindjes?"
" unë mendoj për mrekullinë e vdekjes."
" unë mendoja se ju ishit një poet i madh,"
tha ajo, " por tani që ju takova dhe ju njoha më mirë, nuk
mendoj kështu. ju nuk do të më përdorni më."
"unë nuk ju kam përdorur," iu pergjigja
dhe ju e dini mirë këtë."

ishte ora 3 e mëngjesit dhe une dola
nga dhoma e motelit me një tjetër pije në dorë.
isha veshur me të shkurtra dhe pasi mbarova pijen u
hodha në pishinë. të gjitha dritat ishin shuar. menazheri
kaloi aty pari, ndërsa unësi një qen notova në errësirë

" ç'dreqin je duke bërë aty?" m'u skërmit
"po ndez dritat e pishinës," ia ktheva me skërmitje dhe unë.

dritat erdhën dhe unë i rashë përqark pishinës
dhe për 5 minuta të tjera, pastaj kërceva sipër dhe eca
për në dhomën e motelit.

ajo ishte në shtrat dhe më kishte kthyer kurrizin
mora një tjetër pije dhe pashë
dhjamin që më kishte kërcyer nën tesha
dhe thashë me vete se kisha dhjamosjen më të bukur
në botë
pastaj dritat e pishinës u shuan dhe gjithçka që pashë
ishte shkëlqimi dhe fundi i cigares sime
dhe thashë me vete se në këtë rrethim të madh
të elementeve të natyrës
padyshim që kishte
një shpirt.

Më 27 mars u nda nga jeta shkrimtarja e shquar kroate *Dubravka Ugrešić*

MINISTRIA E DHIMBJES

nga Dubravka Ugrešić

1

"Peizazhi nordik të sjell ndër mend absolutizmin, si shkretëtira. Përveçse, në këtë rast, shkretëtira është e gjelbër dhe e pasur me ujë. Nuk ka relieve, rrumbullakësi, lakime. Toka është fushë, njerëzit janë të ekspozuar dhe kjo dukshmëri e plotë përcakton sjelljen e tyre. Holandezët nuk takohen, ballafaqohen me njëri-tjetrin. E ngulin vështrimin e tyre të çelët te personi tjetër dhe ia peshojnë shpirtin. Nuk ka vend ku njerëzit të mund të fshihen. Ato nuk janë as shtëpitë e tyre. I mbajnë perdet në dritare të mënjanuara dhe e quajnë këtë një virtyt".

Cees Nooteboom

Nuk e mbaj mend kur e vura re për herë të parë se dija të qëndroja në stacion për të pritur tramvajin, duke ia ngulur sytë hartës së qytetit poshtë xhamit, me rrugët shumëngjyrëshe të autobusëve dhe të tramvajeve, që nuk i kuptoj dhe që mezi më interesojnë; të rrish kështu pa menduar për asgjë dhe përnjëherësh të pushtohesh nga dëshira e papritur për ta përplasur ballin pas xhamit dhe të vritem. Dhe çdo herë më duket se jam më pranë, se jam gati ta bëj, ja tani, për një sekondë…

- Shoqe, nuk doni…?- thotë me ton ironik dhe më cek supin me gisht.

Vetëm po e imagjinoj. Imazhi që kam në mendje ndonjëherë është kaq i gjallë, saqë më duket vërtet se e dëgjoj zërin e tij dhe e ndiej prekjen e tij në supin tim.

Thuhet se holandezët flasin vetëm kur kanë diçka për të thënë. Këtu, ku jam e rrethuar nga gjuha holandeze dhe komunikoj në anglisht, gjuha ime amtare më duket e huaj. Që kur gjendem jashtë shtetit, e kam vënë re se si bashkatdhetarët e mi komunikojnë me një lloj gjysmëgjuhë. Është sikur t'i hanin fjalët përgjysmë, sikur të nxirrnin gjysmëtinguj. E përjetoj gjuhën time amtare si përpjekjen e invalidit gjuhësor, që e mbështet çdo mendim, edhe më elementarin, me gjeste, ngërdheshje dhe tone. Bisedat mes bashkatdhetarëve të mi më duken të gjata, rraskapitëse dhe të pavlera. Në vend që të flasin, është sikur i japin njëri-tjetrit një goditje të lehtë me fjalë dhe e mbështjellin njëri-tjetrin në një shkumë të ngjitshme tingujsh.

Prandaj kam përshtypjen se po mësoj të flas vetëm tani, këtu. Nuk është e lehtë, në çdo çast kërkoj një hapësirë për të marrë frymë, vetëm që të mos duhet të përballoj faktin se nuk jam në gjendje të them atë që kam për të thënë; vetëm që të mos duhet të përballoj çështjen, nëse është e mundur të bësh atë që do, për shembull, të tregosh një histori me një gjuhë që nuk di të përshkruajë realitetin, sado i nyjëzuar të mund të jetë perceptimi i brendshëm i këtij të fundit.

Sepse unë isha mësuese letërsie.

Pasi mbërritëm në Gjermani, Gorani dhe unë u sistemuam përkohësisht në Berlin. Ishte një vendim i Goranit, në Gjermani mund të shkoje pa vizë. Kursimet tona nuk ishin të pakta, do të mjaftonin për një vit të tërë. Unë fillova shpejt t'ia dilja mbanë. Ruaja fëmijët e një familjeje amerikane. Paguanin më se ndershmërisht dhe ishin njerëz të këndshëm. Gjeta edhe një punë në Bibliotekën Kombëtare, ku njëherë në javë rregulloja librat e seksionit të sllavistikës. Duke u mbështetur në ndonjë nocion të biblioteko-ekonomisë dhe meqë flisja rusisht, përveç gjuhës sime amtare dhe meqë arrija t'i kuptoja gjuhët e tjera sllave, e përfundoja punën me lehtësi. Më paguanin në të zezë, sepse nuk kishte mënyrë tjetër. Gorani, që ishte docent në Fakultetin e Matematikës së Zagrebit, gjeti menjëherë punë në një shoqëri të informatikës, por e la pas pak muajsh. Një koleg i Goranit kishte gjetur vend në një universitet të Tokios dhe e kishte ftuar disa herë t'i shkonte pas, duke e siguruar se do të kishte gjetur punë me lehtësi. Gorani u përpoq gjatë të më bindte të nisesha, por unë nuk pranova, duke nxjerrë si shkak se atje, në Evropën Perëndimore, do të isha më afër nënës sime dhe prindërve të tij. E gjitha kjo ishte e vërtetë, por kishte edhe diçka tjetër.

Gorani nuk arrinte dot të pranonte asgjë nga ajo që kishte ndodhur. Ishte një matematikan i shkëlqyeshëm, i parapëlqyer nga studentët, por megjithëse ishte marrë gjithmonë me një lëndë "asnjanëse", u pushua nga puna papritur e pakujtuar. Përpjekjet për ta bindur se ishte "normale" - që në luftë njeriu i mesëm të sillet gjithmonë në të njëjtën mënyrë, se tashmë u kishte ndodhur shumë njerëzve, kroatëve në Serbi dhe serbëve në Kroaci, myslimanëve, kroatëve dhe serbëve në Bosnjë, hebrenjve, shqiptarëve dhe *romëve*, se e gjithë kjo i kishte ndodhur kujtdo dhe kudo në ish-vendin tonë fatkeq - nuk shërbyen për ta shpëtuar nga ajo ndjenjë pezmatimi e bashkuar me vetëmëshirë.

Po të kishte dashur vërtet Gorani, mund të ishim vendosur në Gjermani. Atje kishte me dhjetëra mijëra si ne. Pranonin punë të çdo lloji dhe pastaj në një mënyrë a një tjetër, e gjenin rrugën e tyre. Dhe jeta bënte para, edhe fëmijët përshtateshin. Ne nuk kishim fëmijë, ndoshta kjo e lehtësoi vendimin tonë. Nëna ime dhe prindërit e Goranit jetonin në Zagreb. Pasi kishim ikur, apartamenti ynë (i imi dhe i Goranit) u kërkua nga ushtria kroate, që sistemoi familjen e një ushtari. I ati i Goranit u përpoq të merrte sendet tona nga apartamenti, por pa ia dalë dot mbanë. Gorani, në fakt ishte serb dhe unë sipas gjasës "kurva serbe" e tij. Në fatkeqësinë kolektive, ajo ishte koha e shpagimeve të forta, nxirrej dufi mbi kë të mundeshe dhe mbi kë ia dilje dot mbanë, në pjesën më të madhe të rasteve mbi të pafajshmit.

Lufta i rregulloi raportet shumë më mirë nga sa do të kishim qenë në gjendje të bënim ne. Gorani ishte larguar nga Zagrebi me qëllimin e prerë për t'u shpërngulur sa më larg që mundej, dhe në fund përfundoi vërtet në anën tjetër të botës, në Tokio. Shumë pak kohë pas nisjes së tij, e njohura ime Ines Kadiç, më ftoi të jepja mësim për dy semestre *servo-kroatisch* në Fakultetin e Sllavistikës së Amsterdamit. Burri i saj Cees Draaisma, ishte Drejtori i Departamentit. Në atë çast nuk kishte asnjë tjetër të disponueshëm dhe unë e pranova ftesën pa u menduar as edhe një sekondë.

Departamenti mori me qira për mua një apartament në *Oudezijds Kolk*. Ishte fjala për një rrugë të vogël, në anën e së cilës shikonin gjithsej pak shtëpi dhe që nga njëra anë mbinte papritur në stacionin qendror të Amsterdamit dhe nga tjetra, si kërcelli i një gjetheje palme, bigëzohej në *Zeedijk* një rrugë e kontrolluar nga kinezët, dhe në *Oudezijds Voorburgwal* dhe *Achterburgwal*, dy rrugë të lagjes me "drita të kuqe". Apartamenti ishte i vogël dhe i vendosur në katin bodrum, si dhoma e një hoteli me çmim të lirë. Ishte e vështirë të gjeje apartamente në Amsterdam, të paktën sipas sekretares së Departamentit, dhe unë u dorëzova. Lagja më pëlqente. Në mëngjes e kisha zakon të merrja rrugën përgjatë *Zeedijkut* në drejtim të *Niewmarkt*, ose hidhesha për në *JollyJoker*, te *Theo* ose te *Chao Phraya*, kafene që shikonin nga ana e *De Waag*-ut të vjetër. Duke gjerbur kafenë e parë të ditës, vëzhgoja njerëzit që kalonin midis banakëve me harenga, perime, kallëpe djathi holandez dhe mori paninesh të freskëta. Ajo ishte zona me përqendrimin më të lartë të personazheve të çuditshëm. Aty fillonte lagja me "drita të kuqe", rrugët e saj frekuentoheshin nga shpërndarës të vegjël, prostituta, shtëpiake kineze, rrufjanë, toksikomanë, pijanecë, qejflinj të vjetër, pronarë të aktiviteteve të vogla, ambulantë, çirakë, turistë, të papunë, të emargjinuar dhe të pastrehë. Kur qielli ngushtohej (qielli i famshëm i Holandës) dhe shtrihej me zymtësinë e tij mbi qytet, kënaqesha me fluksin e ngathët të kalimtarëve heterogjenë. Gjithçka dukej disi e mjerë, e mbytur, ose e ngadalësuar me diçka bishtnuese, por si e përshkuar nga një urtësi më e thellë jete. Universiteti gjendej në *Spuistraat*, nja dhjetë minuta në këmbë nga apartamenti im. Gjithçka, të paktën kështu m'u duk në fillim, gjendej plotësisht e vendosur në hapësirë. Vera e San Martinos, ishte zgjatur atë vit deri në nëntor, saqë Amsterdami aq i butë dhe i ngadalshëm, më kujtonte lokalitetet e bregdetit Adriatik jashtë stinës.

Historinë e asaj gruaje boshnjake e kisha dëgjuar në Berlin, përpara mbërritjes sime këtu. Familjes së saj iu desh të strehohej jashtë shtetit: i shoqi, fëmijët, prindërit e të shoqit… Një ditë, i erdhën në vesh zëra, sipas të cilëve autoritetet gjermane do t'i internonin refugjatët, duke i kthyer në Bosnjë. Nga frika se mos do t'i duhej të kthehej mbrapsht, gruaja iu lut një mjeku t'i nënshkruante një kërkesë të rreme për t'u shtruar në spitalin psikiatrik. Ai qëndrim prej dy javësh në çmendinë, ishte për gruan një frymë lirie kaq e fortë dhe joshëse, saqë me të dalë nga spitali vendosi të mos kthehet më në shtëpi. U zhduk, ndryshoi identitet dhe nuk u kthye më te të vetët.

Kam dëgjuar me dhjetëra histori të ngjashme. Lufta për shumë ka qenë një humbje, por edhe një arsye e mirë për të mos pranuar jetën e hershme dhe për të filluar një të re. Lufta e ndryshonte ekzistencën e njerëzve. Çmendinat, burgjet dhe gjykatat, u bënë pjesë e jetës së përditshme.

Nuk isha aspak e sigurt se cili ishte roli im në të gjithë këtë. Ndoshta edhe unë kërkoja një alibi. Nuk kënaqesha me statusin e refugjatit, por pikërisht si refugjatët nuk kisha një vend në të cilin të kthehesha. Ose të paktën, kjo ishte ajo që ndieja. Ndoshta edhe unë, si shumë të tjerë, në mënyrë të pavetëdijshme, kisha përvetësuar fatin e keq të të tjerëve për t'i përligjur vetes sime se nuk doja të kthehesha. Nga ana tjetër, shpërbërja e vendit dhe lufta a nuk kishin qenë vallë shkaku i fatkeqësisë sime dhe një arsye e mirë për të ikur? Nuk e di. Di vetëm se kisha ikur prej kohësh dhe se ende nuk kisha mbërritur në asnjë drejtim. Pas nisjes së Goranit, kisha provuar një ndijim lehtësimi të përzierë me një ndjenjë të fortë humbjeje dhe frike. Sepse papritmas gjendesha krejtësisht vetëm, me diturinë time si kapitalin e vetëm të vogël dhe me kursimet e mjaftueshme sa për pak muaj. Isha diplomuar në gjuhën dhe letërsinë sllave jugore. Kështu, me doktoratën time për përdorimin e dialektit kajkav në veprat e shkrimtarëve kroatë dhe disa vitesh mësimdhënieje pranë Universitetit të Pedagogjisë së Zagrebit, u gjenda në Amsterdam. Amsterdami ishte një ajër i freskët i paguar shtrenjtë. Çfarë do të bëja dhe ku do të shkoja më pas, nuk e dija.

(Fragment nga romani, sh.b. Dituria 2009)

Shqyrtim i librit "Lepurushi i mallkuar" nga autorja koreane Bora Chung, i sapoardhur në shqip nga "Onufri"

Si ta mbash një *Lepurush të mallkuar*?

Nga Andreas Dushi

Në një prej të paktave intervista që ka dhënë gjatë jetës së tij, Francis Bacon thotë se epiteti "i llahtarshëm" i duket tërësisht i papërshtatshëm për pikturën e tij. Kjo, pasi ai, mendim i imi ky, nuk krijon art për frikë (arti s'mund të të frikësojë), por për të freskuar estetikën e deriatëhershme, joperfekte (po në të njëjtën intervistë, thotë se pas Piçasos, nuk gjen një tjetër piktor për ta vlerësuar).

Ai e dha intervistën pak para vdekjes, kohë kur e imagjinoj të lodhur, të molisur, me pamje plot elementë nga formatimet artistike të pikturave të tij dhe e gjitha kjo tablo nga imagjinata mu kthye në tekst ndërsa lexoja tregimet e "Lepurushi i mallkuar". Po të vazhdoj t'i qëndroj analogjisë me pikturat, libri duket si ekspozitë *horror*, sikurse hamendësoj duhet të kenë qenë ekspozitat e Baconit në gjallje të tij.

E gjithë natyra e pjesës më të errët të një kombi, ajo e palavdishmja që mbahet e fshehur për të mos u rrëfyer kurrsesi, asnjëherë, shpaloset në plotni brenda kornizës së librit, por sigurisht, korniza nuk mjafton, prandaj vërehet se diku ndodh shkëputja e njërës anë të saj dhe aty zë fill një tjetër kornizë, me në brendi mundësinë të shpalosë të sotshmen e ndërsyer prej keqmenaxhimit të kapitalizmit (jemi në Korenë e Jugut – Korea e Veriut i tmerron me mungesën e mëvetësisë së kapitalit). Historia si e shkuar nuk është më *magistra vitae*, sikurse thonin latinët. Tanimë ajo i përket një konteksti krejt të parrokshëm, ku nuk përket asnjëri prej tregimeve, përveç atij që i jep titullin, ku dhe dua të ndalem pak më gjatë, duke e parë pikërisht në këtë këndvështrim.

Fetishizmi me *të mallkuarën*, nevoja për të thirrur *të keqen për tjetrin* që të triumfojë *e mira për veten* ka nsur njëkohshëm me zanafillën, është pika ku filli rroket (shiko Kainin, e vret Abelin pse flitë e atij drejtuar Hyjit pëlqeheshin – kështu, po ta vriste, mendoi se pëlqimin e Hyjit do ta merrnin flitë e tij). Vëllavrasja nuk është objekt i këtij tregimi, por diktonomia mes së mirës dhe së keqes si hapësirë ku ndodh zhbërja e dilemës morale dhe konkretizohet mungesa e parimeve të atilla, shtruar prej Platonit.

Po *koka* e një tufe mbetjesh? Çfarë njeriu nxjerr jashtë vetes, i mendon si tërësisht të padobishme, pasi jeta, duke u shkëputur prej bartëses së tyre, pra njeriut, ka marrë fund. Jo! Fundi është fillimi i ri. Kjo sentencë e famshme, atribuuar kushedi sa filozofëve e sa popujve, merr trajtë konkrete në tregimin *Koka*.

E papritura a është një tipar thelbësor i letërsisë? Thuhet se po, ndonëse në letërsinë realiste, deduksionet shpjenin kollaj në shpjegime që e shmangnin tërësisht idenë e së papriturës. Ndërsa sot, në bashkëkohësi, e kërkojmë, duam të befasohemi, paçka se ndodh përherë e më rrallë, ndoshta ngaqë, ndonëse mund të mos e besojmë, **të gjitha historitë kanë ndodhur**. Pra, jemi në një rreth vicioz kur rindodh e njëjta gjë, pambarimisht, e ndarë në miliarda gjëra të vogla që gjithashtu përsëriten në jetën e gjithkujt. Kur njerëzimi a njeriu të jetë në gjendje ta gjej cila dhe si është apo ishte ajo *gjë e njëjtë para se të ndahet*, atëherë bota do ta humbasë kuptimin dhe njerëzimi do të kthehet në makineri e vënë në punë prej aplikimit të Inteligjencës Artificiale, pasi ajo natyralja do të jetë zbërthyer tërësisht.

E gjitha kjo bën që *befasia* të transmetohet si normalitet, ndaj edhe ne, edhe pse e dimë që *po befasohemi*, e pyesim veten me qetësi, mos vallë asgjë s'ka ndodhur?

Kështu ndodh në tregimin *trupëzimi*. Një vajzë, pa asnjë marrëdhënie seksuale, ngelet shtatzënë pasi merr pilula kundër shtatzënisë për të ndaluar menstruacionet. Sigurisht, atë e shoqëron *befasia*, por shpejt s'ka më kohë për të: Tani i duhet *të gjejë baba për fëmijën*. *Befasitë* zëvendësojnë njëra-tjetrën deri në atë pikë saqë kuptimi i tyre zhbëhet në të zakonshmen, ose më mirë, e zakonshmja i gllabëron.

Lufta mes nevojës për ekzistencën e befasisë dhe jetës në një pikë përtej asaj sendërton materialin e disa tregimeve në vëllimin që modestisht po shqyrtojmë.

Po mirë, cili është tregimi që i jep titullin vëllimit? Çfarë ndodh aty? Ngjarja, historia...? Asgjë! Nuk mund të tregoj asgjë! Përkundrazi, mund *të mos tregoj*. Mbajtja e të fshehtave... Është edhe ky një lloj fetishizmi? Nxitemi, ndjellemi ne nga ky shkak? Apo na ndjell nxitja e fantazisë së atij prej të cilit po e mban të fshehtën? Po cila, dreqi e mori është kjo e fshehtë? Dhe, mbi të gjitha, pse i kemi dhënë *statusin e së fshehtës*?

Letërsia është një lloj interteksti i pafundëm. Ndër legjenda, shpesh kafshët flasin. Ezopi u jep atyre jo veç fjalë (logos, pra aftësi për të menduar e për të folur), por edhe shpirt, aftësi për të ndjerë. Këtu e kap Chang fillin e lëshuar dhe e ngre në piedestalin e faqes së bardhë, në tregimin *Çarku*. Dhelpra flet, flet dhe vuan. Prej saj djali nuk flet, nuk flet dhe bën të tjerët të vuajnë. Personazhet e tjerë përziehen mes këtyre dy gjendjeve, të folur – të mosfolur dhe vetëm vuajnë, edhe kur mendojnë se nuk po u ndodh kjo.

Kapitalizmi si kapistall i sjelljes njerëzore, në këtë tregim, merr përmasën e tij më reale. Për hir të krijimit të kapitalit, njeriu sakrifikon humanizmin, por hierarkia e sakrificës shkon përtej: Ai është gati të shpërbëjë familjen, të shkatërrojë jetën dhe të sakatojë e mandej shpjejë drejt vdekjes krijesat e tija, fëmijët!

Grykësia, sipas Dantes, është mëkat po aq i madh sa kurrnacëria. Të dy këto kategori prehen në të njëjtin rreth të ferrit. Ndoshta sepse të dy janë të gatshëm të ndërtojnë vetë *ferr* për të tjerët.

E përmenda diku më lart Inteligjencën Artificiale. Sot *ChatGTP* është burim bashkëbisedimi për shumëkënd, sikundër *Siri* ishte dje apo *Bixby* pardje. Kolektivizimi i gjithë këtyre inteligjencave artificiale çfarë sjell? O Zot, as nuk do të doja ta imagjinoja, po mos të ma tregonte *Lamtumirë, dashuria ime* e Borës. Nga çasti kur e mora vesh, jo vetëm nuk resht dot së imagjinuari, por as nuk mund t'i jap fund së përjeturarit të frikës dhe ankthit nga ky realitet që jo vetëm nuk po provojmë ta shmangim, por po e thërrasim buzëqeshur, sikur po bëjmë *pstpstpst* kur shohim ndonjë mace.

Ne përndiqemi nga vetja jonë! Kontekstet mund të krijojnë hapësira fikse jashtë të cilave, po dolëm, do të gjykohemi njëlloj si brenda tyre. Kjo ndodh te *Shenja* ku pafajësia nuk shihet si mundësi, sepse mundësia për ta treguar veten, jashtë gllabërimit prej *të padrejtit* a *padrejtësisë* i është mohuar përherë. Ai di të jetojë si dikush që mbrohet, askush s'e ka mësuar ndryshe, askush s'e ka lënë të provojë se si është ndryshe!

Ndërsa tre tregimet e fundit nuk kam pse t'i përmend! Në to, rrokullisja e botës dhe kokëposhtësimi i saj paraqiten në tre dimensionet e tyre: Atë të frikës, atë të ankthit dhe atë të dashurisë! Është e çuditshme sesi një autore ia del t'i ndërtojë me thjeshtësi rrëfimet për këto tre tema, rrëfime me qetësi të ndërlikuar ndër nyja ku limfa e jetës së tekstit nuk resht së lëvizuri, por kthehet në helmin e fundit të aftësisë perceptuese njerëzore. Gjithë mësimet e deritanishme shndërrohen në pluhur buzë dallgëve të së mundshmes, por që burojnë nga deti për të cilin deri tani kushdo e ka quajtur *Det i së pamundshmes*.

Sikur dikush të ulej e të shkruante një studim për këtë libër, titull metaforik shumë i përshtatshëm kish për të qenë "Notimi i dallgëve të së mundshmes dalë prej detit të së pamundshmes". Ose kjo është sentenca e zbërthimit të kuptimit që merr perceptimi i mundësisë se ndërgjegjja njerëzore zbërthehet edhe nëpërmjet një libri. Një libri si "Lepurushi i mallkuar", një mallkim aq i egër për zvetënimin njerëzor nga një krijesë kaq e butë!

THEODOR DALLTA, MES IKONOGRAFISË BIZANTINE DHE PIKTURËS ITALIANE

nga Fjoralba Prifti



Fillimi i shek. XX solli shumë ndryshime në të gjitha aspektet e jetës, si sociale, arsimore, kulturore dhe gjithashtu dhe me natyrë patriotike. Shumë personalitete të shkolluar dhe të formuar nëpër universitete europiane u rikthyen në Shqipëri, me synimin e çuarjes përpara dhe zhvillimit të shoqërisë dhe shtetit shqiptar drejt një rruge europiane.

Korça, është qyteti me shembullin më të mirë dhe me numrin më të madh të përparimtarëve të cilët, kontribuuan dhe ndikuan në rilindjen dhe krijimin e një qyteti me frymë perëndimore.

Pjesë e këtyre përparimtarëve ishin dhe artistët, si Vangjel Zengo, apo Todi Dallta, K. Rafail apo Ballkameni, e shumë të tjerë, të cilët, të studiuar në vendet fqinje, sollën mësimet dhe eksperiencat e tyre në Korçë dhe jo vetëm.

Mundësia e tyre, të jetonin, të studionin, të arsimoheshin i çoi ata drejt një mentaliteti të lirë dhe pro europian, ku të gjithë të ecnin me hapin e kohës, dhe me lëvizjet e shek. XX, të cilat bazoheshin pikërisht në besimin themelor për përparimin e shoqërisë.

Kjo ishte një kohë revolucioni dhe për kishën ortodokse, e cila kishte disa kohë që kishte filluar të revolucionohej dhe më në fund të shpallte mëvetësinë nga kisha ortodokse greke.

Për here të parë, ikonat nuk pikturoheshin më në bazë të rregullave strikte të artit bizantin, por sollën ndryshime rrënjësore, që nga mënyra e paraqitjes së skenës biblike, konceptimit të saj, si dhe ekzekutimit final. Tradita bizantine pothuajse ishte zhdukur nga ikonat dhe vendin e saj e kishin zënë kopjet e piktorëve të mëdhenj italianë. Megjithatë kishat bizantine funksiononin në po të njëjtën mënyrë, ashtu si dhe sot, dhe përsipër kompozimit të ikonave apo afreskeve shkruhej emri i shenjtorit, emrat e dhuruesve si dhe emri i autorit, të cilat për here të pare, filluan të shkruheshin në gjuhën shqipe.

Si pjesë e një epoke ndryshimesh dhe krijimesh identitetesh, Todi Dallta, zuri vend si një prej piktorëve më të mirë të asaj kohe, dhe ashtu si dhe kolegët e tjerë artistë ndryshuan mënyrën e jetesës, duke i përcjellë shoqërisë së asaj kohe, pakëz aromë perëndimore, emancipim dhe përparim. Kjo vihej re në çdo element të bukur artistik që ata krijonin me shumë dashuri dhe përkushtim.

Todi Dallta, i lindur në Voskopojë, mbaroi Akademinë e Arteve të Bukura në Athinë, punoi për pak kohë në Greqi dhe më pas u rikthye në Korçë, ku jetoi dhe punoi gjithë pjesën tjetër të jetës së tij.

Fillimet artistike të tij ishin afresket nëpër kisha në Greqi si dhe ikona të ndryshme, të cilat më vonë i zhvilloi edhe në qytetin e Korçës. Leksionet mbi artin në Akademinë në Greqi, njohja me artistët e mëdhenj europianë, si dhe eksperienca e tij, e mbante gjithmonë në kërkim të stileve dhe mënyrave të reja të krijimit të skenave, apo personazheve biblike.

Kopjimi dhe realizimi mbi shumë prej tablove kryesore të italianëve të shek. XVI, jo vetëm rriste zhvillimin artistik si dhe shumëllojshmërinë e punëve të tij. Gjithmonë në kërkim dhe zhvillim të identitetit të pikturës së tij, pjekjes artistike, vihen re dallime të ndryshme të stilit të të punuarit nga njëra periudhë në tjetrën apo nga njëra kishë në tjetrën, nga një telajo apo ikonë në tjetrën.

Pas kthimit të tij në Shqipëri, në vitin 1923, në ikonat e T. Dalltës vihet re një mënyre klasike e të pikturuarit, ku penelatat dhe ngjyrat shkrihen me njëra-tjetrën, dhe në mënyrë harmonike, drita dhe hija, vendosja e ngjyrave, natyraliteti dhe emocioni, vizatojnë kompozimet. Në vazhdën e piktorëve të mëdhenj italianë, si Veronese, Giorgione apo Guido Reni, Carraci apo dhe El Greco. Th. Dallta frymëzohej jo vetëm në skenat biblike por edhe tek ato me karakter laik, ku personazhet paraqiteshin me veshje klasike greke-romake në histori idilike.

Në vitet 1920-1929, shkrimet mbi ikona dhe afreske janë në gjuhën greke.

(fig.1) Në qendër të veprës, është Krishti triumfues i cili, zë dhe pjesën më të madhe të kompozimit. Dominon e kuqja në veshjen e tij, e cila, në kontrast me blunë e ftohtë zë peshën kryesore të kompozimit dhe vendos fokusin në të. Rreth tij janë dishepujt dhe njerëz të tjerë të cilët, e mirëpresin me lavde. Draperia dhe përdorimi i dritës dhe hijes, i jep dinamikë të gjithë kompozimit dhe tregon që gjithçka është në lëvizje dhe tregon se ngjarja është në zhvillim.

Th. Dallta ka shumë kompozime me skena masive dhe kryesisht janë ato të " Ngjarjeve të mëdha", fetare , por edhe në ato laike, dallohen vizatimet dinamike, me lëvizje dhe qëndrime natyrale. Kryesisht, këto kompozime qendërzohen nga drita dhe ngjyra e ngrohtë, kryesisht e kuqja, e cila është karakteristikë dominuese e të gjitha pikturave e tij, e cila, më pas shkrihet lehtë duke u përhapur në të gjithë kompozimin dhe duke u përzier me të bardhën e dritës. Nuk mungojnë dhe rastet kur gjithçka balancohet në volum, dritë dhe ngjyra, duke i dhënë baraspeshë kompozimit. (fig.2)

Fig. 1. Theodor Dallta, *Hyrja në Jeruzalem*, 1924. (MKAM)

Në shumë prej pikturave dhe ikonave të tij, gjejmë një figurë qendrore (kryesisht shenjtor, hierark apo martir) i cili, qëndronte në pamje ballore dhe koka e tij në raport me trupin është pak më e madhe, kompozim tipik i ikonografisë bizantine. Por, ndryshimi tek stilizimi i portretit ku drita dhe hija, volumi dhe shkrirja në formë natyrale e ngjyrave me njëra-tjetrën ikin nga tradita bizantine dhe tentojnë drejt asaj europiane.

Sfondi mbrapa gjithashtu, është gjithashtu i pikturuar, tepër natyral, ku dallohet peizazhi, ndarja e vijës së horizontit, si dhe detaje të tjera, si male, lumë, gurë dhe ku ndjehet lëvizja e fijeve te barit apo gjetheve prej erës apo dhe drita e diellit dhe qielli i kaltër.

Një nga mënyrat kryesore të identifikimit të pikturave ikonografike të Th.D. qëndron tek kombinimi dhe kontrastet e ngjyrave të ngrohta, me të cilat ka trajtuar portretin dhe ngjyrat e ftohta të cilat e rrethojnë atë, si veshja apo sfondi. Në të njëjtën kohë kontrastet pasojnë njëra-tjetrën ku dallohet portreti në dritë, flokët e veshja në hije si dhe sfondi përsëri në dritë.

Në vitet '30, mbishkrimet në ikonat e tij, janë në shqip. Vihen re ndryshime në stilin e të pikturuarit, ku penelatat dhe ngjyrat nuk shkrihen më me njëra-tjetrën, por janë të shpenguara dhe dinamike. Këto penelata ndihen jo vetëm në sfond, në peizazh por edhe në portrete dhe në veshjet e shenjtorëve. Në vitet'40 dhe'50, Th. Dallta ka perfeksionuar stilin e tij, kompozimet, janë më të lirshme, penelatat janë komplekse, impresive dhe ngjyra e kuqe vazhdon ende të dominojë, edhe me më shumë forcë veprat e tij, ku fillon me një kulm ku e kuqja është masive dhe e fortë dhe pastaj shpërndahet lehtë

Fig. 2. Theodor Dallta, *Mirëprurëset*

Fig. 3. Theodor Dallta, *Shën e Premte*

me tonalitete të të kuqes dhe duke u miksuar me dritën dhe me penelata rozë.

Ai pikturoi për kishën e "Shën Sotirit", në Korçë, ku shumë prej ikonave mbajnë dhe mbishkrime në gjuhën rumune, pjese e komunitetit të cilës i përket kisha.

Megjithëse tradita bizantine pothuajse ishte zhdukur nga ikonat dhe vendin e saj e kishin zënë kopjet e piktorëve të mëdhenj italianë, ende kishte elementë të cilët e dallonin artin kishtar bizantin nga ai kishtar perëndimor. Përveç mënyrës se si shumë prej kompozimeve të ikonave apo afreskeve, përsipër vazhdonte gjithashtu të shkruhej emri i shenjtorit, emrat e dhuruesve si dhe emri i autorit.

Në rreth 80 vepra, pjesë e fondeve të MKAM, Th. Dallta ka shënjuar emrin e tij, ndërsa pjesa tjetër është evidentuar në lidhje me stilin e tij te pikturuarit dhe i janë atribuuar atij.

Krahas veprave liturgjike, Th. Dalltës i numërohen dhe shumë vepra laike, dekorative apo me karakter patriotik.

Vitet 1920 -1950, ku intensiteti i punës së tij ishte tepër i lartë, në Shqipëri, ishin kohë tepër të vështira, ku vendi ishte jo vetëm në luftë por edhe tepër i varfër. Kjo varfëri ndihej edhe në komunitetin fetar apo në kisha, ku ikonografët pikturonin me bojëra vaji dhe në materiale të ndryshme, kryesisht në dërrasa dhe telajo, letra apo dhe fibra e llamarina. Në shumë prej tyre cilësia e dobët e përgatitjes ka lejuar dëmtimin nga agjentët e jashtëm dhe e ka bërë njëkohësisht shumë të vështirë dhe restaurimin dhe konsolidimin e tyre.

Th. Dallta ka pasur një aktivitet të dendur artistik, krijimtari tepër të pasur, të krijuar jo vetëm në qytetin e Korçës. Ai kryesisht punoi mbi vepra ikonografike dhe afreske të kishave, ku vetëm në MKAM, numërohen mbi 120 ikona të cilat e kanë origjinën nga kishat e " Burimit Jetëdhënës" dhe "Shën Sotiri" në Korçë, apo dhe nga disa kisha në fshatra si: Zvirinë, Mborje, Tërovë, etj., të cilat u prishën në kohën e diktaturës, por numri i veprave, të cilat mund të jenë shkatërruar apo humbur, mendohet të jetë akoma dhe më i madh. Sipas të dhënave të familjarëve janë sekuestruar mbi 200 vepra liturgjike dhe laike në vitet e diktaturës, nga shtëpia e tij. Gjithashtu shume afreske ndodhen ende në muret e kishës "Burimi Jetëdhënës" në Korçë, apo dhe nëpër kisha të tjera. Prej disa vitesh, numri i veprave të Th. Dalltës në MKAM, ka qenë gjithmonë në rritje sepse ende vazhdon të kërkohet dhe të studiohet puna dhe jeta e tij, rrjedhimisht të zbulohen dhe vepra të tjera tij, pjesë e fondeve të muzeut.

Fig. 4. Theodor Dallta, *Profeti Ilia*

Fig. 5. Theodor Dallta, *Shën Todrat*

Visar Zhiti
& Lisandri Kola

PYETJA NR. 19

Bisedë për "Dorëshkrimet e fshehta të burgut"

Onufri